



# Koha



## Problemet e Maqedonisë...

FAQE 12-13

E përditshme informative

Viti XI • Numri 3070 • E martë 9 maj 2017 15 DEN



## 9 Maji, një aspiratë në udhëkryq

Shkup, 8 maj – Të festosh paqen dhe unitetin mes popujve. Kjo është simbolika e 9 Majit, Ditës së Evropës, frymës së aleancës mes popujve, si një garanci për zhvillimin e demokracisë qytetare dhe fuqizimit ekonomik e financiar e cila që prej më shumë se dy dekadash

shënohet në të gjitha vendet. Në Maqedoni aktivitetet që i paraprijnë kësaj dite, të organizuara nga institucionet shtetërore kanë qenë të pakta, ashtu si edhe vetë entuziazmi në rënie për procesin e integritetit të vendit. Kjo datë e gjen Maqedoninë në një udhëkryq, larg

aspiratave për integrimin evropian të vendit dhe të ngarkuar më shumë se kurrë më parë skepticizëm për anëtarësimin në BE. Sipas anketave më të fundit, numri i atyre që mendojnë se nuk ka fare rëndësi nëse vendi anëtarësohet ose jo në BE ...

FAQE 4

I paqartë qëndrimi i Ivanovit rreth mandatit

## Përgatitet Qeveri edhe pa mandat presidencial



Burimet partiake të Gazetës KOHA nga shumica parlamentare, theksojnë se po bëhen gati që në rast të qëndrimit të kundërt të Presidentit Ivanov, respektivisht të mos e mandatojë Zaevin për kryeministër, atëherë Qeveria të zgjidhet direkt nga Parlamenti. Pikërisht çështja e mandatimit dhe zgjedhja e qeverisë së re, mësohet të kenë qenë tema të diskutimit në takimet mes kryeparlamentari Talat Xhaferi me ambasadorët e Francës dhe të SHBA-së, Kristijan Timonie, përkatësisht Xhes Bejli

FAQE 2

DOSSIER

**Djali vdiq në vitin 1994, por zemra e tij pushoi së rrahuri këtë vit**



Mbrëmjen e datës 29 shtator 1994, shtatëvjeçari Nicholas Green u qëllua për vdekje me armë zjarri gjatë pushimeve me familjen në Italinë e jugut. Kjo qe tragjedi për prindërit e tij, Reg dhe Maggie...

FAQE 16

RAJON

**Procedohet demarkacioni nëse i mbijeton mocionit**

FAQE 14

GLOBI

**Makron: Do t'i luftoj ndarjet që sfidojnë Francën**

FAQE 15

SPECIALE

**Jeta e rrezikshme e përkthyesit të Titos**



FAQE 17

## Prokuroria e Shkupit i "ledhaton" dhunuesit e deputetëve



Shkup, 8 maj - Prokuroria Publike e Shkupit ka ngritur propozim akuzë kundër 9 personave, të cilët me datë 27 prill në mënyrë të dhunshme dhe brutale u futën në Kuvendin e Maqedonisë. Të gjithë këto të dyshuar sipas Prokurorisë përndiqen për "pjesëmarrje në turmë e cila ka penguar personin zyrtar në kry-

erjen e detyrës zyrtare", dispozitë kjo e cila buron nga neni 384 i Kodit Penal. Dorëzimi i propozim akuzës deri te Gjykata Penale e Shkupit vjen në kohën kur përfundon afati ligjor prej tetë ditëve ndaj pesë të dyshuarve të parë për sulmin ndaj Kuvendit, katër prej të cilëve gjatë javës së kaluar kanë

qëndruar në paraburgim, ndërsa njëri prej tyre në paraburgim shtëpiak. Për të gjithë katër personat të cilët u arrestuan mbrëmjen e 30 prillit, Prokuroria ka vendosur që masën e paraburgimit t'ua zëvendëson me atë të kujdesit. Ky vendim i tyre arsyetohet me atë se nga dëshmitë...

FAQE 2



Për të gjithë katër personat të cilët u arrestuan mbrëmjen e 30 prillit, Prokuroria ka vendosur që masën e paraburgimit t'ua zëvendësojë me atë të kujdesit. Këtë vendim e arsyetojnë me atë se nga dëshmitë e mbledhura, prokurorët përkatës kanë vlerësuar se nuk ekziston rreziku që këto person të pengojnë procedurën hetimore

Koha | Omer XHAFFERI

Shkup, 8 maj - Prokuroria Publike e Shkupit ka ngritur propozim akuzë kundër 9 personave, të cilët me datë 27 prill në mënyrë të dhunshme dhe brutale u futën në Kuvendin e Maqedonisë. Të gjithë këto të dyshuar sipas Prokurorisë përndiqen për "pjesëmarrje në turmë e cila ka penguar personin zyrtar në kryerjen e detyrës zyrtare", dispozitë kjo e cila buron nga neni 384 i Kodit Penal. Dorëzimi i propozim akuzës deri te Gjykata Penale e Shkupit vjen në kohën kur përfundon afati ligjor prej tetë ditëve ndaj pesë të dyshuarve të parë për sulmin ndaj Kuvendit, katër prej të cilëve gjatë javës së kaluar kanë qëndruar në paraburgim, ndërsa njëri prej tyre në paraburgim shtëpiak. Për të gjithë katër personat të cilët u arrestuan mbrëmjen e 30 prillit, Prokuroria ka vendosur që masën e paraburgimit t'ua zëvendëson me atë të ku-

# Propozim akuzë kundër 9 sulmuesve të Kuvendit

## Prokuroria e Shkupit i "ledhaton" dhunuesit e deputetëve



jdesit. Ky vendim i tyre arsyetohet me atë se nga dëshmitë e mbledhura, prokurorët përkatës kanë vlerësuar se nuk ekziston rreziku që këta persona ta pengojnë procedurën hetimore. "Për dy persona, të cilët janë përfshirë në listën e të dyshuarve, kemi ngritur propozim-akuzë. Prokurori përkatës dorëzoi edhe propozim për vazhdimin e paraburgimit. Nga ana tjetër, për një person i cili deri më sot ishte në paraburgim, ne kemi

vlerësuar për zbutjen e masës së propozuar, gjegjësisht për këtë të dyshuar kërkojmë zëvendësimin e masës me paraburgimin shtëpiak. Njëherit, për një dyshuar tjetër vazhdon të mbetet në fuqi masa e deritanishëm, gjegjësisht vazhdim i paraburgimit shtëpiak. Kurse sa i përket një të dyshuari, i cili deri më sot e ka vuajtur masën e paraburgimit, ne nuk kemi kërkuar vazhdim të kësaj mase, por vetëm caktim të masës

së kujdesit", thuhet në kumtesën e Prokurorisë së Shkupit. Njëkohësisht, nga kjo Prokurori kanë bërë të ditur se me vendim zyrtarë i kanë refuzuar tre paditë penale të dorëzuara nga Ministria për Punë të Brendshme. Duke sqaruar këtë vendim, Prokuroria e Shkupit thotë se për dy nga tre paditë e dorëzuara, Policia ka kryer identifikim të gabuar, respektivisht për një person aspak nuk është e vërtetuar se ka ndërmarrë

veprime të cilat përputhen me veprën penale. Mes tjerash, nëpërmjet kësaj komunikatë publike, Prokuroria e Shkupit ka dhënë sqarim edhe për siç thotë, spekulimet që kohëve të fundit janë përhapur për kualifikimin juridik të kësaj ngjarjeje. "Sipas normave ligjore, kualifikimin juridik për kryerjen e një veprë penale e jep vetë prokurori publik, i cili më pas udhëheq me dëshmitë e mbledhura deri në atë moment. Kjo nënkupton se

në rast të zbulimi të provave të reja, të cilat do të tregojnë se një person i caktuar ka kryer një veprë tjetër penale, atëherë prokurori publik gjatë zhvillimit të procedurës mund të bën rikualifikim të rastit dhe më këtë personi të hetohet për vepra tjera penale", thonë nga Prokuroria e Shkupit. Ndryshe, në kuadër të ngjarjeve që ndodhën me 27 prill, ku një numër i madh i huliganëve dhunshëm i sulmuan deputet dhe gazetarët brenda godinës së Kuvendit, nga kjo prokurori kanë theksuar se vazhdimisht janë duke punuar në mbledhjen e dëshmitë. Mirëpo, si rrallë herë deri më sot, ato kanë apeluar që gjatë raportimit për dhunën në Kuvend, opinioni duhet të ketë parasysh mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut, në radhë të parë parimin e prezumimit të pafajësisë. Meqenëse ky rast është duke u zhvilluar me procedurë të shkurtër, dispozitat e Ligjit për procedurë penale, gjegjësisht neni 490, paragrafi 1, parashohin që një proces i këtillë gjyqësor mund të zgjasë maksimum deri në 60 ditë.

Ministri Nuhiu theksoi se të gjithë së bashku duhet që të angazhohemi që sa më shpejt e gjithë policia të vendoset në shërbim të shtetit dhe shoqërisë

## Shënohet Dita e policisë, apelohe për profesionalizëm

Shkup, 8 maj - Policia duhet që të garantojë mjedis të sigurt për të gjithë qytetarët dhe nevojitet që të gjithë së bashku të angazhohemi që të vendosim transparencë themelore të vendosjes së marrëdhënieve midis policisë dhe qytetarëve, me komunitet dhe opinionin më të gjerë, deklaroi ministri i Punëve të Brendshme Agim Nuhiu në solemnitetin me rastin e Ditës së Policisë së Maqedonisë. Ministri Nuhiu theksoi se të gjithë së bashku duhet që të angazhohemi që sa më shpejt e gjithë policia të vendoset në shërbim të shtetit dhe shoqërisë. "Vendit dhe sigurisë publike i nevojitet profesionalizëm. Në Ditën e Policisë së Republikës së Maqedonisë do të përulem para simbolit të këtij institucioni të rëndësishëm shtetëror me bindje të thellë dhe me përkushtueshmëri maksimale se me angazhimin tonë të përbashkët, këtë institucion do të sjellim në parametra që janë të njohur ndërkombëtarisht për punën e policisë në kushte të një shoqërie



demokratike", deklaroi Nuhiu. Ai theksoi se reformat e mëdha në polici do të duhet që të vazhdojnë, pasi siç tha, të shënohet përparim dhe prosperitet, duke i kultivuar vlerat dhe standardet thelbësore të një policie profesionale, dinjitoze dhe të respektuar. Ndërkohë, LSDM është zotuar të reformojë policinë. "Qeveria e re reformatore e udhëhequr nga LSDM është e vendosur të realizojë reforma në polici dhe në shërbimet e sigurisë, me qëllim që policia të bëhet tërësisht

profesionale, moderne dhe efikase në shërbim të qytetarëve të Republikës së Maqedonisë", ka thënë në konferencën për shtyp sekretari i përgjithshëm i LSDM dhe deputeti, Oliver Spasovski. "Kemi parë se në MPB, në polici dhe në shërbimet e sigurisë ka profesionistë të cilët gjatë kohës së regjimit dhjetëvjeçar, gjatë kohës së dhunës në Parlament, gjatë kohës së tentimeve për destabilizim, janë përgjigjur me ndërjegje dhe dinjitet në interes të qytetarëve. Së bashku me profesionistët, do

të bëjmë reformat e nevojshme përmes së cilave do të mundësojmë polici e cila do të mbrojë vetëm qytetarët, dhe jo interesat e disave personale, partiake ose çfarëdo interesi tjetër. Asnjëherë më askush nuk do të mund të keqpërdorë policinë nga shtabet partiake, as dhe aty nuk do të ketë vend për kriminelë! Do të sigurojmë polici e cila në mënyrë joeslektive do të luftojë kundër kriminit dhe korrupsionit përmes zbatimit të paanshëm të ligjit për të gjithë", ka thënë Spasovski.



## Vidhen 15 ditare nga shkolla "Ismail Qemali"

Shkup, 8 maj - 15 ditare të klasave 6, 7, 8 dhe 9 janë vjedhur nga shkolla fillore "Ismail Qemali". Drejtuesit e shkollës bënë të ditur se për rastin që ka ndodhur të shtunën në mbrëmje kanë njoftuar dhe Ministrinë e Brendshme e cila po punon për zbardhjen e rastit. Siç bëjnë të ditur nga "Ismail Qemali", vjedhja e ditareve nuk do të ndikojë negativisht në përmbylljen e notave për nxënësit për shkak se notat janë të shënuara edhe në ditaret elektronikë. Madje punonjësit e shkollës thonë se personat e përfshirë në këtë vjedhje tashmë janë të njohur për udhëheqësinë e shkollës dhe policisë dhe të njëjtit thuhet se kanë paralajmëruar se do ti kthejnë ditaret.



Burimet partiake të Gazetës KOHA nga shumica parlamentare, theksojnë se po bëhen gati që në rast të qëndrimit të kundërt të Presidentit Ivanov, respektivisht të mos e mandatojë Zaevin për kryeministër, atëherë Qeveria të zgjidhet direkt nga Parlamenti. Pikërisht çështja e mandatimit dhe zgjedhja e qeverisë së re, mësohet të kenë qenë tema të diskutimit në takimet mes kryeparlamentari Talat Xhaferi me ambasadorët e Francës dhe të SHBA-së, Kristijan Timonie, përkatësisht Xhes Bejli

I paqartë qëndrimi i Ivanovit rreth mandatit

# Përgatitet Qeveria edhe pa mandat presidencial



Koha Fatos RUSHITI

Shkup, 8 maj - Formimi i Qeverisë së re nuk do të pres gjatë mandatimin nga presidenti Gjorge Ivanov, por do të ndodhë shumë shpejtë përmes votimit të saj në Parlament, thonë për gazetën KOHA burime partiake nga shumica parlamentare. Aktualisht është duke rrjedhur afati dhjetë ditor që shumica parlamentare ia caktoi Ivanovit për t'ia ndarë mandatin liderit të LSDM-së, Zoran Zaev. Njoftimi se ka shumicë parlamentare ende nuk është publikuar nga Gazeta zyrtare, megjithëse dokumenti për këtë këtij institucioni i është dërguar që nga java e kaluar. Burimet partiake të Gazetës KOHA nga shumica parlamentare, theksojnë se po bëhen gati që në rast të qëndrimit të kundërt të Presidentit Ivanov, respektivisht të mos e mandatojë Zaevin për kryeministër, atëherë Qeveria do të zgjidhet direkt në Parlament, por që të ndodhë kjo, LSDM, BDI, ASH dhe Lëvizja BESA, do të kenë bisedime paraprake dhe të lidhin marrëveshje për ndarjen e pushtetit të ri. Pikërisht çështja e mandatimit dhe zgjedhja e qeverisë së re, mësohet të kenë qenë tema të diskutimit në takimet mes kryeparlamentari Talat Xhaferi me ambasadorët e Francës dhe të SHBA-së, Kristijan Timonie,

## GAZETA ZYRTARE ENDE NUK KA SHPALLUR VENDIMIN PËR XHAFERIN

Ende asnjë përgjigje nga presidenti Gjorge Ivanov lidhur me letrën e kryeparlamentarit Talat Xhaferi për dhënien e mandatit liderin social-demokrat, Zoran Zaev. Presidenti është kthyer nga vizita zyrtare në Turqi por nga kabineti i tij nuk ka asnjë njoftim se kur mund të pritet përgjigje. Në bazë të Kushtetutës Ivanov është i obliguar të kthejë përgjigje në afat prej 10 ditëve nga dita e marrjes së njoftimit për formimin e shumicës së re parlamentare. Ndërkohë ende nuk është publikuar as vendimi i shumicës për zgjedhjen e Xhaferit për kryetar Kuvendi. Nga Gazeta Zyrtare kanë bërë të ditur se përpunimi me ligjet, në numrin e ardhshëm do të publikohet vendimi për zgjedhjen e krye parlamentarit të ri.

përkatësisht Xhes Bejli. Ndonëse asnjëri nuk dha zyrtarisht deklaratë për media, por zgjedhja e Qeverisë pa mandat nga Presidenti u bë e ditur nga kryeparlamentari Talat Xhaferi gjatë takimeve në Bruksel ditë më parë me përfaqësuesit më të lart të BE-së, Federika Mogerini dhe Johanes Han. LSDM ende ka shprehur se Ivanovi do ta jap mandatin duke respektuar kështu procedurat ligjore dhe kushtetuese pas njoftimit nga kryeparlamentari Xhaferi, se në Parlament ekziston shumicë parlamentare për të formuar Qeverinë. "Siç e ka përsëritur lideri Zoran Zaev më herët, Presidenti duhet të veprojë në pajtim me kushtetutën dhe të jap

mandatin sa më shpejtë. Në kemi shprehur se pas asaj çka ndodhi në Parlament, Ivanov nuk mund të ndodhë që të bëjë provokimin e radhës. Nëse ai nuk e zbaton kompetencën e vetë, Parlamenti do të veprojë vetë sepse deputetët për këtë kanë marrë mandat nga populli që të qeveriset me popullin", thonë një zyrar i lartë partiak nga LSDM. Në BDI thonë se nuk kanë shpresa se Ivanov do të jap mandatin, ndërsa theksojnë se në parti tashmë një kohë të gjatë mendohet si të veprohet më drejtë që Parlamenti vetë të zgjedhë Qeverinë. "S'kemi shpresë se Ivanovi. Ashtu siç ka vepruar më herët, njëjtë do të veprojë edhe tani, por ajo që dihet

dhe që do të ndodhë është se Parlamenti nuk mund të pres në pakufi Presidentin dhe do t'i marrë punët në dorë dhe do të zgjedh Qeverinë. Por, për këtë duhet kohë dhe duhet biseduar edhe hisen shqiptare të pushtetit", thonë zyrarët të lartë partiak të BDI-së. LSDM, si partia më e madhe shumicës parlamentare, ende mban shpresë nga presidenti Ivanov se do të mandatojë liderin e tyre Zoran Zaev për kryeministër të ri pas ngjarjeve të dhunshme në Parlament, ndërsa po të njëjtat qëndrime ka edhe Lëvizjes BESA. Nga Lëvizja BESA thonë se aktualisht janë në pritje të vendimit të presidentit Ivanov të respektojë vullnetin e popullit,

ndërkaq nuk e jep mandatin nga kjo parti thonë se do të diskutojnë në organet e larta partiake nëse do të veprojnë në Parlament. "Aktualisht jemi në pritje që presidenti Ivanov ta respektojë vullnetin e shumicës, t'i respektojë procedurat demokratike dhe t'ia jep mandatin zotëri Zaevit. Nëse jo, organet e partisë do të marrin vendim për pozicionin tonë në kësi rrethanash", thonë zyrarë partiak nga Lëvizja BESA. Ndërkohë, sa i përket zgjedhjeve lokale, të mërkurën Gjykata Kushtetuese do të vendosë rreth iniciativës së Ministrisë së Drejtësisë dhe asaj të Pushtetit Lokal për t'i shpallur antikushtetuesen e ligjit për vetëqeverisje lokale që kanë të bëjnë me mbarimin e kompetencave të kryetarëve të komunave dhe këshilltarëve komunal. Por, pavarësisht kësaj, më 15 maj u mbaron mandati të zgjedhurve komunal, ndërsa i mbetet kryeparlamentarit Xhaferi që t'i shpallë zgjedhjet lokale deri në këtë datë. "Shtyrja ose mbajtja e zgjedhjeve lokale tash-

më nuk është diçka që e saktëson ndonjë lider i caktuar politik. Këtu ka ndodhur shkelja e të gjitha afateve dhe nuk ka mundësi teorike të mbarën zgjedhjet lokale para verës. Prandaj, ato detyrimisht duhet të mbarohen më së herëti në vjeshtë. Kurdo që të mbarohen, për neve ky është një lajm i mirë, sepse jemi të bindur se ato do të jenë një shpëtim për shqiptarët e Maqedonisë", thonë nga lëvizja BESA. Më parë, Bashkësia e njësive të Vetëqeverisjes Lokale (BN-JVL) e përkrahi mendimin e dhënë nga Ministria e Vetëqeverisjes Lokale për vazhdimin e mandatit të kryetarëve të Komunave dhe të këshilltarëve deri 15 maj 2017. BNJVL bëri thirrje për sigurimin e kushteve dhe për caktimin e shpejtë të zgjedhjeve lokale, sepse në të kundërtën do të vije në gjendje kur Komunitat dhe institucionet të cilat janë nën kompetencat e komunave: shkollat, kopshtet, institucionet kulturore, ndërmarrjet publike, njësitë e zjarrfikësve nuk do të jenë në gjendje të kryejnë detyrën e tyre.

## DIKASTERET ENDE S'JANË CAKTUAR, SPEKULOHET ME EMRA MINISTRASH

Ditëve të fundit në qarqet partiake flitet për ndarje të kulaçit qeveritar mes LSDM-së, BDI-së dhe ASH-së. Sipas këtyre zërave, BDI do të ketë 5 resorë qeveritarë, ndërsa ASH dy ministra. Sipas gazetës javore "Fokus", ministria e Punëve të Jashtme do t'i takojë BDI-së edhe me shumë gjasa asaj do t'i prijë nënkryetarja Teuta Arifi. BDI do të ketë ose zëvendëskryeministër për çështje ekonomike apo Ministrinë e Financave, ku sipas "Fokus", përfletet emri i Fatmir Besimit. Po ashtu BDI-së do t'i takojë edhe Ministria e Mbrojtjes, ndërkaq dilematike është Ministria e Drejtësisë, ku përveç BDI-së po synohet me çdo kusht edhe nga LSDM, ndërsa kompromisi mund të jetë që BDI të merr Ministrinë e Transportit dhe Lidhjeve. Në punët e Brendshme ministër do të jetë Oliver Spaosovski, ndërsa Lupço Nikollovski, Frosina Ramenski dhe Aleksandër Kiracovski përfleten për ministra në Bujqësi, Shoqëri informatike dhe Arsimit, kurse kultura ka gjasa t'i takojë BDI-së, por që në këtë parti ka më pak spekulime për emra ministrash. ASH, sipas "Fokus", do të merr Shëndetësinë, ndërsa ministria e dytë mund të jetë mes Ekonomisë, Arsimit dhe Pushtetit lokal. Në këtë subjekt emri më i përfolur për të Shëndetësinë një kohë të gjatë është mjeku Arben Tarvarit, sekretar i përgjithshëm i LR-DSH-së.

## APEL I FUNDIT I LSDM-së DERI TE IVANOVI

LSDM-ja apelon që të mundësohet transfer i qetë dhe i sigurt i pushtetit dhe presidenti Gjorge Ivanov të veprojë në pajtueshmëri me Kushtetutën dhe ta japë mandatin për formim të qeverisë së re. "Formimi i qeverisë së re dhe zbatimi i prioritetëve reformues është interes i lartë shtetëror dhe çdo veprim kundër interesave shtetërorë është vepër penale e ndëshkuar me ligj. Apelojmë deri tek të gjithë që të veprojnë me mençuri dhe sipas ligjit, që të mundësohet transfer i qetë dhe i sigurt i pushtetit", njofton LSDM-ja. Në kumtesë shtohet se qytetarët e presin formimin e qeverisë së re që përfundimisht, siç thuhet, të fillojnë ndryshimet për jetë të mirë dhe dinjitoze për të gjithë. "Ajo që qeveria e re do t'i qaset rritjes së pagës minimale, do të hiqet taksa radiodifuzive, do të vendoset tarifë e lirë ditore e rrymës dhe gjatë gjithë fundjavës rrymë të lirë janë vetëm disa nga masat e para prej të cilave qytetarët do të ndjejnë lehtësim në buxhetet familjare", citohet në kumtesë. Nga LSDM-ja thonë se qeveria e re është e domosdoshme edhe për shkak të proceseve euro-integruese të vendit, e cila gjatë kohë ka qenë e bllokuar dhe e izoluar për shkak të, siç thuhet, interesave kriminele të Nikolla Gruevskit dhe udhëheqësisë së VMRO-DPMNE-së.

Aktivitetet që i paraprijnë kësaj dite, të organizuara nga institucionet shtetërore kanë qenë të pakta, ashtu si edhe vetë entuziazmi në rënie për procesin e integritimit të vendit. Kjo datë e gjen Maqedoninë në një udhëkryq, larg aspiratave për integrimin evropian të vendit, të ngarkuar më shumë se kurrë më parë skepticism për anëtarësimin në BE, me Raportin e Pribes në sirtar dhe shqiptarë e maqedonas me perceptime diametralisht të kundërta për proceset integruese

Koha Evis HALILI

Shkup, 8 maj – Të festosh paqen dhe unitetin mes popujve. Kjo është simbolika e 9 Majit, Ditës së Evropës, frymës së aleancës mes popujve, si një garanci për zhvillimin e demokracisë qytetare dhe fuqizimit ekonomik e financiar e cila që prej më shumë se dy dekadash shënohet në të gjitha vendet. Në Maqedoni aktivitetet që i paraprijnë kësaj dite, të organizuara nga institucionet shtetërore kanë qenë të pakta, ashtu si edhe vetë entuziazmi në rënie për procesin e integritimit të vendit. Kjo datë e gjen Maqedoninë në një udhëkryq, larg aspiratave për integrimin evropian të vendit dhe të ngarkuar më shumë se kurrë më parë skepticism për anëtarësimin në BE. Sipas anketave më të fundit, numri i atyre që mendojnë



se nuk ka fare rëndësi nëse vendi anëtarësohet ose jo në BE është në rritje, ndërsa kredibiliteti i vetë BE është vënë në pikëpyetje nga shumica e të anketuarve. Pakënaqësia te pjesa maqedonase e popullsisë është rritur, sidomos me rolin e ndërmytësuesit që luajti BE në tejkalimin e krizës në vend, duke bërë që mbështetja që ato i japin procesit të anëtarësimin të jetë në rënie. Euro-skeptizimi i maqedonasve përligjet edhe me ndjesinë e kërcënimit kulturologjik, si edhe cenimin e sovran-

itetit identitar, përkatësisht me ndryshimin e emrit të shtetit. Kjo është arsyeja që të anketuarit maqedonas shohin si aleat Rusinë, ndërsa pjesa shqiptare shpreson më shumë tek BE dhe procesi eurointegruese. Sa i takon perceptimit të përgjithshëm lidhur me shkaku e refuzimit të vendit për në BE njerëzit janë të bindur se ngecja e reformave është problemi kryesor. Lista e vërejtjeve dhe reformat që duhet të zbatohen kanë qenë vazhdimisht pjesë e Raportave vjetore për Maqedoninë.

Më i rëndësishmi, është Raporti i Pribes i hartuar gati dy vjet më parë nga ekspertë të BE, asnjë nga pesë shtyllat e të cilat nuk arrit të realizohet. Si sfida për qeverinë e ardhshme mbetet plotësimi i kushteve të këtij raporti për të avancuar integrimin evropian të vendit. Reformat që do të duhet të realizojë qeveria e re duhet të përfshijnë pesë sfera. E para ka të bëjë me skandalin e aferës së përgjimeve, keqpërdorimin e detyrës nga nëpunës të lartë qeveritar, që duhet të pasojë me rishikimin e

## QEVERIE E RE, ME DETYRA TË REJA

“Nga ‘status quo’ mund të na nxjerrë Qeveria e re. Kjo është detyra dhe mënyra e vetme për të tejkaluar krizën e gjatë dhe stangimin e vendit drejt proceseve eurointegruese. Kështu ka deklaruar zëvendëskryeministri i Çështjeve Evropiane Arbër Ademi. Në një takim në UEL me temë ‘E ardhmja e BE në 2025 dhe perspektivat e Maqedonisë’ Ademi ndër të tjera ka thënë se si do të duket BE pas kaq vitesh varet nga vendimet që do të merren sot, në një kohë me situatë të komplikuar. ‘Qeveria e re do të ketë përpara vetes një detyrë të rëndësishme, dhe mënyrën e vetme për të ecur përpara dhe për ta lënë pas situatën e ‘status quo’ është implementimi i të gjitha reformave që lidhen me agjendën e BE, si edhe reformat urgjente prioritare, reformat në administratën publike, sistemi gjyqësor, implementimin e Marrëveshjes së Ohrit’, ka thënë Ademi.

kompetencave të Drejtorisë së Sigurisë dhe Kundërzbulimit. Pika e dytë e raportit janë reformat që lidhen me Gjyqësorin dhe Prokurorinë, përkatësisht më shqetësues janë emërimet të krerëve të tyre që bëhen në rrugë partiake. Shtylla e tretë e Raportit lidhet me Mbikëqyrjen e jashtme nga trupa të pavarur, konkretisht me Avokatin e Popullit dhe Drejtorinë e Mbrojtjes së të Dhënave Personale, të cilat nuk u angazhuan në mënyrë aktive gjatë hetimit të skandalit të përgjimeve. Sfera e katërt janë zgjedhjet. Vërejtjet në raport lidhen

me mungesën e një ndarje mes aktiviteteve shtetërore nga ato partiake dhe me listën zgjedhore.

Deri tani është punuar në çështjen e emërimit të anëtarëve të pavarur të KSHZ, ndërsa sa i takon rekomandimeve të tjera për parregullsitë dhe manipulimet gjatë cikleve zgjedhore ende nuk ka asnjë përmirësim. Pika e fundit e këtij raporti, dhe për të cilën ende nuk ka asnjë përmirësim janë mediat dhe liria e tyre. Ato cilësohen si një prej sferave më të cenuara, ndërsa kushtet në të cilat punojnë gazetarët të këqija.

## Ana komerciale e shkollave

## Ekskursionet, pak shëtitje dhe pak biznes

Arsyet për dyshime të këtitilla, sikurse vërejnë nga Unioni i Nxënësve Shqiptarë të Shkollave të Mesme (UNSHM) janë të shumta, ndërsa burimin e kanë të mungesa e transparencës financiare

Koha Laura PAPANIKU

Shkup, 8 maj – Shkollat assesi të largojnë nga vetja tisin e dyshimit që i mbështjell sa herë që hyn para mes tyre dhe nxënësve. Kur janë në pyetje aktivitetet jashtë shkollore, si organizimi i ekskursioneve të ndryshme, mbrëmjeve të maturës apo fotografimi për tabelën e shkollës, jo pa arsye krijohet një atmosferë e rëndë dyshimi se një grup i caktuar njerëzish në shkollë bëjnë me këtë rast edhe pak “biznes”, sa për të mbuluar disa shpenzime shtesë, të planifikuara mbase që



në fillim të vitit shkollor. Arsyet për dyshime të këtitilla, sikurse vërejnë nga Unioni i Nxënësve Shqiptarë të Shkollave të Mesme (UNSHM) janë të shumta, ndërsa burimin e kanë të mungesa e transparencës financiare.

“Nuk duhet asnjëherë se ku përfundojnë të gjitha të hollat që u kërkohen nxënësve, sidomos kur i dërgojnë nëpër ekskursione”, pohon Majlin-

da Qilafi kryetare e UNSHM-së, ndërsa vëren se çdo herë vendimet për vendin e ekskursionit e cakton drejtorja e shkollës. Për këtë rast, shpesh herë, plotëson më tej Qilafi, ka pakënaqësi nga ana e nxënësve dhe prindërve të tyre. Kjo situatë, thotë ajo, përsëritet fatkeqësisht çdo vit, kurse “shuma e të hollave që paguajnë nxënësit nuk korrespondon me atë çfarë

harxhohet për nxënësit gjatë ekskursionit”, nënvizon ajo.

Zakonisht, në pagesën që bëjnë nxënësit, sikurse tregon kryetaria e UNSHM-së, hyn edhe pagesa për mesimdhënësit si dhe për ndonjë nxënës që vjen nga familje me status të rrezikuar social. Por, edhe përkaj këtyre kalkulimeve, Qilafi thotë se janë edhe një pjesë tjetër e parave të cilat nuk dihet se

ku përfundojnë. Jo më larg se më 18 prill shumë shkolla të mesme të Shkupit organizuan ekskursion një ditë në Strugë. Mirëpo, ajo që ra në sy ishte se nxënësit e disa shkollave të mesme, si “Cvetan Dimov”, apo “Pançe Karagjov”, paguan nga 450 denarë, ndërsa nxënësit e Shkollës së mesme “Arseni Jovkov” nga 600 denarë. Si të parët ashtu edhe të dytët, në këtë çmim kishin vetëm pagesën e rrugës Shkup-Struge dhe anasjelltas dhe asgjë më shumë. Variacione çmimesh ka edhe për ekskursionet disa ditore që shkollat organizojnë me nxënësit e viteve të treta dhe për mbrëmjet e maturës. Sot e kësaj dite mungon një pagesë e unifikuar konform ofertave të njëjta. Për pesë ditë ekskursion në Shqipëri, për shembull, dikush paguan 180 euro, dikush tjetër 210 euro. Ose për të njëjtin qëllim, disa shkolla i dërgojnë nxënësit në Turqi, disa të tjera në Rumani. Problemi është se

shkollave u mungon krejtësisht transparenca financiare dhe se përjashtojnë nxënësit nga vendimmarrjet e këtitilla.

“Nxënësit nuk janë të kyçur aspak në procesin e marrjes së vendimeve lidhur me atë se ku do të shkohet në ekskursion, sa ditë do të qëndrohet apo se cila ofertë është me e leverdishme. Për gjithçka vendosën udhëheqësi e shkollës dhe nuk konsultohen aspak nxënësit”, pohon Qilafi, kryetaria e UNSH-së.

E ,në fakt, të gjithë drejtorët ankohen për “kokëçarje” që thonë se u shkaktojnë situatat kur duhet të dërgojnë nxënësit nëpër ekskursione apo të organizojnë mbrëmje mature, fotografim për tabelën e shkollës e kështu me radhë. Mirëpo, nuk u shpëton asnjëherë dhe asnjë rast pa mos qenë personalisht në krye të organizimeve të këtitilla. Dikush fshihet pas Këshillit Drejtues të Shkollës, e dikush është më i drejtpërdrejtë.



Trefishohet eksporti i shërbimeve

# Pak ia shohim hairin rritjes

Edhe pse Maqedonia ka trefishuar eksportin e shërbimeve në periudhën 2006-2016, megjithatë nuk janë të mëdha përfitimet nga ky sektor ekonomik. Kur minusohet importi i vlefshëm 1 miliardë e 50 milionë euro, prej eksportit të vlefshëm 1 miliardë e 450 milionë euro, del se kemi fitim neto prej 400 milionë euro nga sektori i shërbimeve

Koha Fisnik PASHOLLI

Shkup, 8 maj - Edhe pse Maqedonia ka trefishuar eksportin e shërbimeve në periudhën 2006-2016, megjithatë pak ia shikon hairin rritjes kaq të madhe të këtij sektori ekonomik. Kur minusohet importi i vlefshëm 1 miliardë e 50 milionë euro, prej eksportit të vlefshëm 1 miliardë e 450 milionë euro, del se kemi fitim neto prej 400 milionë euro nga sektori i shërbimeve.

Nga ana tjetër, gati 50 për qind e vlerës së përgjithshme si të eksportit, ashtu edhe të importit ka të bëjë me shërbimet e përpunimit të tekstilit apo prodhimit dhe gjysmë-përpunimeve kimike apo të industrisë automobilistike për fabrikat e ndërtaura në zonat industriale.

Sipas ekonomistëve, trendet e tilla të rritjes së



eksportit janë pozitive, por megjithatë shtojnë se duhet pasur parasysh edhe faktin se në periudhën e kaluar dhjetëvjeçare nuk është rritur vetëm eksporti i shërbimeve, por dukshëm është rritur edhe importi i shërbimeve. Në vitin 2006, vlera e importit të shërbimeve ka qenë 367 milionë euro për t'u rritur në një miliardë euro e 50 milionë euro. Kjo do të thotë se kemi edhe rritje prej 683 milionë euro të importit.

Andaj, ekonomistët thonë se Maqedonia një rëndësi të veçantë duhet t'i kushtojë sektorëve që kryesisht shfrytëzojnë potencialin intelektual vendor, siç është teknologjia informatike, por edhe shfrytëzimi më i madh të mirave materiale dhe natyrore, që përdoren nga sektori i turizmit me qëllim të rritjes së përfitimeve

në devisa nga eksporti i shërbimeve. Të ardhurat nga turizmi në Maqedoni lëvizin prej dy deri tre për qind si pjesë e Prodhimit të Brendshëm Bruto, që është disa herë më pak se shtetet fqinje, ku kjo përqindje arrin edhe 10 për qind. Nga ana tjetër, sektor që kërkon më shumë kujdes është sektori i teknologjisë informatike që gati ka dyfishuar eksportin prej 87 milionë euro në vitin 2009, në 151 milionë euro në vitin 2016, që posedon potencial të madh për eksport, por megjithatë ballafaqohet me sfida të mëdha.

Nga Oda ekonomike e teknologjisë informatike "MASIT", thonë se rritja kaq e madhe e sektorit të teknologjisë informatike, i detyrohet numrit të madh të kompanive të hapura informatike si dhe orien-

timit se vjen e më të madh të kompanive ekzistuese ndaj eksportit.

Një nga përparësitë kryesore të industrisë vendore të teknologjisë informatike, është se oferta e saj paraqet "vlerë për të holla", fuqia punëtore nuk është e lirë, por ka çmim që është i kapshëm për kompanitë në shtetet e targetuara për eksport që fitojnë shërbime me cilësi të lartë. Gjithashtu kompanitë e këtij sektori kanë njohuri të mëdha teknike, janë të gatshme të punojnë sipas teknologjive dhe standardeve më të larta dhe kanë njohuri mjaft të lartë, jo vetëm të gjuhës angleze por gjuhës të tjera që i kërkon tregu.

Por, ekzistojnë edhe mjaft sfida për avancimin e këtij sektori siç janë masat stimuluese që do të përmirësojnë dhe rrisin kapacitetet eksportuese të

## VLERA E EKSPORTIT DHE IMPORTIT TË SHËRBIMEVE NË 2016

Shërbime prodhuese për përpunim  
Eksport- 995 milionë euro  
Import - 680 milionë euro

Shërbimet e teknologjisë informatike  
Eksport- 150 milionë euro  
Import - 75 milionë euro

Udhëtime  
Eksport- 257 milionë euro  
Import- 162 milionë euro

torët e huaj që sjellin turistë të huaj, avio-biletat e lira, promovimit të Maqedonisë si destinacion atraktiv turistik dhe masave të tjera mbështetëse, megjithatë në dhjetë vitet e fundit në mesatare turistët e huaj flenë vetëm dy net.

Të ardhurat nga turizmi në Maqedoni lëvizin prej dy deri tre për qind si pjesë e prodhimit të brendshëm bruto, që është disa herë më pak se shtetet fqinje ku kjo përqindje arrin edhe 10 për qind. Për shembull, Sllovenia nga turizmi në vit realizon 13 për qind të PPP-së, ndërsa Serbia fqinje vitin e kaluar ka realizuar një miliardë euro nga turizmi. Nga ana tjetër, në Maqedoni të ardhurat devizore prej turistëve të huaj në 12 muajt e vitit të kaluar ishin afër 250 milionë euro, tregojnë të dhënat e Bankës Popullore. Sipas njohësve të turizmit, Maqedonia duhet të përgatisë një ofertë dalluese në raport me shtetet fqinje si dhe të orientohet edhe ndaj turistëve të shteteve të Lindjes së afërt, që e kanë të vështirësuar ardhjen në shtetet evropiane, nëse dëshiron që për disa herë të rrisë të ardhurat nga turistët e huaj. Vlerësohet se një potencial të veçantë për zhvillimin e turizmit të verës, së gastronomisë dhe atij shëndetësor përfshi edhe spa qendrat, për çka nevojiten më shumë investime dhe ofertë më e madhe në këto fusha.

Në prill shpenzimet për jetesë më të larta për një për qind

## Janë shtrenjtuar gati të gjitha prodhimet

Rritje shënojnë edhe çmimet me pakicë për 2,2 për qind në krahasim me prillin e vitit të kaluar, ndërsa në krahasim me muajin e kaluar për 0,1 për qind

Koha Zejnulla VESELI

Shkup, 8 maj - Shpenzimet e jetesës në prill të vitit 2017, në krahasim me prillin e vitit 2016 shënon rritje prej një për qind, ndërsa në krahasim me muajin e kaluar për 0,3 për qind. Rritje shënojnë edhe çmimet me pakicë për 2,2 për qind në krahasim me prillin e vitit të kaluar, ndërsa në krahasim me muajin e kaluar për 0,1 për qind. Sipas të dhënave të publikuara të Entit Shtetëror të Statistikës, rritje e indekseve të jetesës në prill të vitit



2017, në krahasim me muajin e njëjtë të vitit të kaluar është vërejtur tek perimet e freskëta dhe të ngrira, përveç patates për 15,8 për qind, frutat freskëta dhe të ngrira për 11,7 për qind, patatet për 4,1 për qind, arrat dhe produktet e frutave të thata me 1,4 për qind, vezët për 1,2 për qind, kosi për

0,7 për qind, cigaret 0,5 për qind, produkte të tjera të mishit, produktet e peshkut dhe të frutave të detit, perimet e thata, perimet e konservuara dhe të tjera të përpunuara për 0,4 për qind, sheqeri, reçeli, mjalti, çokolllat dhe ëmbëlsirat për 0,3 për qind dhe buka për 0,2 për qind. Në prill, gjithashtu

rritje të Indeksit të çmimeve të konsumit është regjistruar edhe tek qilimat dhe mbulesat tjera të dyshemesë për 2,8 për qind, pajisje fotografike dhe kinematografike dhe instrumentet optike për 2,0 për qind, të sigurimeve për 1,8 për qind, materialet e zyrave dhe materialet për vizatim për 1,6 për

qind, këpucët për 1,2 për qind, biçikletat, kopshte, bimët dhe lulet, shërbimet për rekreim dhe sport dhe shërbimet për akomodim për 0,9 për qind, lojëra, lodra dhe hobi për 0,7 për qind, riparimi i pajisjeve elektrike për 0,6 për qind, pajisjet për praninë, regjistrim dhe riprodhim i zërit dhe fotove 0,5 për qind, shërbimet për mirëmbajtjen dhe riparimin e banesës, sende të tjera personale dhe shërbime financiare të papërmendura në vende tjera për 0,3 për qind, veshje, pajisje të mëdha, aranzhmane turistike, shërbime hotelerike dhe artikuj të higjienës personale dhe shëndetit me 0,2 për qind. Ulje në Indeks të çmimeve të Konsumit në muajin prill 2017, në krahasim me muajin e kaluar është regjistruar në produktet e tjera ushqimore për 1,3 për qind, mishi për 1,2 për qind, frutat e ngrira për 0,8 për qind, pijet

alkoolike për 0,5 për qind, peshku dhe frutat e detit për 0,4 për qind. Një rënie e indeksit të shpenzimeve është regjistruar në pajisjet e informacionit me 7,2 për qind, gazit për amvisëri me 4,7 për qind, lëndë djegëse të lëngëta për amvisëri për 4,2 për qind, pajisjet për telefon dhe faks për 3 për qind për shërbimet spitalore për 2,5 për qind, lëndët djegëse të lëngshme dhe lubrifikantët, si pjesë e pajisjeve për pajisjeve për transportin personal për 2,2 për qind, tekstilet shtëpiake dhe automjetet për 0,6 për qind, mjettet dhe pajisjet për shtëpi dhe kopshte, produkte të tjera mjekësore dhe aparatet terapeutike, të shërbimeve për kulturë dhe shërbime të tjera që nuk janë përmendur më vend tjetër për 0,4 për qind, pajisjet për pastrimi dhe mirëmbajtjen e banesës dhe transporti ajror i udhëtarëve për 0,3 për qind.



Thirrja e katërt e Fondit për inovacione

# Inovatorët ofrojnë zgjidhje për industri të shumta

Shumica, respektivisht pothuajse gjysma e projekteve të propozuara është në teknologjinë informative dhe komunikuese. Ka aplikime për mjekësi, palestër, çiklizëm, projektim, bujqësi, marketing, video, si dhe përpunimin e ushqimit dhe të ndërtimit

Koha Qefser ABDYLI

Shkup, 8 maj - Pesëdhjetë e nëntë aplikimet për financim të projekteve të kompanive për të realizuar zgjidhje të reja janë grumbulluar në thirrjen e katërt të Fondit për inovacione dhe zhvillim teknologjik, i cili ka gjithsej për këtë dedikim ka ndarë 1.450.000 euro. Shumica, respektivisht pothuajse gjysma e projekteve të propozuara është në teknologjinë informative dhe komunikuese. Ka aplikime për mjekësi, palestër, çiklizëm, projektim, bujqësi, marketing, video, si dhe përpunimin e ushqimit dhe të ndërtimit. "Tridhjetë e një aplikime për startap - ndërmarrjet, dhe 28 për komercializimin e inovacioneve. Është planifikuar për t'u mbështetur 15 startap - ndërmarrje, me një total prej 450.000 euro, kryesisht 30.000 euro nga projekti. Për komercializimin e risive janë planifikuar për t'u ndarë 10



grante, deri në 100.000 euro për projektin, ose një total prej një milion euro", tha drejtore-sha e fondit për inovacione dhe zhvillim teknologjik, Jasmina Popovska. Ajo njoftoi se komiteti për miratimin e investimeve deri në fund të korrikut do të vendosë se kush do të marrë fonde dhe në fillim të shtatorit pritet të nënshkruhet kontrata për bashkëfinancim dhe fillim të projekteve. Nëse dokumentacioni nuk është i plotë, aplikantët kanë pesë ditë për të paraqitur dokumentet e kërkuara, komisioni do të bëjë një para-përzgjedhje dhe vlerësim. Nëse dokumentacioni nuk është i plotë, ap-

likantët kanë pesë ditë për të paraqitur dokumentet e kërkuara, kurse komisioni do të bëjë një para-përzgjedhje dhe vlerësim. "Ata që janë të selektuar do të kenë mundësinë të paraqesin zgjidhjet para komisionit dhe personalisht të shpjegojnë se çfarë është inovative, cili është tregu potencial, a ka kapacitet për të zbatuar dhe për të eksportuar jashtë vendit, cili është i gjithë qëllimi i këtyre instrumenteve - për të gjenuar më shumë eksportet dhe konkurrencë të madhe për biznesin", tha Popovska.

Përveç inovacioneve, nevojitet plotësimi i kriterëve për

përzgjedhjen e projekteve dhe potencialin e tregut, kapaciteti i ekipit të menaxhimit, përshatshmëria e shpenzimeve të projektuara, ose cilësinë e përgjithshme të projektit. Kompanitë kanë pasur mundësi në 90 ditët e fundit për të paraqitur aplikacionet për thirrjen e katërt, e cila ndanë bashkë-financim për startap dhe spinof dhe grante të konfiskuara dhe kredi me kusht për komercializimin e inovacioneve. Në thirrjet e mëparshme fondin e kanë mbështetur 36 projekte, nga të cilat, siç tha Popovska, kryesisht të suksesshme dhe aktive në treg.

## Nga e enjtja temperatura deri në 34 gradë celsius

Shkup, 8 maj - Moti i vranët me reshje të kohë-paskohshme të shiut do të mbajë deri të mërkurën, ndërsa të enjten pritet stabilizim i motit me erë mesatare jugore dhe me rritje të konsiderueshme të temperaturave. Temperatura të

mërkurën do të lëvizë prej 16 deri në 24 ndërsa të enjten nga 20 deri në 27 gradë Celsius, të premten prej 24 deri në 30, të shtunën nga 25 deri në 34 gradë dhe të dielën nga 22 deri në 30 gradë Celsius. Moti sot do të jetë me vranësira të konsiderueshme

dhe me reshje të përkohshme të shiut, veçanërisht në pjesët perëndimore të vendit. Do të ketë edhe paraqitje të rrallë të bubullimave. Do të fryjë erë mesatare veriore e cila do të përforcohet përgjatë Luginës së Vardarit. Të mërkurën, moti do të jetë i

vranët me shi të kohë-paskohshëm, ndërsa paradite në perëndim ende do të ketë kushte për shi lokal. Nga e enjtja moti do të jetë me diell me vranësira të vogla dhe i qëndrueshëm me rritje të konsiderueshme të temperaturës.

## Projekt për konsolidim të tokës bujqësore

Shkup, 8 maj - Katër grupe të reja në të paktën 1.000 hektarë të tokës bujqësore me qëllim të konsolidimit së tyre, pritet të realizohen në 3,5 vitet e ardhshme me projektin "Vendosje e programit kombëtar për konsolidim". Projekti zyrtarisht filloi të hënën dhe është i financuar nga BE-ja me 2,5 milionë euro, ndërsa e realizon FAO. Parashikon përfundim të kapaciteteve teknike dhe administrative të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave (MBPEU), por, megjithatë, efektet kyçe, siç u tha në pres-konferencën promovuese, janë drejtpë-

drejtë të orientuara drejt prodhuesve, pronarëve të parcelave. "Struktura e pavolitshme momentale e tokës bujqësore e përbërë nga sipërfaqe të vogla, të fragmentuara, negativisht ndikon ndaj ekonomisë, të ardhurave dhe përfitimit të ekonomive bujqësore. Madhësia mesatare e parcelave për një ekonomi është 1,85 hektarë ose jashtëzakonisht nën mesataren evropiane prej 16 hektarë. Rreth 60 për qind e të gjithë ekonomive bujqësore në vend përpunojnë më pak se një hektar, ndërsa madje 90 për qind më pak se tre hektarë", theksoi këshilltari shtetëror në MBPEU



Perica Ivanovski. Kjo, shtoi, nuk e reflekton gjithë problemin sepse në mënyrë plotësuese, pronat e vogla bujqësore janë fragmentuar në pesë dhe më shumë parcela të largëta hapësinore me madhësi prej vetëm 0,2 hektarë. "Për shkak të imtësimi, një pjesë e

madhe e parcelave nuk kanë qasje deri në rrugë dhe deri te sistemet për ujë dhe tharje. Përpunimi i kapacitetit të këtyre tokës e limiton vëllimin e prodhimit, i rrit shpenzimet, pamundëson zbatim të masave bashkëkohore agroteknike dhe teknologjisë moderne,

e pengon hyrjen e subjekteve të reja në biznes. ndërsa ai ekzistues e bën ekonomikisht të paqëndrueshëm", theksoi Ivanovski.

Sipas Mauro Di Veroli, udhëheqës i Sektorit për infrastrukturë, bujqësi dhe politikë sociale, Maqedonia ndërmerr hapa për konsolidim të tokës, progresi është evident, por duhet ende të punohet në këtë drejtim. Edhe Morten Hartvingsen nga FAO theksoi se hapat kryesor janë ndërmarrë. Duke e prezantuar shkurt projektin Vilma Daugaliene nga FAO tha se aktivitetet e planifikuara u dedikohen zgjidhjes së problemeve të

bujqve të cilët kanë parcela të imëta, të braktitura, ndërsa rezultati konkret është që të ndihmohet që Ministria t'i bëjë hapat përfundimtar në konsolidimin e tokës përmes përfundimit të kapaciteteve. Maqedonia ka miratuar Strategji kombëtare për konsolidim të tokës bujqësore për periudhën 2012 - 2020, si dhe Ligj për konsolidim në vitin 2013. Në kuadër të MBPEU-së, madje, është formuar edhe sektor i veçantë për këtë sferë. Njëherit po përfundojnë dy projektet - për konsolidim të 360 hektarëve në Egri, Komuna Manastir dhe të 32 hektarëve në Konçe.

## Grante të vogla për përfaqësim dhe gazetari hulumtuese

Shkup, 8 maj - Tre organizata jo-qeveritare nga Negotina, Kumanova dhe Tetova kanë marrë grante në kuadër të projektit "Media platformë për përfaqësim" me qëllim të zbatimit të fushatave të përbashkëta për përfaqësim të organizatave civile dhe gazetarët në rajonin verilindor, të Vardarit dhe të rajonit planor të Pollogut. Asociacioni qytetar MOST, i cili është implementues i projektit informoi se organizata Ekovita nga Negotina, Civis nga Kumanova dhe Shoqata për paralizë cerebrale nga Tetova në bashkëpunim me mediat lokale, kanë marrë mbështetje financiare që të zbatojnë projekte në kohëzgjatje prej 6 muajve në rajonet përkatëse, në tema të ndërlidhura me mbrojtjen e mjedisit jetësor dhe të drejtave të njeriut. Qëllim i thirrjes ka qenë që t'i nxitë organizatat civile dhe gazetarët që të punojnë bashkërisht në zhvillimin dhe zbatimin e fushatave për përfaqësim, të cilët targetojnë çështje që dalin nga bashkësitë lokale, ndërsa janë me rëndësi për inkuadrimitin drejt BE-së. Mbështetja financiare ka për qëllim që ta nxitë bashkëpunimin mes organizatave civile nga njëra anë dhe gazetarët/mediat nga ana tjetër, të cilët përmes partneriteteve të krijuara dhe bashkëpunimit duhet t'i shpërblejnë kapacitetet e tyre dhe të kontribuojnë në zhvillimin e gazetarisë hulumtuese në Republikën e Maqedonisë. Këto janë grantet e para të vogla, të cilat do të ndahen, ndërsa në kuadër të projektit është parashikuar që të ndahen edhe 7 grante për përfaqësim të organizatave lokale dhe mediave. Në trajnime është promovuar edhe platforma www.getdata.mk, e cila paraqet mjet për gazetarë dhe organizata civile, të cilët punojnë në hulumtime të ndërlidhura me korrupsionin dhe sundimin e drejtësisë. Trajnimi i ardhshëm rajonal do të mbahet në Rajonin e Shkupit, për çka është hapur thirrje për paraqitje. Projekti "Media platformë për përfaqësim" është financuar nga Bashkimi Evropian, përmes IPA programit për shoqëri të reja dhe mediat.



Modifikimet në kundërshtim me ligjin

# Motoçikletat me rimorkio, potencial rreziku

Aksidenti i ndodhur së fundmi në qytetin e Gostivarit, kishte kosto të lartë shëndetësore për pronarin e motoçikletës së modifikuar, me ç'rast humbi një rënë këmbë si pasojë e goditjes nga makina në lëvizje

Koha Driton ZENKU

Gostivar, 8 maj – Prania e motoçikletave të modifikuar po vështirëson qarkullimin në trafikun urban. Dikur kanë qenë motoçikleta që shërbenin për lëvizjen e një apo dy personave, ndërsa sot janë modifikuar në mënyrë të atillë duke ju vënë rimorkio që shërbejnë për transport dhe shitje mallrash. Këtu situata bëhet e vështirë dhe alarmante. Aksidenti i ndodhur së fundmi në qytetin e Gostivarit, kishte kosto të lartë shëndetësore për pronarin e motoçikletës së modifikuar, me ç'rast humbi një rënë këmbë si pasojë e goditjes nga makina në lëvizje. Ngjarja ndodhi te ura e lumit Vardar afër thetores së qytetit. Në kundërshtim të çdo ligji dhe rregulli këto motoçikleta të modifikuara qarkullojnë në trafik ditën apo natën duke rrezikuar jo vetëm jetën e përdoruesve por edhe te qytetarëve apo drejtuesve të mjeteve që lëvizin në rrugë. Pa asnjë shenjë këta motoçikleta që sot nuk mund t'i quash të tilla, ecin në çdo rrugë të



qytetit dhe askush nuk i ndalon apo pengon që të dalin në rrugë. Rritja e temperaturave dhe për pasojë prania e motoçikletave në komunikacion, po shndërrohen në makth të vërtetë për drejtuesit e automjeteve dhe këmbësorët. Lëvizja e pakontrolluar e tyre, por edhe drejtimi nga persona adoleshentë dhe pa leje të posaçme qarkullimi, ka bërë që gjatë pranverës dhe verës, burim kryesor aksidentesh në trafikun urban të Gostivarit të jenë pikërisht motoçikletat. Regjistrimi i motoçikletës, posedimi i lejes për vozitje si dhe përgatitjet e posaçme dhe respektimi i rregullave në komunikacion, janë ndër

kushtet të cilat policia i kërkon nga drejtuesit e motoçikletave. Në të kundërtën, policia paralajmëron dënime të ashpra. Me rritja e prezencës së skuterëve në komunikacion gjatë periudhës së verës, policia e Gostivarit apelon deri te drejtuesit e tyre që maksimalisht të respektojnë rregullat e trafikut. Ato rikujtohen edhe në obligimet ligjore me të cilat obligohen t'i respektojnë në ofitë se frekuentojnë komunikacionin. Mungesa e ndonjë jërës nga kriteret e parapara me ligj mund të godas gjeprat e motoristëve nga 300 deri 500 euro. Krahas motoçikletave personale, shumica e të rinjve deri te motoçikletat

vijnë duke i marrë me qira për orë të caktuara, nga firma të caktuara të cilat ushtrojnë veprimtarinë e tyre në të zehtë. Policia bën me dije se gjatë kësaj periudhe, motoristët do të ndiqen në hap dhe do të përcillet çdo lëvizje e tyre dhe nëse vërehet ndonjë lëshim, pa dallim se bëhet fjalë për të rritur apo të mitur, predispozitat ligjore do të respektohen deri në fund. Nga Policia e Gostivarit thonë se vazhdimisht ndodhen në terren dhe është duke mbikëqyrur lëvizjen e biçikletave dhe motoçikletave në komunikacion, dhe për çdo parregullsi, policia do të vepron bazuar në predispozitat ligjore.

Mbledhje komemorative kushtuar Hazbi Idrizit

## Ishte kryetar shumë i respektuar

Tetovë, 8 maj - Dy ditë pas vrasjes së kryetarit të Komunës së Bogovinës, Hazbi Idrizi, është mbajtur mbledhja komemorative në shkollën fillore Abdyl Frashëri të fshatit Bogovinë. Në këtë mbledhje komemorative kanë marrë pjesë familjarë, miq, bashkëpunëtorë dhe kryetarë të komunave të Pollogut. Pjesëtarët e familjes së tashmë të ndjerit Hazbi Idrizi, janë shprehur se akti tragjik që i ndodhi kësaj familje, ka tronditur ata si familje dhe jo vetëm ata, por edhe më gjerë. Por, ata nënvizuan se kjo ngjarje shumë e rëndë me kaq mbyllet për dy familjet.

“Për rastin makabër që ndodhi, dua të them se na ka tronditur të gjithëve, ne nuk do t'ju lodhim, ai që bëri krimin zoti do ta gjykojë sepse ka vrarë njeriun e pafajshëm. Sa i përket anës sonë, ne nuk kemi asgjë me familjen e tij, për shkak se ai që e bëri këtë e bëri dhe



pastaj vrau veten e tij dhe zoti ta gjykojë, sepse zoti është i madh dhe ne besojmë në zot”, tha Idriz Zejnuli, vëllai i Hazbi Idrizit, kryetarit tashmë të ndjerë të Komunës së Bogovinës. Para të pranishmëve, në emër të kryetarëve të komunave, fjalë mbajti kryetari i kryetari i Komunës së Gosti-

varit, Nevzat Bejta. “Nuk besoj që kishim ndonjë kryetar tjetër më të përgatitur në radhët e shqiptarëve, por edhe të tjerëve. Jo vetëm ne e respektonim si shqiptarë, ai respektohej edhe nga kryetarët e komuniteteve të tjera, për shkak se ishte i përgatitur profesionalisht dhe e njihte mirë punën e

administratës, ekonomisë dhe financave. Këshillat e tij, ne si kryetarë komunash, i zbatonim në komunat tona, dhe ndoshta shumë pak e kanë ditur që Hazbi Idrizi i ka pasur të gjitha këto veti”, tha Bejta, duke shtuar që tani që ndërroi jetë, administrata e Komunës dhe banorët e Bogovinës humbën njeriun e tyre më të dashur”, tha Bejta. Përndryshe, me vendim të këshillit të Komunës së Bogovinës, në territorin e kësaj komune, është shpallur tre ditë zi ku në institucionet që janë pjesë e komunës janë ulur flamujt në gjysmë shtizë. Përndryshe, të shtunën paradite Bogovina u përfshi në një ngjarje të rëndë, kur me gjashtë plumbat u qëllua për vdekje kryetari i Komunës së Bogovinës Hazbi Idrizi, nga Qani Abazi pas një zënke që kishin pasur mes vete. Më pas edhe vet qëlluesi kishte vrarë veten e tij. (u.h.)

Mezi sigurojnë rrogat



• Qatip Besimi

## Kryqi i Kuq pa mjete nga shteti

Drejtues të Kryqit të Kuq në Tetovë ankohen se mos ndarja e mjeteve nga ana e shtetit, ka sjellë në pikëpyetje funksionimin e kësaj organizate

Koha Urim HASIPI

Tetovë, 8 maj - Gjendja e Kryqit të Kuq në Tetovë gjithnjë e më shumë bëhet më e vështirë. Mungojnë mjetet nga buxheti i shtetit, ndërsa edhe ato aktivitete që organizohen, bëhen me vetëfinansim. Drejtues të Kryqit të Kuq në Tetovë ankohen se mos ndarja e mjeteve nga ana e shtetit, ka sjellë në pikëpyetje funksionimin e kësaj organizate.

“Shteti për Kryqin e Kuq ndan 0 mjete. Ne jemi me vetëfinansim dhe, për fat të keq, nuk mund që t'i realizojmë ato obligime programore që i kemi për shkak të mungesës së mjeteve financiare dhe kjo situatë është në të gjithë Kryqin e Kuq të Maqedonisë. Ne nuk financohemi prej buxhetit të shtetit dhe nuk mundemi që ne vet t'i sigurojmë mjetet dhe kemi një barrë të rëndë për t'i siguruar mjete për të ekzistuar e mos të bëjmë fjalë për aktivitete”, thotë Qatip Besimit, drejtor i Kryqit të Kuq - Tetovë. Sipas tij, në rrezik janë edhe sigurimi i rrogave për të punësuarit në Kryqin e Kuq të Tetovës, ngase edhe rrogat sigurohen përmes aktiviteteve apo vetë financimit. “Janë katër të punësuar, por mendoj se edhe këta janë të tepërt për shkak se ne nuk kemi mjete financiare, nuk financohemi prej shtetit, ne jemi me vetëfinansim dhe nuk mund që të durojmë tempin e aktiviteteve që i bën Kryqi i Kuq për shkak se për çdo gjë duhet që të sigurohen mjete financiare”, tha Besimi.

Edhe përkaj vështirësive, megjithatë kjo organizatë arrin në bashkëpunim me shumë institucione tjera, që të sigurojë gjak për nevojat që ka spitali i Tetovës. “Aksionet e grumbullimit të gjakut i kemi me program vjetor. Varësisht prej situatës në teren, ne i realizojmë të gjitha aksionet që janë të parapara me programin vjetor dhe i kalojmë të gjitha shkollat e mesme në Tetovë, universitetet dhe organizata publike që janë në Tetovë, siç janë komuna, gjyqi, të gjitha këto që janë të parapara në programin vjetor”, shprehet drejtuesi i kësaj organizate. Megjithatë, Besimi, nënvizon se asnjëherë pacientët nuk kanë pasur mungesë të gjakut. “Ky gjak i grumbulluar nga këto aksione që ndërmarrim ne, i plotëson nevojat e të sëmurëve dhe të lënduarve në rrethinën e Tetovës në Spitalin klinik dhe në klinikën e Shkupit, për shkak se ne e kemi edhe obligim që për pacientët tonë të sigurojmë gjak edhe për pacientët tonë që kërkojnë ndihmë në klinikën e Shkupit, dhe deri më tani nuk kemi pasur ndonjë pengesë që të anulohet ndonjë operacion për shkak të mungesës së gjakut, nuk ka ndodhur që ndonjë pacient të mos shërohet në kohë për shkak të mungesës apo pritjes së gjakut gjithmonë gjaku e ka pritur të sëmurin. Meqenëse në numër ne jemi më pak në krahasim me komunat tjera në Republikën e Maqedonisë por i plotësojmë nevojat e Tetovës me rrethinë në klinikën spitalore të Tetovës dhe në klinikën e Shkupit”, deklaroi Qatip Besimi.

Për dallim nga e kaluara kur Kryqi i Kuq ishte në ballë të të gjitha aksioneve humanitare, tashmë roli i Kryqit të Kuq është zbehur dukshëm, pikërisht për shkak të mos interesimit të shtetit.







Të rinjtë e Kërçovës me shumë pak shpresa

# “Fundi i gotës” si shpresë për perspektivë

fenomeni i përdorimit të pijeve alkoolike, në veçanti në mesin e të rinjve, është dukuri që po shqetëson opinionin e Kërçovës. Kabaretë dhe lokalet e natës po mbijnë si “kërpudhat pas shiut” dhe me këtë ngadalë dhe pahetueshëm po ngritët edhe numri i vartësve nga pijet alkoolike dhe lëndëve të tjera vartëse

Koha Adem XHELADINI

Kërçovë, 8 maj - Kriza ekonomike, që po prek thellë në trungun e rinisë në Kërçovë, ngadalë dhe pahetueshëm po krijon vartës të rinj nga shprehjet e këqija. Tanimë përpos rrugës së “zbrazjes së Kërçovës” nga gjenerata e re, si pasojë e mospasjes së perspektivës dhe mosgjatjes së shtegut për të zënë filllet e një jete normale, ajo ia ka mësyre në mënyrë marramendëse rrugës së kurbetit, ku sigurojnë të ardhmen e tyre, dhe një mirëqenie për një jetë të dinjitetshme. Megjithatë, shtresa tjetër e të rinjve, të cilët nuk kanë “fatin” e këtyre të parëve, “shpresën” për t’i ikur zhgënjimit të tyre e kërkojnë në forma të tjera, siç janë pirja e duhanit, prova e konsumit të pijeve alkoolike, po edhe e provës së fatit nëpër lojërat e fatit nëpër kazinotë e shumta, është bërë një fenomen që po tërheq të rinjtë, krahas atyre të



vjetërve, që të jenë edhe ata pjesë e klientelës së rregullt të këtyre formave të organizimit.

Tashmë, fenomeni i përdorimit të pijeve alkoolike, në veçanti në mesin e të rinjve, është dukuri që po shqetëson opinionin e Kërçovës. Kabaretë dhe lokalet e natës po mbijnë si “kërpudhat pas shiut” dhe me këtë ngadalë dhe pahetueshëm po ngritët edhe numri i vartësve nga pijet alkoolike dhe lëndëve të tjera vartëse, siç janë duhani, dhe lëndët tjera narkotike. Për t’i ikur këtij fenomeni, që pa vetëdije po gllabëron shtresën më të ndjeshme të shoqërisë, domethënë të rinjtë, kohë më parë në gjimnazin e Kërçovës dhe nëpër shumë shkolla fillore, SPB e Ohrit dhe stacioni policor i Kërçovës, me arsimtarët e kësaj qendre arsimore, kanë mbajtur orë informuese, ku është bërë njoftimi me masat parandaluese që duhet të ndër-

merren lidhur me mbrojtjen e të rinjve nga lëndët narkotike. Konstatimi i përbashkët gjatë këtyre takimeve mes punonjësve të policisë dhe profesorëve ishte, se mjerisht ky fenomen është i pranishëm edhe në Kërçovë. Përpos, “konsumimi të lëndëve narkotike”, në Kërçovë me të madhe ka filluar të rritet edhe numri i të rinjve të cilët përdorin pijet alkoolike. Kur jemi tek struktura gjinore e kësaj shtrese të popullsisë, nuk ka ndonjë dallim. Konsumatorët të alkoolit ka nga të dyja gjinitë që përpara nuk ka qenë dukuri që edhe vajzat të jenë konsumatorë të rregullta të alkoolit. Në njësinë e urgjencës pranë Qendrës mjekësore të Kërçovës, njoftojnë se “numri i të helmuarve nga konsumimi i pijeve alkoolike është në rritje, sidomos gjatë vikendeve, ku nëpër kabaretë dhe klubet e natës, që

në Kërçovë nuk janë të pakta, bëhet konsumim i pakontrolluar i pijeve alkoolike.” Ndonëse, nëpër çdo lokal hotelier janë të ngjitura mbishkrimet “ndalohet shërbimi dhe shitja e pijeve alkoolike të personave nën 18 vjeç”, kjo dukuri po merr përmasa shqetësuese.

Specialisti i mjekësisë familjare Dr. Ibrahim Ramadani nga ordianca e Zajazit, shprehet se “përdorimi i pijeve alkoolike, sidomos në sasi të pakontrolluara, po edhe në mesin e të rinjve, është një çështje me rrezik. Përpos dëmeve në shëndetin e vetë konsumatorëve dhe rrezikut të drejtpërdrejtë, në radhë të parë për vetë ata, pastaj rreziku shtrihet edhe në shtresat e gjera të shoqërisë, ku një numër i konsiderueshëm, më pastaj i grahim makinës në gjendje të dehur dhe kësh-tu të shkaktojnë pasoja me përmasa të paparashikueshme, ku shpesh

aksidentet me pasoja humbjen e jetës janë evidente dhe të pashmangshme”. Konsumimi i alkoolit, shpesh po shihet si dukuri, ku të rinjtë “përpos që duan të provojnë një botë ndryshe”, shfaqet edhe si modë në mesin e tyre dhe si mënyrë për të hequr qafe problemet e përditshme, të cilat nuk mund të kenë zgjidhje “në fundin e gotës”. Nevoja e organizimit të këshillimeve, mbajtjes së orëve mësimore nëpër shkolla, po edhe aktivizimi i sektorit joqeveritar, përpos institucioneve, të cilat edhe e kanë për detyrë, është më se e pashmangshme dhe nevojitet që sa më parë të ndërmerren masa, për t’i dalur përballë këtij fenomeni shqetësues. “Nëpër orët e kujdestarisë, janë paraparë orë mësimore, ku nxënësit njoftohen me efektet e dëmshme nga përdorimi i alkoolit, duhanit dhe lëndëve të tjera që

sulmojnë shëndetin e njeriut. Po sërish kjo nuk mjafton dhe nevojitet edhe një sensibilizim i opinionit, duke u organizuar edhe ligjëratat me të rinjtë si dhe rritja e kontrollit nga organet përkatëse nëpër lokalet ku edhe shërbehen këto lloje të pijeve, të cilat drejtpërdrejt sulmojnë shëndetin e të rinjve”, thekson Gafurr Ajruli, profesor i biologjisë pranë gjimnazit “Drita”.

Pasoja e konsumimit të alkoolit, i kanë bërë publike edhe nga shërbimi policor i Kërçovës, ku kanë paralajmëruar një shifër në rritje të shoferëve të cilët kanë vozitur nën ndikimin e alkoolit, dhe ndaj të cilëve janë ngritur edhe procedura ndëshkuese, sepse ata drejtpërsëdrejti kanë ndikuar në rritjen e rrezikut në komunikacion. Përdorimi i alkoolit, të shpeshtën ka rezultuar edhe me dhunën në familje, ku ka pasur edhe pasoja të zënkave të ndryshme familjare, të cilat kanë nxitur edhe konflikte dhe përdorim të pakontrolluar të dhunës ndaj të tjerëve, kanë potencuar nga shërbimi policor i Kërçovës. Sidoqoftë, është koha e fundit që këtij fenomeni, t’i dilet përpara dhe në mos të çrrënjoset plotësisht, së paku ai të zbutet në përmasat e të tolerueshmes. Lidhur me këtë përpos shkollave dhe institucioneve tjera përgjegjëse, një rol tejet të rëndësishëm mund ta luajnë edhe prindërit, të cilët do të duhet ta rrisin kontrollin ndaj fëmijëve të tyre.

Probleme të shumta në lëmin e mjedisit jetësor

## Dibra pa deponi për mbeturinat e ngurta

Persona dhe firma të pandërgjegjshëm ndotin komunën me mbeturinat inerte, sepse askush nuk ua tërheq vërejtjen, as nga institucionet kompetente, pasi rrallë ndodhë që ndokush nga kjo kategori të paditet për këtë çështje

Vjollca SADIKU

Dibër, 8 maj - Problemi i mbeturinave inerte në qytetin e Dibrës është një problem shqetësues. Aktualisht mbeturinat e ngurta vazhdojnë të hidhen në deponinë e qytetit, por edhe në shumë lokacione në periferi të tij. Ekologët me të drejtë thonë se për çdo ditë bëhet një ndotje e ambientit jetësor me pasoja të rënda. Në deponinë e qytetit edhe me dije të kompetentëve bëhet hedh-



ja e mbeturinave të ngurta të disa kompanive, gjë që dukshëm irriton shoqatat ekologjike.

Për problemin në fjalë u debatua edhe në Këshillin e Komunës Dibrë. Këshilltarët nga përfaqësuesit të Ndërmarrjes komunale publike “Standardi” kërkuar që të

ndalohet tërësisht hedhja e mbeturinave inerte në deponinë e qytetit dhe kërkuar të ndërmerren aktivitete dhe masa për të krijuar një deponi për mbeturinat e ngurta. Është ky një problem shumë serioz, i cili kërkon zgjidhje, u theksua në seancën e Këshillit të Ko-

munës. Përfaqësuesi i Ndërmarrjes “Standardi”, e cila menaxhon me mbeturinat, Omer Cami, pranon se nuk duhet të hidhen mbeturinat inerte në deponinë e qytetit, por sqaruan se nuk ka mjete për ndërtimin të një deponie vetëm për mbeturinat e ngurta. Mbeturinat e

ngurta sot mund t’i gjejmë shumicë edhe në deponinë e qytetit, por edhe në shumë pjesë të tjera të komunës, siç janë bregu i Liqenit të Dibrës, vendet turistike, por edhe në afërsi të lumenjve dhe përroskave të komunës, siç janë Radika, Drini i Zi etj. Bashkim Mashkulli, kryetar i Këshillit të Komunës, thotë se këshilltarët me të drejtë debatuan rreth këtij problemi, i cili me të vërtetë është shqetësues. Persona dhe firma të pandërgjegjshëm ndotin komunën me mbeturinat inerte, sepse askush nuk ua tërheq vërejtjen, as nga institucionet kompetente, pasi rrallë ndodhë që ndokush nga kjo kategori të paditet për këtë çështje.

Nga ana tjetër, sidomos gjatë pranverës dhe verës, kur dukshëm shtohet puna e investitorëve në lëmin e ndërtimit, derdhja e mbeturinave të ngurta është prezent në shumë lokacione. Sasi të

mëdha të mbeturinave inerte mund të shihen këto ditë edhe në afërsi të rrugëve rajonale dhe lokale, jo vetëm në afërsi të qytetit, por edhe në afërsi të vendbanimeve rurale. Këshilltarët kërkuar masa urgjente për ndërtimin e një deponie. Në seancën e Këshillit u ngrit edhe çështja e riciklimit të mbeturinave dhe u propozua që Ndërmarrja “Standardi” të fillojë me riciklimin e mbeturinave në një lagje të Dibrës, si pilot projekt.

Por, kur behet fjalë për problemin e mjedisit jetësor, duhet theksuar edhe faktin se qyteti nuk posedon as deponi për mbeturinat mjekësore, të cilët nga institucionet shëndetësore mbarojnë në deponinë e qytetit. Duke marrë parasysh se çdo mbeturinë përfundon në deponinë e qytetit, atëherë është shumë e qartë se deponitë e tilla shndërrohen edhe në vatër të sëmundjeve të ndryshme.

# Greçia si Rusia trash zërin për Maqedoninë... pse ka mbetur pa rol rajonal



Mentor NAZARKO

Ndaj zhvillimeve të fundit në Maqedoni nuk mund të rrinte pa folur dhe Greçia. Folën gjithë aktorët më të rëndësishëm ndërkombëtarë, përfshi dhe Rusinë, e cila e vinte gishtin në faktorin shqiptar si faktor shkatërrues për fqinjin tonë. Dhe më në fund foli dhe fqinji ynë jugor nëpërmjet ministrit të jashtëm Kotzias, i cila ndërta i përmbahet deklarativisht politikës së mosndërhyrjes, praktikisht foli për ruajtjen e karakterit unitar të shtetit maqedonas. Po për kë e ka fjalën Greçia kur flet për politikën e mosndërhyrjes, të cilën pretendon se e ka respektuar si askush tjetër në Ballkan? Me siguri e ka për Shqipërinë, e cila akuzohet nga partia e Gruevskit si palë që ka

**Zërave të tjerë ndërkombëtarë për zhvillimet në Maqedoni iu shtua Greçia. Pa përmendur shqiptarët në kontekst negativ, Greçia i trembet faktorizimit shqiptar**

ndikuar në të ashtuquajturën Platformë të Tiranës.

Kush janë kërcënuesit e karakterit unitar të Maqedonisë? Dhe çfarë nënkupton ky karakter unitar sipas politikës së jashtme greke? Mosndryshimin e kushtetutës së Maqedonisë, mosfederalizimin e saj, apo në përgjithësi mosavancimin kushtetues të drejtave të shqiptarëve atje? Për këtë po flitet më shumë në fakt, dhe me gjasë Greçia e ka saktësisht për këtë temë. Kur Greçia flet për ruajtje të karakterit unitar, do duhet të kujtohem në fakt se këtë term e ka përdorur presidenti Ivanov si kundërvënie ndaj LSDM-së, dhe liderit të saj Zaeve, të cilit nuk po i jep mandatin e krijimit të

qeverisë pse e akuzon se po zbaton platformën e Tiranës. Nga Greçia, po ashtu në mënyrë kritike ndaj Shqipërisë dhe shqiptarëve, ka folur dhe një lider tjetër i Syrizas, i cili e ka parë përfshirjen e krerëve të vendit në zhvillimet në Maqedoni si një mënyrë për të shmangur vëmendjen nga problemet e brendshme. Dhe ky zë grek do duhet quajtur gjithashtu një zë zyrtar.

Në fakt, në lidhje me zhvillimet maqedonase nuk ka folur vetëm një zë zyrtar grek, apo dhe dy, por dhe një ambasador me eksperiencë, i angazhuar në atë që është OJQ-ja më serioze greke e politikës së jashtme, një lloj instituti zyrtar i studimeve strategjike greke, ELIAMEP, ambasadori Aleksandër Mallias, që ka punuar në Tiranë, por dhe në Uashington. Në një artikull të publikuar dhe në Konica.al, me titull 9 të verteta mbi krizën e Shkupit, Mallias, i njohur për qëndrimet e veta realiste ndaj faktorit shqiptar në Ballkan, thotë disa të vërteta të tjera alternative me

qëndrimin e kancelarisë greke. Ai, në fakt, e gjen origjinën e krizës tek parabazat e faktorit shqiptar në Maqedoni, faktor i cili duhet nxitur të arrijë më shumë, të përfshihet në negociatat me Greçinë për emrin, etj., etj. Mallias, në mënyrë diplomatike siç është zakoni, e quan të dobishme deklaratën e ministrit të jashtëm të vendit të tij, por duket se vë theksin vetëm tek politika e re greke e mosndërhyrjes.

## Realizmi grek, përballë rreshtimit tradicional grek ndaj shqiptarëve

Sepse në gjithçka tjetër, Mallias është praktikisht në kundërshtim me qëndrimin zyrtar grek. Në të vërtetë, vetë qëndrimi zyrtar grek është kontradiktore në vetëvetë dhe shumë ndërhyrës, gati protektiv: nëse je me politikën e mosndërhyrjes, atëherë nuk ke arsye pse të jesh kritik ndaj vullnetit të palëve të caktuara në Maqedoni që duan avancim kushtetues të të drejtave të shqiptarëve që

mund të arrijë deri në federalizim. Pse Greçia duhet të jetë kundër federalizimit për shembull, nëse atë e duan vetë faktorët politikë maqedonas, pavarësisht origjinës së tyre etnike?

Ky shkrim rreket thjeshtë të kuptojë arsyet e këtij qëndrimi grek në këtë kohë dhe jo të bëjë kritikën e tij. Politika zyrtare greke ndjek interesat kombëtare të vetat, sipas vizionit të partisë politike apo koalicionit në pushtet. Dhe ja disa cilësi të këtij vizioni aktual të politikës së jashtme greke, ballafaquar me një zë realist grek. Së pari, politika greke rreshtohet një lloj si politika ruse, e cila e sheh rrezikun e destabilizimit të Maqedonisë tek faktori shqiptar. Rusët, për arrogancë prej të madhi, janë më konkretë, duke thënë se fantazma e Shqipërisë së madhe është problemi, kurse grekët, më të ndrojtur flasin «për ruajtje të karakterit unitar të shtetit», që i bie se kërcënohet nga shqiptarët. Në këtë pozicionim grekët janë qartazi jashtë linjës së Ba-

shkimit Evropian, që nuk ka folur kurrë për ndonjë kërcënim shqiptar, sa kohë që platforma nuk ka asgjë që kapërcen madje dhe kushtetutën e Maqedonisë. Po ajo që nuk pranon Greçia, si duket, është aktivizimi i Tiranës, i qeverisë së saj, i kryeministrit Rama, i cili ka arritur një lloj kompaktësimi të faktorit shqiptar në Maqedoni. Kah avancimi i statusit të tyre kushtetues.

E pikërisht në këtë rol të Tiranës nuk sheh asgjë problematike ambasadori Mallias. Ai, madje, kur flet për rol të Greçisë në Ballkan, kërkon që ajo të merret vesh me shqiptarët në bllok, pra të realizohet një marrëveshje midis dy kombeve, që të parashikojë shkëmbime të tipit: ju njohim Kosovën, por na jepni kufirin detar, etj., etj. Pavarësisht përmbytjes së marrëveshjes që propozon Mallias, lloji i negociimit ngjan racional: faktori shqiptar të paraqitet në një tryezë rajonale, bashkë. Imagjinoni, parë nga Greçia, ne (Shqipëria, Kosova, partitë shqiptare në Maqedoni) mund të



Lumir ABDIXHIKU

## Vlimi ballkanik dhe mençuria jonë

**Tendencave ruse u duhet e u mungon veç një reagim zinxhiror. Dhe vetëm një komb ka mundësi të japë këtë reagim prej zinxhiri — janë pikërisht shqiptarët**

**1.** Një vlim Ballkanik që po ngjanë – e do të ngjajë edhe për një kohë të gjatë – është pikërisht çfarë ishte paraparë në profecinë e një BE-je, që zgjerimin e saj nuk e ka më prioritet. Në momentin e parë që ky zgjerim është ngrirë e vënë në rend të dytë, kanë nisë çarjet e një harte me fushëbeteja gjithandej. Çarja më e madhe, tani për tani, ndodhë në Maqedoni; dhe të njëjtës provohet t'i jepet karakter etnik. Problemet ndëretnike në Maqedoni janë evidente. Maqedonia sot është shteti me albanofobinë më të institucionalizuar se secili shtet tjetër në rajon. Por pavarësisht të gjithave, përplasja atje është shumë më e gjerë sesa veçse etnike. Sepse edhe vetë shqiptarët e diskriminuar në Maqedoni janë në aleancë me një pjesë të maqedonasve etnikë. Pra betejën me pushtetin pa-

radiktatorial e kanë të për-bashkët. Në prapaskenë të nismës destabilizuese në Maqedoni është ballafaqimi i Rusisë me Perëndimin. Në të vërtetë, ky ballafaqim është i njëanshëm tani për tani, meqë Perëndimi ka kohë që është shndërruar në vëzhgues pa ndonjë ide se si duhet ta nxjerrë gjithë Ballkanin nga një rrugë qorre si kjo. Dhe do të mbetet vëzhgues përderisa nuk vendos të trajtojë Ballkanin në nivelet më të larta politike të saj, shumë më të larta se sa diplomatë të niveleve të mesme. Në një vështrim më të gjerë e në një hapësirë kohore pak më të gjatë, ka një patern të shënuar me konsistencë. Lodhja evropiane me Ballkanin Perëndimor, pak për shkak të rritjes së

tendencave joliberalë atje, e shumë për shkak të burokracisë së stër-rritur në Bruksel, ka krijuar një hapësirë të re për politikën ruse. Politika ruse, ndërta, nuk ka pretendime që Ballkanin Perëndimor ta përdorë si potencial për inkuadrim nëpër klubet e veta. Si një ishull i rrethuar me vende të NATO-s e të BE-së, një pretendim i tillë do të ishte edhe për standardet e Putinit, çmenduri. Rusia ka një mision krejt më të thjeshtë. Në thelb, misioni kërkon krijimin e trazirave – nën pretekstet e llojllojshme – trazira që më pas mbajnë të zënë e në telashe gjithë Perëndimin. Kjo do t'i jepte Rusisë kohë e hapësirë të zgjerorë influencën e vet rreth zonave gjeostrategjike të saj; në Ukrainë e Gjeorgji në radhë të parë, në Siri e Lindje të Mesme më pas. Sepse, në secilën llogaritje të mundshme, një konflikt i ri në mes të Evropës, do të vinte në prapaskenë të gjitha konfliktet në periferi të saj. Do t'i jepte Rusisë frymëmarrjen e kërkuar kaheerë.

**2.** Në paternin e tillë, Rusia ka përdorur e provon të përdorë skenarë të llojllojshëm, por që në thelb kanë për lëndë të parë ndasitë etnike. Në fakt, skenari i Maqedonisë ishte replikim i përpiktë i skenarit të dështuar në Mal të Zi. Atje, në komplozin e dështuar që rezultojë me mbi 30 arrestime të paramilitarëve serbë e rusë, shkalla e intervenimit të paraparë ishte shumë më e lartë. Me siguri për shkak të leximit se për të ngjallur konflikt në një vend para-anëtar i NATO-s do të duhej vrasje – deri tek ajo e kryeministrit. Në Maqedoni, ky skenar duhej të kishte më pak forcë. Sepse gjasat e përplasjes etnike në Maqedoni janë shumë më reale sesa në Mal të Zi. Pra, në skenarin destabilizues, do të mjaftonte një ndezje më e lehtë, pa armë të rënda sikurse në Mal të Zi, për të përshkallëzuar në konflikt gjithë territorin. Ndezja, për fat të mirë tonin, nuk ndodhi. Në skenarin rus ishte dhe provokimi i Serbisë në Veri të Kosovës.

Treni, fillimisht, më pas muri, kërkonin mu këtë përshkallëzim. Ishte dashë intervenim i nivelit më të lartë politik në BE, intervenim që mbërrinte deri tek kancelarja Merkel, për të parandaluar një konflikt të tmerrshëm ballkanian. Por provokimi i Serbisë nuk ndalet me kaq. Në të vërtetë, Serbia është vazhdimisht duke shtyrë tensionet ndëretnike në Ballkan. Edhe te politika e fletarrestimeve, edhe te politika e reagimit ndaj ngjarjeve në Shkup, edhe te politika e proklamimit të Shqipërisë së Madhe – deklaratat zyrtare në Serbi janë në vijë të plotë me ato të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Rusisë. Janë në sinkronizim perfekt në ton, përmbytje madje edhe në kohë të publikimeve. Një dualizim i tillë jep prapaskenë e qartë të koordinuesve. Deri më tani, dhe me siguri, si ruajtëse e letrës së fundit nuk është përdorur vetëm Bosnjë-Hercegovina; atje gjasat për përplasje ndëretnike janë shumë më të mëdha se sa në Maqedoni. Influenca bizneso-

re ruse është, po ashtu, më e theksuar e ndikimi i Perëndimit edhe më i ndarë. Çfarë s'bën kuptim në gjithë këtë skenar është vlimi që ndodhë në Tiranë. Ndoshta shqiptarët atje po i bëjnë një asist vullnetar e pa vetëdije qëllimeve destabilizuese ruse. Por, gjithsesi, stabiliteti në një vend të NATO-s, edhe po të jetë i tillë, është më pak i dëmshëm sesa në vendet e tjera ballkanase.

**3.** Në një vlim të tillë është e pamundur të mos kontaminohemi dhe ne. Natyrisht se do të ndikohen investimet tona, stabiliteti ynë, projekcioni i Kosovës – çfarëdo qoftë ai. Në fund të ditës para forcave të mëdha integruese, ne shihemi krejt si një rajon. Pra izolimi ynë është i pamundur. Por është shumë e mundur të sillemi mençur sa për të mos bërë asist në një përshkallëzim të tillë. Mos të harrojmë; pjesa më e madhe e provokimeve ruse bëhen për qëllim të nxitjes reaguese të shqiptarëve. Tendencave ruse i

rrimë bashkë në një tavolinë. E pse vallë, parë nga Shqipëria s'mund të rrimë bashkë? Mallias (prej vitit 1999 ka analiza si kjo) pranon në analizën e tij konsekuente rritjen e peshës së faktorit shqiptar në Ballkan, ndaj ai propozon që duhet bërë marrëveshje me të. Politika zyrtare greke ngjan se jo, se nuk don ta pranojë këtë peshë.

**Arsyet greke**

Ka një arsye pse politika aktuale greke nuk e pranon këtë faktorizim shqiptar (dy shtete, Shqipëria, anëtare e NATO-s, afër BE-së, marrëdhënie aliance me Perëndimin) që e bën me realizëm Mallias. Ai po ndodh kur politika e jashtme greke është defaktorizuar si pasojë e krizës ekonomike greke. Dhe mjerisht kjo përpjekje e druajtur për rifaktorizim, e kamufluar si mosdërhurje, po shfaqet nëpërmjet një deklarate kundërvënëse ndaj shqiptarëve në Maqedoni, por dhe në rajon. Ky rifaktorizim po ndodh në fakt dhe nëpërmjet një rishikimi rrënjësor të pozicionit grek ndaj faktorëve politikë maqedonas. Dhe këtu Mallias është prapë realist-ai mbetet kundër Gruevskit. Deklarata zyrtare greke e pozicionon Greqinë pro mbrojtësve të karakterit unitar të shtetit, ku rreshtohet Gruevski, Ivanovi, njerëzit që e kanë bllokuar zgjidhjen e çështjes së emrit, hyrjen e Maqedonisë në NATO, etj., etj. Në këtë rreshtim, madje, politika zyrtare greke e formuluar dhe ekzekutuar nga të majtë, nuk është as e pozicionuar majtas kah Zaevi, që është socialdemokrat. Pse vallë? I vetmi element që mund të shpjegojë pozicionimin e fundit grek është padurimi ndaj faktorizimit të shqiptarëve në një aleancë tjetër politike me LSDM-në dhe mbrojtja që i bën perëndimi atyre. Dhe këtu përsëri Mallias nuk është dakord. Ndaj mjafton kritika e tij jo e drejtpërdrejtë për të shpjeguar pse Greqia nëpërmjet përpjekjes për rifaktorizim, krahas humbjes së terrenit në Shqipëri, në Serbi eventualisht apo në Mal të Zi, po humb shansin ta fitojë në Maqedoni. Sepse shqiptarët atje, po flasin me një zë, madje me ndihmën e Shqipërisë. Dhe të Perëndimit! (konica.al)

duhet e i mungon veç një reagim zinxhiror. Dhe vetëm një komb ka mundësi të japë këtë reagim prej zinxhiri – janë pikërisht shqiptarët pra. Rusia e di mirë se një përshkallëzim në Maqedoni, nuk mund t'i mbajë inferiorë shqiptarët në Kosovë e Shqipëri. E di se një përplasje në Veri nuk do të izolojë reagimin e shqiptarëve të tjerë në tjetër shtet. Mbi të gjitha e di se shqiptarët s'mund t'i ketë aleatë asnjëherë, prandaj i ka në thelb të provokimeve të para. Shqiptarët në Kosovë duhet të tregohen më të maturit. Dhe matura kërkon bërjen e dy hapave të mençur shumë. Hapi i parë ka të bëjë me shmangien e secilit konflikt ndërpartiak në vend. Në këtë fazë na duhet me finesë të kalojmë dallimet rreth demarkacionit, sepse janë krejt të parëndësishme përballë forcës provokuese që kemi përpara. Në një lojë më të mirë politike, dallimet e demarkacionit do të jepnin dhe liberalizim – pra në hap më tutje drejt evropianizimit. Por po që s'morëm liberalizim, është e domosdoshme që së paku të mos bëjmë destabilizim. Një përplasje ndërshqiptare, sikurse ajo e viteve 2015 e 2016, do të krijonte hapësirë e shkas për një seri provokimesh në Veri. Sot, mrekullisht, kur gjithë regjioni është në vlim, Kosova është krejt në qetësi. Tjetër çka që qetësi jonë ka të bëjë me mosbërjen e asgjëje. Pra jemi të qetë, sepse s'bëjmë gjë; por megjithatë s'jemi në vlim. Hapi i dytë, ka të bëjë me ndërtrimin e aleancave pro-perëndimore në Ballkan. Pra shqiptarët e Kosovës, pasi të kenë zgjedhur problemet e veta, duhet të presin – madje dhe të kërkojnë – zgjidhjen e problemeve të shqiptarëve në Shqipëri. Së bashku, më pas, do të duhet të ndërtonim aleancë me Qeverinë në Mal të Zi dhe me Qeverinë e re në Maqedoni. Këtë aleancë të re duhet ta promovojmë në Perëndim si forcë garantuese e shpërfilljes ruse në rajon; dhe mbi të gjitha, si forcë shumë etnike ballkanase. Një aleancë e tillë do ta vinte Serbinë në presion e Rusinë pa faktor destabilizues në Ballkan. (koha.net)

# Pesë arsye përse fitoi Emmanuel Macron

Becy BRANFORD

Emmanuel Macron ka shkaktuar një tërmet politik në politikën franceze. Një vit më parë, ai ishte thjesht njëri prej ministrave të qeverisë së njërit prej presidentëve më të papëlqyeshëm në historinë e Francës. Sot, kur është vetëm 39 vjeç, ai ka fituar zgjedhjet presidenciale të Francës, duke mundur qendrën e majtë dhe qendrën e djathtë, dhe tashmë, edhe të djathtën ekstreme.

**ISHTE ME FAT:** Nuk ka asnjë dyshim që Macron shkoi drejt fitores, i ndihmuar pjesërisht edhe nga errërat e fatit. Një skandal publik rrëzoi kandidatin favorit të qendrës së djathtë, François Fillon; dhe kandidati socialist Benoît Hamon, tashmë në periferinë e majtë të partisë, u dërmua publikisht, teksa votuesit tradicionalë shkuan gjetkë. "Ishte shumë me fat, sepse përballë me një situatë e cila ishte krejt e papritur", thotë Marc-Olivier Padiš i think tank-ut Terra Nova, me qendër në Paris.

**ISHTE DINAK:** Por fati nuk tregon të gjithë historinë. Macroni mund të kishte kërkuar të ishte kandidati i socialistëve, por ai e kuptoi pas viteve në pushtet dhe mbështetjes shumë të ulët në opinionin publik, se zëri i partisë gjithmonë do të kish probleme për t'u dëgjuar. "Ai ishte në gjendje të parashikonte se kishte një mundësi, atëherë kur askush nuk e shihte këtë gjë", thotë Padiš.



Ai hodhi sytë nga lëvizjet politike janë përhapur gjetkë në Evropë – Podemos në Spanjë, Lëvizja Pesë Yjet në Itali – dhe pa që edhe në Francë kishte një forcë ekuivalente politike, e cila mund të ndryshonte lojën. Në prill 2016, ai themeloi forcën e tij En Marche! dhe katër muaj më vonë u tërhoq nga qeveria e presidentit François Hollande.


**PROVOI DIÇKA TE RE NË FRANCË:** Pasi themeloi En Marche!, ai u përpoq të nxjerrë mësim nga fushata zgjedhore e Barak Obamës në vitin 2008, thotë gazetarja e pavarur me banim në Paris, Emily Schultheis. Përpjekja e tij e parë ishte Grande Marche (Marshimi i Madh), kur ai mobilizoi radhët e shtuara të aktivistëve të tij energjikë po pa përvojë. "Fushata përdori algoritme nga një firmë politike me të cilën ata punuan – të cilët, meqë ra fjala, kishin qenë vullnetarë në fushatën e Obamës në vitin 2008 – për të identifikuar lagjet që ishin më përfaqësues të Francës në tërësi", thotë znj. Schultheis. "Ata dërguan njerëz, që të trokisnin në 300 000 dyer". Vullnetarët nuk dorëzuan

vetëm fletushka – ata bënë 25,000 intervista të thella për rreth 15 minuta me votuesit anembanë vendit. Ky informacion u fut në një bazë të madhe të dhënash, e cila ndihmoi në hartimin e prioriteteve dhe politikave të fushatës. "Ishte një grup fokusi shumë i madh për Macron, që të maste temperaturën e vendit, por gjithashtu siguroi që njerëzit të kishin kontakte që në krye të herës me lëvizjen e tij, duke u siguruar që vullnetarët të dinin se si të shkonin derë më derë. Ishte një ushtrim që hodhi bazat për atë që u arrit këtë vit", sqaron Schultheis. Dhe ai kapitalizoi mbi këtë.

**KISHTE NJE MESAZH POZITIV:** Personi politik i Macron duket i mbushur me kontradikta. "Rishtari", që ishte mbrojtës i presidentit Hollande dhe më pas ministër i ekonomisë; ish bankier i bankës së investimeve që drejton një lëvizje të bazës; Centrist me një program radikal për të zvogëluar sektorin publik. Ishte municioni i duhur për rivalen Marine Le Pen, e cila tha se Macron ishte kandidat i elitës, aspak rishtar, siç thoshte ai vetë. Por, ai i shmangu përpjekjet për ta etiketuar si një tjetër François Hollande, duke krijuar një profil që rezononte mes njerëzve të dëshpëruar për diçka të re. "Në Francë ekziston një gjendje shumë pesimiste shpirtërore, dhe ai erdhi me një mesazh shumë optimist dhe pozitiv", thotë Marc-Olivier Padiš. "Ai është i ri, plot energji dhe nuk po

shpjegon se çfarë do të bëjë për Francën, por se si njerëzit do të kenë shanse. Është i vetmi që ka këtë lloj mesazhi".

**QENDROI FORT KUNDER LE PENIT:** Përballë mesazhit të tij më optimist, mesazhi i Marine Le Penit erdhi në veshët e njerëzve si negativ – anti-imigrim, antiBE, antisistem. Në fushatat e Macronit spikasnin skenat e ndriçuara fort me muzikë pop, thotë Emily Schultheis, ndërkohë që në takimet masive të Marine Le Pen kishte protestues që hidhnin shishe dhe fishekzjarrë, një prani të madhe të policisë, qëndrime të errëta dhe plot zemërim të audiencës. Debatet e madhe televizive në 3 maj ishte një shpërthim zemërimi, me fyerje të hedhura nga të dy palët. Ajo ishte "një priftëreshë e madhe e frikës" nga i njëjti sfond ekstremist si babai i saj. Ai ishte një kukull socialiste, një mjet i rrezikshëm i financës globale, që do të bënte çdo gjë që do i kërkonte Angela Merkeli e Gjermanisë. Por shumëkush u tremb nga mundësia e një presidenciale potencialisht destabilizuese të të djathtës ekstreme, dhe e panë atë si pengesën e fundit në rrugën e saj. Marine Le Pen mund të ketë bërë një fushatë shumë efektive, por mbështetja për të në sondazhe ka qenë në rënie gjatë muajve të fundit. Ajo ishte në krye në sondazhe vitin e kaluar, diku tek 30 përqindëshi, e megjithatë në vetëm dy javë ajo është mundur dy herë nga Emmanuel Macon. (BBC)



Umberto ECO

Mund të jap vetëm një përgjigje polemike, për atë që unë do të bëja nëse do të sundoja botën, për shkak se nuk ka shanse që kjo të ndodhë. Duke u plakur kam filluar ta urrej njerëzimin, kështu që po të kisha patur pushtet absolut, do ta lija të vazhonte në rrugën e vetëshkatërrimit – kështu ai do të shkatërrohej dhe unë do të isha më i lumtur. Njerëz si unë, intelektualë – bëjmë punën tonë, shkruajmë artikuj, kemi mënyrat tona të të protestuarit, – s'mund ta ndryshojmë botën. Angela Merkeli bëri një deklaratë pozitive, kur nxiti popullin gjerman që të mirëpresësh refugjatët sirianë. Ajo ndryshoi imazhin e popullit gjerman në të gjithë botën – ata nuk do të shihen më si SS-ët e Adolf Hitlerit. Këtë mund të bëjnë politikanët. Të rinjtë duhen mësuar që të filtrojnë dhe të shtrojnë pikëpyetje mbi informacionin që marrin përmes Internetit, në vend se ta pranojnë atë për të vërtetë. Unë e përdor Wikipedian dhe e di se mund t'i besoj asaj 99 për qind të kohës, por njerëzit kanë shkru-

## Nëse botën do ta sundoja unë...


ar në faqen time se kam qenë i pari i 13 fëmijëve dhe se jam martuar me bijën e botuesit tim të parë. Asnjë prej këtyre nuk është e vërtetë, kështu që edhe kjo mund të bëhet objekt manipulimi. Një prej nipërve të mi është 15 vjeç dhe ai më thotë se shumë prej bashkëmohatarëve të tij u besojnë teorive konspirative që lexojnë në internet. Nuk ka kontroll cilësie – dhe ky është problem shumë i madh.

Çdo qeveri duhet të përpiqet të përmirësojë arsimin. Përpara Luftës së Parë Botërore, vetëm rreth 20 për qind e njerëzve në Itali merrnin arsim fillor. Sot, problemi janë universitetet – rreziku është që të reduktojmë kërkesat e hyrjes, me qëllim që t'u japim më shumë njerëzve qasje në universitet, por edhe të kemi cilësi më të ulët. Ndodhi kohët e fundit në Itali dhe ishte një tragjedi. Tani tre vitet e parë të universitetit janë shumë të kollajtë – studentëve nuk u duhet të lexojnë libra më shumë se 100 faqesh. Ata që kanë pushtet duhet të kuptojnë se, që të rritesh, duhet të sfidohesh. Kur unë isha në universitet, lexoja një mijë faqe dhe nuk vdisja! Mësimi i gjuhëve të huaja është e vetmja gjë që unë do ta bëja të detyrueshme në shkollë. Në qoftë se koncepti i Evropës ekziston, atëherë ai

është i bazuar në njohuritë e ndërsjella të gjuhëve. Në dy prej vendeve më të mëdha, Francës dhe Anglisë, shumica e njerëzve duket se dinë vetëm gjuhën e tyre. Jo shumë kohë më parë, në Angli, njerëzit ishin mësuar të flisnin rrjedhshëm në gjuhën latine. Ekziston një histori e një gjenerali anglez, i dërguar në krahinën indiane të Sindh në shekullin e XIX-të, gjatë një revolte. Për shaka, ai dërgoi një telegram në Londër në latinisht, ku shkruante "Peccavi," që përkthet "Kam mëkatuar." Gjëja e mrekullueshme nuk ishte se ai mund të bënte shaka në latinisht, por se kolegët e tij në Londër e kuptuan. Nipi im ka studiuar greqisht për dy vitet e fundit; ai mund të mos jetë në gjendje që të lexojë Homerin në origjinal, por ka zhvilluar një kuptim të qytetërimit grek. Është një pjesë e asaj që është quajtur "encycloios", e cila do të thotë "arsim 360 gradë", prej nga vjen edhe fjala "enciklopedi". Njerëzit janë kafshë fetare. Qentë nuk janë fetarë. Është e vërtetë se ata i lehin Hënës, por kjo ndoshta nuk ndodh për shkak të fesë. Njerëzit kanë tendencën për të kërkuar arsytën e situatave të tyre. Ka një fjalë të bukur që i atribuohet GK Chestertonit: "Kur njerëzit nuk besojnë më në Zot, kjo nuk ndodh për

shkak se ata nuk besojnë në asgjë; ata besojnë në çdo gjë!" Sundimtari i botës nuk mund ta eliminojë fenë. Ju mund të jeni një ateist apo një jobsimtar, por ju duhet të pranoni se pjesa më e madhe e njerëzve kanë nevojë për disa besime fetare. Karl Marksi thoshte se feja është opiumi i popullit – se ajo i mban njerëzit të qetë. Por, ajo mund të jetë gjithashtu kokaina e popullit. Ajo ka funksionet e dyfishtë – t'u përgjigjet pyetjeve të caktuara themelore dhe ndonjëherë duke i shtyrë ato, për të luftuar jobsimtarët. Ky është një tipar i njerëzimit, po aq sa edhe ai që i bën njerëzit të jenë të vetmet specie të aftë për të dashuruar. Së fundi, në qoftë se unë do të isha sundimtar i botës, do të doja të detyroja njerëzit për të lexuar të gjithë librat e mi, në mënyrë që të bëhen aq të zgjuar sa unë dhe kështu të mos besonin, se ne duhet të kemi një sundimtar në këtë botë! Jam i irrituar nga kritikë pozitive, nëse ato janë pozitive për arsye të gabuara. Dhe, ndonjëherë jam i prekur nga kritikë negative, sepse ata e shohin që unë kam kuptuar diçka të vërtetë. Ndonjëherë jam i irrituar nga një kritikë negative, sepse unë mendoj se është idiote, por OK, kjo është pjesë e lojës. (bota.al)

## SHABAN MURATI, DIPLOMAT KARRIERE



# PROBLEMET E MAQEDONISË RRËNJËT I KANË NË PROJEKTIN E SHTREMBËRUAR TË SHTETIT

Situata e sigurisë në Ballkan nuk është e qëndrueshme për dy arsye. Së pari, nga politikat e qarqeve të ndryshme ballkanike për të siguruar epërsi dhe hegjemoni ndaj popujve të tjerë të rajonit. Shembull janë për këtë përpjekjet e Serbisë, e cila jorastësisht përpiket vazhdimisht që të ringjallë në forma të ndryshme Jugosllavinë për ta sunduar si dikur. Së dyti, nga ndërhyrjet e faktorëve anti atlantikë dhe anti evropianë, që punojnë të pengojnë integrimin euroatlantik të rajonit. Shembulli më i qartë është lufta hibride, që Rusia zhvillon në Ballkan, që pas krizës ukrainase, dhe ndërhyrjet e saj të shumëllojshme në jetën politike, sociale dhe elektorale të vendeve të rajonit, si në Maqedoni, Mal të Zi, Serbi, Shqipëri, Bosnjë-Hercegovinë, Bullgari, etj.

Koha | Delvina KËRLUKU

Shaban Murati, Ambasador i parë i Shqipërisë në Shkup (1993 – 1997). “Mjeshtër i Madh” në diplomaci. Diplomati karriere, studiues i marrëdhënieve ndërkombëtare dhe analist diplomatik me përvojë rreth 50 vjeçare në fushën e politikës së jashtme. Ka shërbyer si ambasador i Shqipërisë në Suedi, Finlandë, Norvegji dhe Islandë dhe në ministrinë e jashtme në detyrat si zëdhënës i shtypit, drejtor i drejtorisë së analizë-prognozës, drejtor i Drejtorisë së Ballkanit, drejtor i Akademisë diplomatike të MPJ dhe këshilltar

i posaçëm për rajonin. Autor i shumë librave dhe i qindra analizave për çështjet e diplomacisë dhe të politikës së jashtme në mediat e vendit dhe të huaja. “Çmimi i karrierës”, nga Unioni i Gazetarëve Shqiptarë, 2012. Si pjesë e kolanës së gjatë të librave të botuar nga autori për çështjet e Ballkanit dhe të mendimit diplomatik shqiptar, ka botuar edhe librin “Shqiptarët e Maqedonisë-prioriteti i çështjes shqiptare”. Maqedonia dhe shqiptarët e Maqedonisë janë një temë e preferuar për autorin, sepse duke qenë ambasadori i parë i Shqipërisë në Maqedoni, ka ndjekur zhvillimet me një konsekuencë të rral-

lë, jo vetëm gjatë mandatit diplomatik, por edhe nga koha e largimit prej postit diplomatik e deri në ditët tona.

**KOHA: Z. Murati, keni qenë ambasador i Shqipërisë në Maqedoni. Si ishte Maqedonia në periudhën kur Ju shërbenit në Shkup?**

**MURATI:** Kam pasur nderin të jem ambasadori i parë i Shqipërisë në Maqedoni, dhe siç kam theksuar në librin tim, “Shqiptarët e Maqedonisë-prioriteti i çështjes shqiptare”: “Maqedonia zë një vend të pazëvendësueshëm në zemrën, në krijimtarinë dhe në vokacionin

tim profesional e kombëtar”. Kam punuar në Maqedoni në vitet kur sapo ishte krijuar Republika e Maqedonisë dhe kur politikanët maqedonas, të cilëve iu dha shansi të ndërtonin për herë të parë një shtet me emrin “Maqedoni”, nuk kuptuan dot as kohën dhe as historinë. Ata bënë dy gabime strategjike, të cilat rrodhën nga ëndërra e papërligjurar nacionaliste për të krijuar një shtet një-nacional të maqedonasve. Gabimi i parë ishte se nuk vlerësuan rëndësinë e kontributit historik dhe të pjesëmarrjes së shqiptareve në institucionet e shtetit të ri, dhe që pa popullin shqiptar atje nuk do të



mund të ekzistonte shteti i ri. Gabimi i dytë ishte se nuk kuptuan që marrëdhëniet e barazisë midis popullit shqiptar dhe popullit maqedonas në të drejtat, në liritë dhe në kompetencat e drejtimit të shtetit, ishin themeli i sigurisë dhe i jetëgjatësisë së shtetit. Si ambasador i Shqipërisë kam përjetuar ngjarje të papërsëritshme të historisë së popullit shqiptar në Maqedoni, që nga festimi për herë të parë në 28 nëntor 1993 të Ditës së Flamurit në Kalanë e Shkupit, me simbolin e shqiponjave në gjokset e gjithë të ftuarve. (Kam foton me ministrin e Jashtëm Cërvenkovski me stemën e flamurit tonë në gjoks).

Themelimi i Universitetit të Tetovës përbën një nga faqet e paharuarra historike të veprimtarisë sime si ambasador, për shkak të:

- mbështetjes në ditët e përgatitjes së krijimit të tij,
- përpjekjeve për unifikimin e faktorit shqiptar në përkrahjen e themelimit,
- ndërkombëtarizimin e çështjes së Universitetit të Tetovës dhe lobimin për njohjen e tij nga faktori ndërkombëtar,
- presionin diplomatik dhe shtetëror mbi autoritetet maqedonase për pranimin dhe legalizimin e tij. Dhe sot ndjehem krenar që edhe unë kam vënë një tullë në atë ngrëhinë të shquar të arsimit të lartë në gjuhën shqipe.

**KOHA: Z. Murati, Maqedonia është ballafaquar me problemet e ndërlikuara të shoqërisë, keqkuptimet, të gjitha këto, me komunitetin maqedonas dhe atij shqiptar. Problematikën e zhvillimeve në këtë vend e keni pasqyruar në librin “Shqiptarët e Maqedonisë”. Ndërsa, sot akoma vazhdon ky problem. Ku e shihni Ju Maqedoninë?**

**MURATI:** Problemet aktuale në Maqedoni i kanë rrënjët në projektin e shtrembëruar të shtetit, i cili u konceptua nga drejtuesit e shtetit si një dominim i popullit maqedonas mbi popullin shqiptar në Maqedoni. Ky koncept i rrezikshëm u konkretizua me institucionet agresive të shtetit të ri, i cili derdhi gjak shqiptar kur u themelua Universiteti i Tetovës në gjuhën shqipe, kur u ngrit çështja e së drejtës së përdorimit të flamurit kombëtar në vitin 1997, në konfliktin e armatosur të vitit



të Perëndimit, që i shtyri edhe shtetin e Shqipërisë, edhe forcat politike shqiptare në Maqedoni të përkrahin krijimin e Maqedonisë si shtet i ri. Ky qëndrim realist ishte i rëndësishëm përballë makinacioneve të klasës politike maqedonase, e cila qysh në devizën e referendumit të pavarësisë në vitin 1991, në mënyrë dinake futi pjesën e cila ligjëron të drejtën për t'u ribashkuar me Jugosllavinë, pra me Serbinë. Nga pikëpamja formale, ajo devizë ka ende vlerë juridike dhe është disi e pakuptueshme se si as partitë politike maqedonase, madje as edhe ato shqiptare, nuk kanë kërkuar abrogimin e kësaj pjese të devizës së referendumit të vitit 1991.

Mendoj se faktori shqiptar në Ballkan duhet t'i përmbahet strategjisë së aleatëve tanë strategjikë për ekzistencën e shtetit të Maqedonisë dhe të mos joshet pas tezaeve infantile, që dalin herë pas here në qarkullim për prishjen apo ndarjen e Maqedonisë. Desha të kujtoj me këtë rast një të vërtetë historike se krijimin, ruajtjen apo ndarjen e shteteve në Ballkan nuk e kanë vendosur kurrë aktorët rajonalë.

**KOHA: Maqedonisë, Bullgaria ia konteston gjuhën, bashkë me identitetin, Serbia - kishën (autoqefalitetin), Greqia - emrin, duke u mbështetur te fakti se dy të tretat e Maqedonisë antike, sot janë nën sovranitetin e saj. E vetmja është Shqipëria që ka treguar një neutralitet të theksuar. Pse?**

**MURATI:** Mendimi im, i mbështetur edhe nga përvoja e mandatit si ambasador, është se Shqipëria ka vepruar drejt, që ka përkrahur shtetin e Maqedonisë dhe nuk ka paraqitur rivendikime të llojeve të ndryshme, që përmendet Ju. Kjo është e drejte edhe nga pikëpamja e interesit kombëtar shqiptar, edhe nga pikëpamja e strategjisë euroatlantike. Ndaj edhe Shqipëria, edhe partitë politike shqiptare në Maqedoni, me të drejtë kanë mbështetur anëtarësimin e Maqedonisë në BE dhe në NATO.

Përkrahja ndaj shtetit të Maqedonisë si pjesë e familjes euroatlantike, nuk duhet të ndikohet nga fakti se qeveritë maqedonase nuk kanë ditur ta vlerësojnë proporcionalisht këtë qëndrim të drejtë të Shqipërisë. Mua me kujtohet se në kohën e qëndrimit tim si ambasador, teoria zyrtare për marrëdhëniet me fqinjët ishte ajo e ekuidistancës, e cila realisht nuk ishte ekuidistancë ndaj fqinjëve, por ishte proklamuar si e tillë për të mbuluar preferencat ndaj njërit apo tjetrit fqinj në veçanti. Kjo etiketë mbulonte edhe qëndrimin e pa ngrohtë ndaj Shqipërisë, e cila ishte i vetmi shtet fqinj, që nuk paraqiste asnjë rivendikim territorial historik, gjeografik, politik, fetar, gjuhësor, etj.

**KOHA: Gjenerata ime po bëhet dëshmitare okulare e stërvuajtjeve shpirtërore të prindërve të të akuzuarve dhe të dë-**



**nuarve pa faj, në burgjet e Maqedonisë. Nën at shqiptare qëndrojnë këmbëkryq në derën e gjykatës. A ka pasur ndonjëherë drejtësi për shqiptarët në Maqedoni. Flasi edhe për periudhën kur Ju keni qëndruar në Shkup?**

**MURATI:** Një shtet i ndërtuar mbi diskriminimin nacional nuk mund të ketë drejtësi të vërtetë dhe shqiptarët e kanë provuar gjatë gjithë këtyre 26 vjetëve të shtetit të Maqedonisë. Përtej fajit kryesor të qeverive dhe të institucioneve maqedonase, mendoj se populli shqiptar në Maqedoni e meriton një autokritikë edhe nga partitë politike shqiptare, të cilat kanë qenë pjesë e qeverive në të gjitha periudhat dhe duhej të kishin qenë më intransigentë në drejtim të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të popullit shqiptar në Maqedoni.

**KOHA: A duhet gjuha shqipe të respektohet, në gjithë territorin e Maqedonisë (shqiptarët e Maqedonisë janë në katër anët e këtij shteti)?**

**MURATI:** Gjuha shqipe duhet të jetë gjuhë zyrtare në Maqedoni në të gjithë territorin dhe sistemin e saj institucional, me status të barabartë me gjuhën maqedonase. Maqedonia mund të marrë plot shembuj në Evropën e sotme, ku gjuhët e shumta zyrtare e kanë forcuar shtetin dhe demokracinë dhe bashkëjetesën, dhe mjafton të ndiqet shembulli i Zvicrës, Belgjikës, etj.

**KOHA: Marrëveshja e Ohrit, të cilën e ka sponsorizuar BE-ja, thirret në ligjet pozitive. Ndërsa, sot kemi "Platformën shqiptare", të përpiluar nga vetë palët shqiptare. A thua kjo platformë pa ndërhyrjen e fuqisë ndërkombëtare do të zbatohet?**

**MURATI:** Duhet pasur një koncept të qartë përfundimtar shtet-ndërtues se shqiptarët në Maqedoni nuk janë as minoritet e as komunitet. Ata janë popull dhe nuk mund të trajtohen me ligje pozitive apo me diskriminime pozitive, siç trajtohet për shembull minoriteti serb në Kosovë. Populli sh-

qiptar në Maqedoni meriton dhe ka të drejtën të ketë status të barabartë kushtetueso-ligjor për të drejtuar së bashku shtetin me popullin maqedonas. Marrëveshja e Ohrit i përket vitit 2001 dhe, pavarësisht se pushteti maqedonas nuk i ka plotësuar detyrimet që rrjedhin nga ajo marrëveshje e nënshkruar prej atij pushteti, duhet pasur parasysh se korniza e kërkesave të popullit shqiptar sot nuk mund të jetë vetëm kadri kontraktual i para 16 vjetëve. Ndaj lindi si kërkesë e kohës së re ajo që quhet platformë e partive politike shqiptare në Maqedoni.

Platforma e partive shqiptare është një e drejtë e tyre të koordinojnë qëndrimet dhe të dalin me kërkesa të përbashkëta për mbrojtjen e interesave dhe identitetit kombëtar të popullit, që përfaqësojnë, dhe që i voton në Maqedoni. Se nuk ka logjikë që populli shqiptar në Maqedoni të pranojë platformën maqedonase të shtetit njënacional dhe populli maqedonas të mos pranojë platformën e barazisë gjuhësore, juridike dhe kushtetuese të popullit shqiptar atje.

**KOHA: Si e vlerësoni bashkëpunimin Maqedoni-Shqipëri, në sferën e politikës dhe në sferën të ndryshme të jetës?**

**MURATI:** Marrëdhëniet midis Shqipërisë dhe Maqedonisë janë normale. Mendimi im është se do të kishin pasur një shkallë më të lartë bashkëpunimi dhe përfitimi reciprok, nëse qeveritë maqedonase nuk do të vuanin nga paragjykimet, si ndaj popullit shqiptar në Maqedoni, ashtu dhe ndaj të drejtës së shtetit të Shqipërisë për të mbrojtur të drejtat e shqiptarëve në Maqedoni.

**KOHA: Mungesa e unitetit të faktorit politik shqiptar në Ballkan, ka bërë që shqiptarët e ndarë në pesë shtete të jetojnë të defaktorizuar?**

**MURATI:** Unë mendoj se shqiptarët kanë nevojë për unitetin e faktorit politik shqiptar në secilin shtet ballkanik, ku jetojnë. Përpara se të kërkojmë unitet ballkanik

të faktorit shqiptar, mendoj se duhet të kërkojmë unitet të faktorit shqiptar në Maqedoni, të faktorit shqiptar në Mal të Zi, të faktorit shqiptar në Serbi, etj. Faktorizimi i faktorit shqiptar në secilin shtet ballkanik do të prodhojë faktorizimin e tij rajonal.

**KOHA: Situata e sigurisë në Ballkan nuk është stabile. Ku e shihni Ju shpëtimin?**

**MURATI:** Situata e sigurisë në Ballkan nuk është e qëndrueshme për dy arsye. Së pari, nga politikat e qarqeve të ndryshme ballkanike për të siguruar epërsi dhe hegjemoni ndaj popujve të tjerë të rajonit. Shembulli më i qartë është lufta hibride, që Rusia zhvillon në Ballkan, që pas krizës ukrainase, dhe ndërhyrjet e saj të shumëllojshme në jetën politike, sociale dhe elektorale të vendeve të rajonit, si në Maqedoni, Mal të Zi, Serbi, Shqipëri, Bosnjë-Hercegovinë, Bullgari etj.

Integrimi i plotë euroatlantik i rajonit do të krijojë bazën e stabilitetit afatgjatë në rajon. Sa i përket Maqedonisë, ajo nuk do të jetë asnjëherë e qetë, derisa të realizojë barazinë e të drejtave dhe të vendimmarrjes në shtet midis popullit maqedonas dhe popullit shqiptar.

**KOHA: Si mund ta konsiderojmë gazetarinë sot? Duke pasur parasysh se Ju keni punuar një periudhë në gazetari?**

**MURATI:** Gazetaria është profesion dhe vokacion. Ajo ndodhet aktualisht në një periudhë të vështirë, sepse me lindjen e portaleve dhe të rrjeteve sociale gjithkush, që din shkrim e këndim mendon se automatikisht është gazetar. Në fakt profesion i gazetarit ka qenë dhe është i njëjtë si profesioni i mjekut apo i inxhinierit. Unë kam punuar gjysmën e jetës profesionale në gazetari, por nuk jam ndarë prej saj as në gjysmën tjetër, që kam punuar në diplomaci. Kam qenë me fat, që kam ardhur në diplomaci nga gazetaria, që për mua është profesioni më i përshtatshëm për t'u bërë diplomat.

**KOHA: z. Murati, ku e dalloni dashurinë ndaj familjes me atdashedashurinë?**

**MURATI:** Është detyrim të duash familjen njësoj si atdheun, dhe atdheun njësoj si familjen. Historia e shtetit shqiptar na ka mësuar që nuk ka qenë gjithmonë ashtu. Kur shqiptarët të arrijnë të njësojnë të dy dashuritë, mund të themi se e kemi bërë Shqipërinë.





Ndërsa qeveria po përgatitet të procedojë për herë të dytë demarkacionin në Kuvend, opozita ka deponuar të premtën një mocion me nënshkrimet e 42 deputetëve, 30 nga partitë opozitare dhe 12 nga partitë tjera, përfshirë edhe ato në pushtet për rrëzimin e qeverisë aktuale

Marrëveshja është vendosur të dërgohet për ratifikim në Kuvend, në javën kur ligjvënësit pritet të votojnë mocionin e opozitës për rrëzimin e qeverisë aktuale. Kjo marrëveshje po kundërshtohet ashpër nga opozita si dhe një numër i deputetëve nga partitë në pushtet, me pretendimet se nëse ratifikohet si e tillë, përmes saj Kosova do të humbte mbi 8 mijë hektarë tokë

Në një komunikatë për media, thuhet se pas diskutimeve të partnerëve të koalicionit qeverisës PDK-LDK, ku ishin të pranishëm edhe përfaqësuesit e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, u arrit dakordimi që mbledhja e kabinetit qeveritar ku do të shqyrtohet Projektligji për Ratifikimin e Marrëveshjes për Kufirin Shtetëror ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi, të mbahet pas seancës së Kuvendit të Republikës së Kosovës, që do të zhvillohet të mërkurën. "Qeveria e Republikës së Kosovës shpreh përkushtimin e saj të plotë, që në bashkëpunim të ngushtë me partnerët strategjikë ndërkombëtarë, SHBA-të dhe BE-në, të adresojë me prioritet dhe përkushtim të plotë çështjen e Ratifikimit të Kufirit Shtetëror me Malin e Zi, si një prej vendimeve më të rëndë-

# Veseli e Mustafa në takim me amerikanët

## Qeveria procedon demarkacionin nëse i mbijeton mocionit



sishme për të ardhmen e qytetarëve dhe të shtetit të Kosovës", theksohet në komunikatë. Marrëveshja është vendosur të dërgohet për ratifikim në Kuvend, në javën kur ligjvënësit pritet të votojnë mocionin e opozitës për rrëzimin e qeverisë aktuale. Kjo marrëveshje po kundërshtohet ashpër nga opozita si dhe një numër i deputetëve nga partitë në pushtet, me pretendimet se nëse ratifikohet si e

tillë, përmes saj Kosova do të humbte mbi 8 mijë hektarë tokë. Gjendja e krijuar me demarkacionin, por edhe në raportet mes partnerëve të koalicionit, është shqyrtuar në një takim të Kryesisë së Lidhjes Demokratike të Kosovës. Anëtarë i Kryesisë së LDK-së, Arban Abrashi tha se çështja e demarkacionit do të paraqitet në qeveri dhe kuvend pas të mërkurës, më 10 maj, kur do të voto-

het për mocionin e opozitës. "Besojmë që mocioni nuk kalon dhe është me rëndësi që më pas të ratifikohet demarkacioni dhe të bëhet liberalizimi i vizave, në mënyrë që qytetarët të lëvizin lirshëm brenda 90 ditëve", ka thënë Abrashi. Një tentativë paraprake për ratifikimin e kësaj marrëveshje ishte shënuar edhe më 1 shtator të vitit të kaluar. Por, atë ditë, koalicioni nuk i kishte 80 votat e

**YMERI: QEVERIA DUHET TË SHKOJË TË MËRKURËN, DO TA NDALIM DEMARKACIONIN**

Kryetari i Vetëvendosjes, Visar Ymeri, në një konferencë për shtyp ka folur për zhvillimet e sotme politike në vend. Ai tha se e pamë edhe një zbrapsje të Qeverisë. Nuk pati guxim ta sjell në Kuvend demarkacionin. Edhe Qeveria e di që është e dëmshme dhe do të jetë e dëmshme për shtetin. Qeveria me kokëfortësi insistoi në këtë marrëveshje. Në vazhdim Ymeri shtoi se në këto ditë është parë një garë ndërmjet Isa Mustafës dhe Kadri Veselit sepse në mendje kanë vetëm kolltukun. Mustafa që të mbesë në Qeveri e Veseli që të vijë në pozitën e kryeministrit. Këto parti nuk dëshirojnë të mirën për qytetarët prandaj rrëzimi i saj është i domosdoshëm. Qeveria duhet të shkarkohet të mërkurën. Por, në një skenar që qeveria sjell demarkacionin, ne do të protestojmë dhe do ta ndalim këtë marrëveshje, tha Ymeri.

nevojshme për ratifikim, ndërkohë që edhe gjendja e sigurisë që përkeqësuar, çka e kishte detyruar kryeministrin Isa Mustafa ta tërhiqte ratifikimin e marrëveshjes nga Kuvendi. Prishtina dhe Podgorica nënshkruan Marrëveshjen për Demarkacionin e kufirit në gusht të vitit 2015, në praninë ndërkombëtare. Kjo marrëveshje më pas u shndërrua në një kusht nga BE-ja për procesin e

liberalizimit të vizave për qytetarët e Kosovës. Ndërsa qeveria po përgatitet të procedojë për herë të dytë demarkacionin në Kuvend, opozita ka deponuar të premtën një mocion me nënshkrimet e 42 deputetëve, 30 nga partitë opozitare dhe 12 nga partitë tjera, përfshirë edhe ato në pushtet për rrëzimin e qeverisë aktuale. Mocioni për rrëzimin e qeverisë është caktuar të votohet më 10 maj.

## Linjë ajrore shqiptare me ndihmën e "Turkish Airlines"

Kryeministri Edi Rama njoftoi se, me ndihmën e "Turkish Airlines", do të nisë projekti për një linjë ajrore shqiptare. "Cilësia e transportit ajror të shqiptarëve lë shumë për të dëshiruar. Flas për shërbimin që u jepet njerëzve në shumë drejtime, me një cilësi të ulët dhe kosto të lartë. I jam mirënjohës Presidentit të Turqisë dhe drejtuesit ekzekutiv të "Turkish Airlines", që po na japin një ndihmë të vyer", tha Rama. "Jemi afër realizimit të projektit dhe shpresojmë që këtë vit të nisim fluturimet e para. Kompania e re shqiptare shpresoj që të shërbejë me të njëjtën cilësi si "Turkish Airlines", edhe pse në madhësi nuk mund të krahasohemi", shtoi kryeministri. Rama premtoi: "Ne do i japim shqiptarëve një mundësi të re dhe do të nisim një epokë të re edhe në këtë drejtim".

## Kocijançiç thërret për shmangie të retorikës luftënxitëse në Ballkan

Gazeta e Beogradit, "Novosti", citon sot zëdhënësen e përfaqësueses së lartë të BE-së, Maja Kocijançiç, e cila rikujton se BE ka ndjekur me kujdes rastin e arrestimit dhe pastaj të lirimit të Ramush Haradinajt nga autoritetet policore të Francës në bazë të një kërkesë të Serbisë, transmeton Koha.net. Sipas kësaj gazete ajo, duke iu përgjigjur një pyetjeje (nuk sqarohet nëse vinte nga gazetarë të Beogradit, por që supozohet - plotësim ynë) rreth gjoja kërcënimeve

erisë së Serbisë, si dhe apelit të Rusisë për Brukselin dhe SHBA-në që "të frenojnë të mbrojturit e tyre" nga Kosova, tha se "deklaratat që mund të interpretohen si ndërhyrje politike në vendet fqinje nuk kontribuojnë për ndërtimin e marrëdhënieve të mira dhe e ballafaqojnë rajonin me rrezikun e retorikës luftënxitëse". BE pret nga të gjithë në rajon që të vazhdojnë ndërtimin e marrëdhënieve konstruktive dhe bashkëpunuese si dhe të intensifikojnë punën në pro-

gramet përkatëse reformuese që të përparojnë në rrugën e integritimit europian, tha Kocijançiç. Sipas fjalëve të saj, Këshilli i Europës ka përsëritur mbështetjen e tij ndaj perspektivës së qartë europiane të rajonit. Kocijançiç ka theksuar se BE mbështet me konsekuencë parimet e pajtimit dhe vazhdon bilateralisht të punojë me të gjithë partnerët në rajon në rrugën e tyre europiane dhe të bashkëpunimit të ngushtë e efikas rajonal të tyre.

## Basha: Rama e destabilizoi vendin

Kryetari i Partisë Demokratike, Lulzim Basha, deklaroi nga çadra e protestës se është kryeministri Edi Rama ai që e ka destabilizuar vendin këto 4 vite. "Plani i Edi Ramës është të shkojë në zgjedhje vetëm me koalicionin e sharlatanëve, hajdutëve dhe kriminelëve që qeverisi Shqipërinë në këto 4 vite. Edi Rama flet për destabilizimin e Shqipërisë këto ditë, por e destabilizoi vendin me deputetë, kryepolicë, tatimorë dhe drejtorë kriminelë", tha Basha. Më tej, kreu i PD-së shtoi: "Në vitin 2015 vonoi ligjin e dekriminalizimit për të çuar Rroshin në Kavajë. Kur OSBE-ODIHR tha se me këto zgjedhje ke shkatërruar besimin e shqiptarëve në procesin elektoral, e mbushi Shqipërinë me drogë dhe futi duart në zgjedhjet në Kolonjë". "Ka shkatërruar ekonominë, ka rrënuar shëndetësinë, ka çuar prapa arsimin, ka varfëruar shqiptarët dhe ka larguar investitorët e huaj", shtoi Basha.



Macron mundi të dielën, në rrethin e dytë të zgjedhjeve, rivalen nga ekstremi i djathtë, Marine Le Pen. Me të gjitha votat e numëruara, kandidati i qendrës fitoi 66.06% të tyre, ndërsa Le Pen 33.94%

Presidenti i zgjedhur i Francës, Emmanuel Macron, u zotua se do të shërbejë me përlulesi, me forcë dhe duke u qëndruar besnik parimeve të Republikës për "liri, barazi dhe vëllazëri". Macron mundi të dielën, në rrethin e dytë të zgjedhjeve, rivalen nga ekstremi i djathtë, Marine Le Pen. Me të gjitha votat e numëruara, kandidati i qendrës fitoi 66.06% të tyre, ndërsa Le Pen 33.94%. Macron, 39 vjeç, presidenti më i ri i Francës, u zotua se do të forcojë marrëdhëniet e vendit të tij me Evropën. Ai iu adresua mijëra mbështetësve para Muzeut Louvre në Paris, duke dalë në skenë me himnin e Bashkimit Evropian. "Do të bëj gjithçka që mundem gjatë pesë vjetëve të ardhshëm, në mënyrë që askush të mos ketë më arsye për të votuar për ekstremet", tha Macron, duke iu referuar atyre që kanë votuar Le Penin.

**Do të kërkojë shumicë të fuqishme**

"Nuk do të dorëzohemi para frikës dhe ndarjeve. Do t'i luftoj ndarjet që sfidojnë Francën", tha ai. Macron tha se është e rëndësishme të ndërtojë edhe shumicën parlamentare, për të kryer ndryshimet shumë të nevojshme për Francën. "Detyra jonë është e madhe. Do të na kërkojë të ndërtojmë, prej nesër e tutje, një shumicë të vërtetë, një shumicë të fuqishme", tha Macron, i cili duhet të përqendrohet në sigurimin e shumicës në Dhomën e Ulët të Parlamentit, në zgjedhjet e qershorit. Dy sondazhe të

Macron fiton balotazhin në zgjedhjet presidenciale

# Do t'i luftoj ndarjet që sfidojnë Francën



opinionit, të publikuara pas fitores së tij, treguan se lëvizja e tij "Përpara" do të dala e para në zgjedhjet për legjislativin, të cilat do të mbahen më 11 dhe 18 qershor. Macron është liberal, pro biznesit dhe mbështetës i fuqishëm i Bashkimit Evropian, ndërsa Marine Le Pen ishte kundër migracionit dhe donte që Franca të largohej nga BE-ja dhe të braktiste monedhën euro. Euro u rrit në vlerë pas fi-

tores së bindshme të Macronit, duke arritur në 1.1023 dollarë në tregtinë në Azi, që është vlera më e lartë në gjashtë muaj. Tregjet në Tokio dhe në SHBA u rritën po ashtu, ndërsa shumica në Evropë të hënën janë të mbyllura për shkak të një feste më 8 maj. "I lumtur që Franca ka zgjedhur të ardhmen evropiane", shkroi në Twitter presidenti i Komisionit Evropian, Jean-Claude Juncker. Kance-

larja gjermane, Angela Merkel, tha se fitorja e Macronit është "fitore për një Evropë të fuqishme dhe të bashkuar". Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, uroi po ashtu presidentin e zgjedhur të Francës për, siç tha, fitoren e madhe. Macron pritet të bëjë betimin më 14 maj. Gushtin e kaluar, ai ka lënë Qeverinë socialiste të presidentit Francois Hollande, ku ka shërbyer si ministër,

tradicionalisht role më pak të rëndësishme në jetën publike. Por te Trogneux nuk ka asgjë tradicionale dhe Macron ka thënë se, nëse do të zgjidhej, do t'i japë gruas së tij një rol zyrtar në administratë. Ish-mësuesja lindi në një familje të klases së mesme, që merrej me prodhimin e çokollatave, dhe është më e vogla e 6 fëmijëve. Ashtu si Macron, edhe qyteti i saj i lindjes është Amiens, në veri të Francës. Para se të njihej me bashkëshortin e ardhshëm, ajo kishte një karrierë të qëndrueshme si mësuese e letërsisë franceze, latinishtes dhe dramaturgisë, e ishte e martuar me bankierin Andre Louis Auziere, me të cilin ka 3 fëmijë. Në një intervistë për revistën "Paris Match" në vitin 2016, ajo rrefeu se dashuria e kishte bërë të ndryshonte drastikisht rrjedhën e jetës, duke u divorcuar nga i shoqi. "Ishte e pamundur t'i rezistoj atij", ishin fjalët e Trogneux. Gruaja u nda nga Auziere në vitin 2006 dhe u martua me Macron një vit më vonë, duke u zhvendosur në Paris për të punuar si mësuese. Në vitin 2015 hoqi dorë nga karriera, për t'u fokusuar te bashkëshorti, që në atë kohë ishte ministër Ekonomie. Në një dokumentar të transmetuar nga "France3 TV", Trogneux përshkruhet si këshilltarja e tij, e në një prej skenave, ajo shfaqet tekta e udhëzon të flasë me zë më të ulët gjatë provave për një fjalim. Ende nuk është e qartë se kur nisi romanca mes të dyve, por Macron e dinte se çfarë donte që në moshë të re. Në moshën 17-vjeçare i shprehu dashurinë mësueses dhe i tha asaj se, çfarëdo që i ndodhte, do të martohej me të. Të dy ata janë kujdesur që marrëdhëniet e tyre të mos përkufizohet si ndonjë lloj skandali, duke e përshkruar martesën si të pazakonshme, por si një familje moderne ku mbizotëron dashuria.

për të formuar lëvizjen e tij "Përpara", për të cilën thotë se nuk është as e djathtë, as e majtë.

**Brigitte Trogneux, mësuesja që bëhet Zonjë e Parë**

Marrëdhëniet mes presidentit të zgjedhur francez, Emmanuel Macron, dhe bashkëshortes së tij ka magjepsur botën. Nuk ka asgjë klishe në historinë e tyre, e cila nisi kur 15-vjeçari Macron mori pjesë në një shkollë drame të drejtuar nga Brigitte Trogneux, 24 vite më e madhe sesa ai. Nga mësuesja e tij, ajo u kthye në partneren e më pas bashkëshorten e tij. Por në secilin fazë, sipas Macron, ka qenë këshilltare e frymëzimit për të. "Pa gruan time nuk do të isha ky që jam sot", tha 39-vjeçari pas fitores së raundit të parë të votimit në muajin prill. 64-vjeçarja Trogneux, e cila ka 7 nipër, do të bëhet Zonja e Parë franceze. Në ndryshim me Shtetet e Bashkuara, bashkëshortet e udhëheqësve francezë kanë pasur

**Euro "merr frymë" pas fitores së Macron**

Tregjet e aksioneve kanë marrë frymë lirisht pas lajmit të fitores së kandidatit liberal francez, Emmanuel Macron. Euro mbërriti nivelin e tij më të lartë të 6 muajve të fundit, kundrejt monedhës së gjelbërt, duke u kuotuar në nivelin e 1.10 dollarëve në çeljen e bursave aziatike, për t'u tërhequr pastaj përsëri në 1.095. Indeksi "CAC 40" i Bursës në Paris ishte rritur me mbi 6%, që kur Macron triumfoi në raundin e parë. Megjithatë, pas spostimit të fokusit nga një fitore e parashikuar te sfidat me të cilat përballlet axhenda e reformave të 39-vjeçarit, treguesi pësoi një turrje të lehtë me 0.6%. Shumica e rrezikut për çmimin e bonove qeveritare franceze ishte davaritur që me humbjen e Marine Le Penit më 23 prill. Investitorët i druhen një fitoreje të populistëve. Në sytë e tyre, thjesht fakti që Marine Le Pen nuk iu afrua dot pallatit "Elize", do ta reduktojë në përgjithësi atë që perceptohej si rrezik politik në Europë. Analistët parashikojnë që ulja e një risku të tillë, pikërisht në kohën kur fitimet e kompanive janë në përmirësim në periudhën afatmesme, mund të tërheqë një valë të re investimesh në aksionet europiane. Javën e kaluar, vetëm shpresat e një fitoreje të Macronit mjaftuan që "CAC 40" të mbërrinte nivelin e tij më të lartë të 9 viteve të fundit.

## Kanada, gjendje e jashtëzakonshme nga përmbytjet



Gjendja e jashtëzakonshme është shpallur në qytetin kanadez të Montrealit, për shkak të përmbytjeve të shkaktuara nga shirat e dendur dhe shkrirja e borës. Masa u shpall pasditen e së dielës dhe do të qëndrojë në fuqi për 48 orë, siç njoftuan autoritetet lokale. Në provincën e Quebecut, në Kanadanë lindore, gati 1.900 banesa

janë përmbytur përreth 126 qyteteve e fshatrave. Rreth 1.200 trupa janë mobilizuar për të ndihmuar në evakuimin e njerëzve. Gjendja e jashtëzakonshme në Montreal u shpall pas shpërthimit të 3 digave në qytetin verior. Qyteza e Rigaud në perëndim të Montrealit është goditur rëndë dhe gjendja e emergjencës është shpal-

lur edhe atje. Kryebashkiaku ka urdhëruar evakuimet e detyrueshme në zonat e përmbytura. Përmbytjet nuk janë kufizuar vetëm në Quebec, por kanë prekur edhe provincën e Ontarios. Liqeni që mban në njëntim emër ka arritur nivele të papara që prej vitit 1993, siç njoftoi agjencia e lajmeve "Canadian Press".

## Parada në "Sheshin e kuq", gati 10 mijë trupa e 114 armë të reja

Provat e fundit të paradës madhështore ruse, mbajtur në ditën e fitores mbi nazizmin, u zhvilluan në "Sheshin e kuq" të Moskës, përpara shfaqjes kryesore të së martës. Mbi 10 mijë trupa, 114 armë të reja moderne e 72 avionë ishin pjesë e përgatitjeve, për të cilat ndiqet e njëjta procedurë si në paradën reale. Në sheshin e famshëm të kryeqytetit rus kanë marshuar 46 formacione ushtarake nga 29 njësi, përfshirë këtu kadetë të instituteve më të larta ushtarake të vendit, shkollës "Suvorov" dhe Akademisë detare "Nakhimov", ushtarët e distriktit ushtarak perëndimor, pjesëtarë të Gardës Kombëtare, si dhe ata të shërbimit federal të sigurisë. Pas parakalimit të këmbësorëve vijon



formacionet mekanike, duke nisur nga autobлиндat, platformat e lëshimit të raketave ndërkontinentale dhe tanket. Prova gjenerale u përmyll me formacionet ajrore, ku ekipet akrobatike "Swift" dhe ata të "Kalorësve rusë" kanë demonstruar performancën e avionëve më të rinj luftarakë të vendit. Ky zhvillim vjen në kohën kur shtypi i huaj njofton se Rusia po përpiqet për një

zgjidhje paqësore të situatës në Afganistan, rol ky që përshin edhe shitjen e kufizuar të armëve për talebanët, gjë që ngjall mosbesimin e Shteteve të Bashkuara. Amerikanët janë për nga natyra dyshues, lidhur me planet e Moskës në këtë vend. Ekspertët besojnë, megjithatë, se më e shumta që Rusia mund të bëjë është t'i furnizojë talebanët me armë të lehta.



Mbrëmjen e datës 29 shtator 1994, shtatëvjeçari Nicholas Green u qëllua për vdekje me armë zjarri gjatë pushimeve me familjen në Italinë e jugut. Kjo qe tragjedi për prindërit e tij, Reg dhe Maggie, por vendimi i tyre për t'i dhuruar organet e tij bënte që shkalla e dhurimit të organeve në Itali të trefishohet brenda dekadës. Kjo dukuri ka marrë emrin "efekti Nicholas".

Harry LOW


"Herën e parë që e ndjeva rrezikun që kur një veturë me ngjyrë të errët na afrova shumë nga mbrapa duke mos na u ndarë për disa çaste," thotë Reg Green, duke kujtuar natën kur të birin ia qëlluan në mënyrë të pakuptimtë me armë zjarri disa persona të panjohur në jug të Italisë. "Pastaj, shumë shpejt, vetura filloi të na parakalonte. Aty për aty u qetësua, duke kujtuar se parandjenja nuk qe e saktë." Mirëpo, në vend që të bënte përpara, vetura tjetër vazhdoi të ecte përkrah tyre. Green dhe e shoqja, Maggie, dëgjuan britma zemërimi. E morën me mend se njerëzit brenda saj donin që ata ta ndalonin veturën.

"Mendova se, nëse do të ndalonim, do të ishim tërësisht në mëshirën e tyre, prandaj i dhashë më shumë gaz. Edhe ata bëjnë të njëjtën gjë, kështu që të dyja veturat bëjnë një garë paralele njëra-tjetrës, në mes të errësirës. Dritarja e pasme u shkërmoq nga një plumb. Maggie ktheu kokën dhe iu duk se të dy fëmijët po bënin gjumë të thellë." Në fakt, Nicholas-in plumbi e kishte marrë në kokë, ndërsa e motra Eleanor po rrinte e pazuar. Pak sekonda më pas, u thye edhe xhami i dritares së shoferit dhe vetura tjetër u largua me shpejtësi. "Ndalova makinën dhe dola. Atëherë u ndez drita e kabinës, por Nicholas nuk lëvizti. Iu afrova dhe vura re se gjuha i varej pak jashtë ndërsa në mjekër kishte një gjurmë të vjelle. Aty e kuptova se kishte ndodhur diçka e tmerrshme," thotë Green, 88 vjeç, i cili ka shkruar një libër të titulluar "Efekti Nicholas", lidhur me këtë përvojë.

Ngjarjet e asaj nate janë përshtatur në vitin 1998 në një film Hollivudi të titulluar "Nicholas' Gift", me aktorë kryesorë Jamie Lee Curtis dhe Alan Bates. "Tronditja që pësua kur e pashë ashtu është çasti më i tmerrshëm i jetës sime. Kur e kuptova se e kishte marrë plumbi, m'u përmbys e gjithë bota." "Grabitësit qëllojnë një shtatëvjeçar," shkruante the Times. Pushimet e një familjeje amerikane qenë kthyer kështu në një mak-

Histori që duhet lexuar

# Djali vdiq në vitin 1994, por zemra e tij pushoi së rrahuri këtë vit



th. Nicholas do të vdiste pas disa ditësh në spital, duke mos dalë nga koma. Por përpara se të ndërronte jetë, prindërit e tij morën një vendim i cili do t'ua ndryshonte jetën shtatë familjeve në mbarë Italinë. Ata vendosën t'ua dhuronin organet e të birit shtatë personave në nevojë për transplant.

"Në atë çast, ata njerëz nuk qenë veçse abstraksion. Nuk mund ta dije se çfarë njerëzish qenë. Ishte

njësoj sikur t'i jepje lëmoshë dikujt, por pa e ditur fare se si do ta ndihmonte kjo gjë tjetrin. Pas katër muajsh, na ftuan të ktheheshim dhe të njiheshim me të gjithë në Sicili, prej nga qenë katër prej përfituesve." Në Itali kriminelët shumë rrallë vrasin fëmijë, thotë Green, sepse në një rast të tillë policia u qepet këmba-këmbës gjersa t'i gjejë. Kështu ndodhi edhe në rastin e Nicholas-it. Një



qeshë në gjendje të kuptoja sa e rëndë do të kishte qenë vdekja e tyre për prindërit dhe gjyshërit e tyre. E kuptova se këtu bëhej fjalë për shumë më shumë njerëz të tjerë jeta e të cilëve do të kishte qenë shumë më e mjerë sikur të mos t'i kishim shpëtuara ata fëmijë."


Green dhe e shoqja Maggie, të cilët janë martuar në prill 1986, qenë të vendosur që Eleanor të mos rritej fëmijë i vetëm. Pas tragjedisë, atyre u lindën edhe dy binjakë, Laura dhe Martin, të cilët mbushin 21 vjeç në maj. Si ka ndikuar në jetën e Green-it vdekja e të birit? "Kam një brengë që nuk më shqitet kurrë nga shpirti, një brengë që nuk e kam pasur kurrë më parë. Kurrë më nuk kam ndier lumturi të plotë. Edhe në çastet më të gëzuara, mendoj: 'Sikur të ishte edhe Nicholas këtu!'" Por l'e fletto Nicholas – efekti Nicholas – është një e mirë që doli nga kjo fatkeqësi.

"Më duket sikur sa herë që del ndonjë lajm në gazetë, televizor apo radio, do të jetë dikush nga lexuesit, shikuesit apo dëgjuesit të cilit do t'i duhet ta marrë këtë vendim. Sikur të mos kenë dëgjuar apo menduar për faljen e organeve më parë, gjasat më shumë janë që të thonë 'jo.'" Green kthehet dy herë në vit në Itali për të bërë ndërgjegjësime për dhurimin e organeve. Herën e fundit u njoh me Maria Pia Pedala-n, e cila qe në koma me kolaps mëlqie ditën kur vdiq Nicholas dhe pritej të vdiste, por shpejt e mori veten pas transplantit të mëlçisë. Pas dy vjetësh ajo u martua dhe dy vjet më pas lindi një fëmijë mashkull, të cilit ia vuri emrin Nicholas, pas të cilit i lindi edhe një vajzë, Alessia. Të tre udhëtuan nga Sicilia – ku dhurimi i organeve në vitin 1994 thuhet nuk njihet fare, thotë Green – për të marrë pjesë bashkë me të në një program televiziv në Milano.

nuk kam asnjë dyshim. Nëse do të ndodhej përpara mundësisë për të qenë i zemëruar me personat që kryen këtë gjë dhe mundësisë për të ndihmuar dikë tjetër, padyshim që ai do të kishte zgjedhur këtë të dytën. Nicholas më ka mësuar shumë për durimin, për shembull," shton Green, i cili më së shumti ka punuar si gazetar përpara se të vendosej në SHBA ku hapi familje me të shoqen Maggie. "Unë nuk kam durim shumë dhe kur përballem me probleme, nxehem. Nicholas rrethohej nga një qetësi dhe dashamirësi që të bënte edhe ty të sillshe njësoj si ai."

Për Green çasti kur u gjend ballë për ballë me njerëzit të cilëve organet e Nicholas-it u kishte shpëtuara jetën qe i papërbalueshëm. "Kur u hap dera dhe të gjashtë hynë në dhomë, efekti qe i papërbalueshëm," thotë ai, duke shtuar se njëri prej përfituesve nuk qe i pranishëm për shkak se ndodhej i sëmurë në spital. "Kush kishte buzën në gaz, kush i kishte sytë me lot, kush mezi e ngrinte kokën nga ndrojtja, ama të gjithë qenë gjallë. Shumica e tyre pat qenë në prag të vdekjes. Aty e kuptova për herë të parë se sa i rëndësishëm pat qenë vendimi ynë. Gjithashtu,





Ivanji kaloi pothuajse 20 vjet në Vjenë, por pas vdekjes së gruas së tij Dragana, vendosi të kthehej në Beograd. "Asgjë nuk është siç duhej të ishte (në Serbi), por unë u ktheva," thotë ai. Ai mbetet shumë aktiv dhe aktualisht po planifikon një udhëtim në Gjermani

Ivan Ivanji, përkthyesi i gjermanishtes për Titon, gjithashtu shkrimtar dhe i mbijetuar i kampeve naziste të përqendrimit, tashmë 88 vjeç kujton çastet e dashurisë, humbjes dhe mbijetesës në jetën e tij të jashtëzakonshme dhe dramatike.

Natalia ZABA

Jeta e rrezikshme e përkthyesit të Titos

# Unë nuk mbijetova, dikush më shpëtoi

Jeta dhe eksperiencia e tij profesionale është aq e pasur sa që hedhja në librin e ri duket një mision i pamundur, edhe për një shkrimtar të arrirë si Ivan Ivanji. Shkrimtari serbo-hebre, i cili e përshkruan veten si një jugosllav, thotë se tani nuk e ka vendin askund – por ndihet si në shtëpi në Beograd. Ivanji ishte përkthyesi personal i presidentit jugosllav Josip Broz Tito për 20 vjet, përvjetori i vdekjes së të cilit 37 vite më parë përkujtohet çdo vit më 4 maj nga mijëra jugosllavë nostalgjikë. Ivanji gjithashtu punoi si diplomat, si sekretar i përgjithshëm i Unionit të Shkrimtarëve Jugosllavë, si redaktor, si drejtor teatri dhe si mësues i një shkolle fillore. Ai ka shkruar dhjetëra novela, tregime dhe artikuj. Personalisht ka njohur shumicën e artistëve dhe shkrimtarëve më në zë të ish-Jugosllavisë, përfshirë shkrimtarin fitues të çmimit Nobel, Ivo Andriç, shkrimtarin e famshëm kroat, Miroslav Kërlezha dhe ishte gjithashtu mik me fituesin e çmimit Nobel, gjermanin Gunter Grass për shumë vite. I pyetur për karrierën e tij 20-vjeçare si përkthyesi personal i Titos nga gjermanishtja, Ivanji thotë se nuk punonte për Titon gjatë gjithë kohës, por kujton konferencat e nivelit të lartë si stresuese dhe rraskapitëse. "Ndonjëherë isha krejtësisht i padobishëm si përkthyes. Tito fliste shumë mirë gjermanishten, madje mund të diskutonte me kancelarin Helmut Schmidt rreth August Bebelit – babai të Partisë së Social Demokratike të Punëtorëve, por ai kishte nevojë për një person që mund ta kuptonte gjuhën dhe të sigurohej që askush nuk po dëgjonte bisedat që i shkëmbente ato me zyrtarët më të lartë dhe duhej të mbeteshin sekrete", kujton Ivanji.

Sipas tij, një përkthyes ka një profesion shumë specifik, pasi mund ta shohë një klient "të zhveshur". "Tito ishte një diplomat shumë i mirë, një ndërmjetësues shumë i shkathët dhe i hapur. "Mund të përmendësh si teatralë pionerët që ia bënin me dorë Titos në Ditën e Rinisë, por kur Tito vizitonte vende të tjera liderët botërorë tregonin shumë respekt për të dhe askush nuk mund ta mohonte," përfundoi Ivanji.

I pyetur nëse kishte pasur probleme me Titon, për shkak të gjuhës së tij të mprehtë dhe komenteve



ironike, Ivanji thotë se nuk i ka ndodhur. Sidoqoftë, ai kujton se një herë kur i tha Titos se Beogradi duhet të kishte një ndërtesë të vërtetë opere, Tito qartazi nuk e aprovoi këtë ide, por ai nuk tha gjë dhe vetëm sa i ktheu kokën. Përveç një karriere të lartë, jeta i ka sjellë edhe Ivanjit edhe shumë dhimbje. Ai humbi prindërit në

vitin 1941, të dy të vrarë nga pushtuesit nazistë të Jugosllavisë.

Ivanji u deportua në moshën 15-vjeçare në kampet e përqendrimit Buçenvald dhe Aushvic në vitin 1944 dhe qëndroi aty deri në vitin 1945, pasi arriti të mbijetonte. Ai regjistroi përvojat në të dyja kampet në romanin e tij "Jeta ime e bukur në

ferr" dhe paraqiti karrierën e tij si përkthyes dhe sekretar i përgjithshëm i Unionit të Shkrimtarëve Jugosllavë, në librin e tij të kujtimeve si përkthyes i Titos. 88-vjeçari mbetet i pamundur nga përvojat e tmerrshme të jetës së tij. Kur takohemi, ai nuk flet për humbjen e prindërve të tij apo për Aushvicin ose Buçenvaldin. Ai thotë se

nuk kishte përvojë më të hidhur në jetën e tij sesa vdekja e gruas së dashur, Dragana, e cila u nda nga jeta dy vjet më parë.

"Ngjarja më dramatike në jetën time ndodhi kur më vdiq gruaja. Kuptova se ajo nuk është më këtu, por unë jam ende gjallë," thotë ai.

Ivanji u njoh me gruan e tij të tretë në teatër. Ajo ishte balerinë dhe ai një drejtor në kërkim të balerinëve për një nga shfaqjet e tij. "Kërkesa ishte që ato duhet të dukeshin si prostituta dhe më duheshin gjashtë të tilla. Dragana ishte një nga ato. Ajo u zemërua kur dëgjoi kërkesat. Më kujtohet kur tha me zemërim: "Nuk jemi prostituta, jemi balerina të arsimuara," kujton Ivanji.

"Askush në teatër nuk e dinte se kishte diçka mes nesh. Pas dy muajsh, në vitin 1964, u martuam. Jam martuar tri herë, i ndarë dy herë, gjithçka në kohën e duhur", thotë

Ivanji. Si figurë e shquar në jetën kulturore të Beogradit, ai u takua me shkrimtarin e famshëm, fituesin e vetëm të çmimit Nobel të Jugosllavisë për letërsinë, Ivo Andriç. "Andriç ishte shumë i shquar, por gjithashtu kishte çaste humori të zi," kujton ai.

Ivanji kujton pjesëmarrjen në një takim gjatë së cilit Andriç u tha delegatëve të Bashkimit të Shkrimtarëve se do t'i hante të gjitha librat me poezi patriotike që ata vendosnin të botonin! Ai gjithashtu tregon historinë e një shkrimtari kroat, Kërlezha dhe vizitës së tij në resortin bregdetar kroat të Opatijës.

Kërlezha deklaroi se nuk do të notonte në det, pasi uji ishte i ndotur. Ivanji e pyeti gruan e Kërlezhës nëse uji ishte vërtet aq keq. Ajo rrëfeu se Kërlezha kishte shtuar në peshë dhe kishte turp të hiqte rrobat para të tjerëve.

"Kam qenë me fat që njoha aq shumë njerëz të famshëm dhe i njoha vërtet [si qenie njerëzore]," pranon Ivanji. Pavarësisht se ngeli jetim në një moshë të re dhe dëshmoi tmerret e Aushvicit dhe Buçenvaldit, ai refuzoi ta shohë botën si të keqe dhe distancohet nga çdo gjë që ai ka përjetuar.

"Ishte 13 prilli i vitit 1945 kur u largova nga kampi, ndihesha më i rritur se kurrë", thotë ai për çastin e çlirimit të tij.

"Unë nuk mbijetova – dikush më shpëtoi. Sipas dokumenteve, duhet të dërgohesha në Aushvic në dhomën e gazit, por dikush tjetër u dërgua atje," thotë Ivanji.

"Nuk e di se çfarë do të bëja nëse do të isha në lëkurën e dikujt që kishte mundësinë të vriste", thotë Ivanji për vitet e luftës.

Ai kujton shijimin e fitores shumë vite më pas.

"Gjatë një prej përvojave të Buçenvald u akomodova në një dhomë hoteli vendas, ku kishte qëndruar Hitleri dhe ndjenja ishte fantastike. Ai ka vdekur dhe unë jam ende gjallë", thotë Ivanji, duke qeshur. I pyetur për gjendjen e tanishme në Ballkan, ai thotë se është i shqetësuar, por nuk pranon t'i krahasojë ngjarjet aktuale me vitet 1930. "Bosnja dhe Maqedonia nuk duken mirë dhe kam frikë se çfarë mund të ndodhë atje, por nuk mendoj se mund të themi se ajo që shohim tani mund të krahasohet me kaosin para Luftës së Dytë Botërore", tha ai.

Ivanji kaloi pothuajse 20 vjet në Vjenë, por pas vdekjes së gruas së tij Dragana, vendosi të kthehej në Beograd. "Asgjë nuk është siç duhej të ishte (në Serbi), por unë u ktheva," thotë ai. Ai mbetet shumë aktiv dhe aktualisht po planifikon një udhëtim në Gjermani. Megjithatë, ai pranon se e mendon vdekjen më shpesh.

"Nuk kam frikë nga vdekja, kam frikë nga procesi i vdekjes, mund të jetë shumë i pakëndshëm," përfundon ai me një buzëqeshje. (birn)






**Përderisa mendja e Dostojevski ishte në gjendje shumë më të mirë se shumica e mendjeve të zakonshme, kjo nuk vlente edhe për trupin e tij. Sëmundja e tij fillimisht filloi të shfaqej në shkollën ushtarake**

Gjëra që duhet t'i dini për Dostojevskin

# I dënuar edhe me vdekje

**Në vitin 1840, Dostojevski mori pjesë në një grup ose rreth letrar, qëllimi i të cilëve ishte reforma shoqërore. Ata lexonin libra të ndaluar dhe diskutonin ndryshimin e mundshëm shoqëror**



Nëse ndonjëherë e keni hapur një libër të Dostojevskit, ju mesiguri e keni vërejtur se njeriu pas saj ishte i komplikuar dhe fascionues. Librat e tij e kanë një mënyrë ruse të veçantë të hapjes së jetëve të personazheve, që e lejon lexuesin t'i kontrollojë dhe t'i inspektojë. Më poshtë i keni pesë gjëra të cilët duhet ti dini për këtë autor.

**Novelën e parë e publikoi në moshën 25 vjeçare**

Dostojevski e nisi një fillim të mbarë, sepse ai vinte nga një familje fisnike e cila ndikoi që ky të edukohet në rininë e tij. Ai nuk u trajnuar për të qenë shkrimtar; ai u dërgua në një institut inxhinierik ushtarak edhe ai nuk përshtatej fare aty. Ai i'u kthye letërsisë, madje edhe para se t'i përfundonte detyrat e tij në institute, duke i përkthyer veprat franceze në rusisht. Në vitin 1845, në moshën 25 vjeçare, ai e publikoi novelën e parë të quajtur "Poor Folks", e cila shpeshherë është përkthyer si novela e parë shoqërore ruse.

**Ai ishte dënuar me vdekje**

Në vitin 1840, Dostojevski mori pjesë në një grup ose rreth letrar, qëllimi i të cilëve ishte reforma shoqërore. Ata lexonin libra të ndaluar dhe diskutonin ndryshimin e mundshëm shoqëror – çlirimim nga censura dhe robëria – në një kohë kur këto ide ishin tmerruese për pushtetin e asaj kohe. Kur ata u kapën, menjëherë u dërguan në një burg të sigurisë së lartë dhe pastaj u dënuan me vdekje. Pak para se të ndodhte ekzekutimi ashtu siç ishte paraparë, vjen një lajmëtar i cili e përcillte urdhrin e Carit, në të cilin thuhej se në

vend se të ekzekutohej, Dostojevski duhej të dërgohej në Omsk, Siberi, të punonte punë të rënda për tetë vite.

**Ai ishte epileptik**

Përderisa mendja e Dostojevski ishte në gjendje shumë më të mirë se shumica e mendjeve të zakonshme, kjo nuk vlente edhe për trupin e tij. Sëmundja e tij fillimisht filloi të shfaqej në shkollën ushtarake dhe duke vazhduar me kriza të shpeshta, në vitin 1839, në moshën 18 vjeçare. Gjatë internimit të tij në Siberi, krizat e tij u përkeqësuan, dhe edhe pse ishte e paraparë që ai të

shërbente në ushtri pas kthimit nga Siberia, ky planifikim u anulua për shkak të shëndetit të tij të dobët. Këto kriza të vazhdueshme edhe i shkaktuan vdekjen, në vitin 1881, në moshën 59 vjeçare.

**Ai ishte shumë i dhënë pas Kishës Ortodokse**

Përveç psikologjisë së njeriut, Dostojevski preokupohej edhe për religionin, në veçanti me kishën ortodokse ruse, por më vonë përkushtimi i tij filloi të ndryshojë formën pasi ai ra në kontakt me disa elemente të kishës të cilët ai nuk i pëlqente, të tillë si prifti jashtë kampit të tij në Siri. Ai e ruajti një përkushtim të vazhdueshëm për Krishtin edhe pse forma aktuale e sistemit të tij të besimit kishte ndryshuar shumë.

**Car Aleksandri II i kërkoi t'i jepte mësim fëmijëve të tij**

Në vitet e mëvonshme të Dostojevskit, fama e tij kishte arritur larg, dhe veprat e tij vlerësoheshin gjerësisht, në Rusi dhe në Europë. Ai kishte udhëtuar shpesh në Europën Perëndimore, kryesisht në banjat e Gjermanisë për t'u trajtuar për sëmundjet e tij. Kur ai u kthye në Rusi nga njëri prej udhëtimeve të tij në Europë, Car Aleksandri e ftoi Dostojevskin për t'ia lexuar librin e tij të ardhshëm dhe pasi ai u nda shumë i kënaqur nga kjo, Cari i kërkoi Dostojevskit t'i mësonte fëmijët e tij.

**Fakte të pakundërshtueshme**



**Ja sa i gjatë ishte Skënderbeu...**

**Ndonëse Skënderbeu ka jetuar në shekullin XV (1405-1468), falë një dokumenti prej 26 fletësh që ruhet në Arkivin Shtetëror të Venedikut, historianët kanë arritur të përllorarisin për afërsisht gjatësinë e trupit të tij**

Kur është fjala për ato personalitete që kanë lënë shumë gjurmë në histori, kureshtja njerëzore kërkon të mësojë për ta edhe gjëra dhe detaje nga më të voglat.

Kështu, figura më madhore e popullit shqiptar, Kryezoti mesjetar, Gjergj Kastrioti, i mbiquajtur Skënderbeu, shpeshherë është portretizuar dhe përkthyer si një njeri fort i madh dhe tejet i fuqishëm. Por sa realisht ishte i gjatë Gjergj Kastrioti?

Ndonëse Skënderbeu ka jetuar në shekullin XV (1405-1468), falë një dokumenti prej 26 fletësh që ruhet në Arkivin Shtetëror të Venedikut, historianët kanë arritur të përllorarisin për afërsisht gjatësinë e trupit të tij, shkruan Koha.net. Këtë përlloraritje e ka bërë albonologu dhe prifti italian, At Giuseppe Valentini (1900-1979), në një artikull të tij të botuar më 1971, në revistën "Shejzat". Në këtë artikull, Valentini citon një dokument të datës 8 korrik 1457, që Gjergj Kastrioti ia kishte shkruar Senatit të Venedikut, përmes të dërguarit të tij, priftit apostolik Xhorxhio Pelini, abat i Shën Marisë së Ratacit, pranë Antivarit (Tivarit). Në këtë letër, Skënderbeu i drejtohej Venedikut me fjalët:


"Në lidhje me rrobat, që siç na është premtuar do të na jepen dy herë në vit, ju lutem të më dërgoni rroba të përshtatshme për trupin tim, ashtu siç iu janë dhënë edhe zotërinjve të tjerë, sepse thonë që mund të më mjaftojnë 16 krahë (roba) për dy palë veshje. Mirëpo zotërinj, llogarisni pak me kujdes se sa krahë më duhen për dy palë veshje e aq jepmëni".

Pra për Venedikun, 8 krahë rroba (stof) mjaftonin për të mbuluar një trup me shtat mesatar. Le ta marrim si gjatësi mesatare lartësinë trupore prej 1.75 m.

Nëse Skënderbeu nuk i mjaftonin 8 krahë rroba, kjo do të thotë se ai ka qenë më i gjatë se 1.75 metra. Nëse ai ka kërkuar qoftë edhe vetëm një krah më shumë rroba, rezulton që ai ka qenë goxha shtatllartë, sepse nëse për një trup 1.75 m., mjaftonin 8 krahë rroba, atëherë me 9 krahë rroba mund të mbulohet një trup prej 1.98 m. Kjo do të thotë që Skënderbeu, duhet të ketë qenë rreth 2 metra i gjatë.

# Xhamia e Plumbit në hapësirën e harresës

**Xhamia e Mehmet Pashë Bushatit ose Xhamia e Plumbit u ndërtua në vitin 1773-1774 nga Mehmet Pashë Bushati (Plaku), themeluesi i familjes së njohur të Bushatlinjve të Shkodrës**



Anisa DEMIRAJ

Xhamia e Shkodrës ose e quajtur ndryshe e Plumbit është një nga ndërtesat më të vjetra të Shkodrës dhe xhamia më e madhe dhe më e bukura e Shqipërisë deri në gjysmën e parë të shekullit XX. Është quajtur Xhamia e Plumbit për motivin e vëtm sepse në fillimet e saj kjo xhami, çatinë e kishte të veshur me plumb. Xhamia e Mehmet Pashë Bushatit ose Xhamia e Plumbit u ndërtua në vitin 1773-1774 nga Mehmet Pashë Bushati (Plaku), themeluesi i familjes së njohur të Bushatlinjve të Shkodrës.

Xhamia është e vendosur në pjesën e jashtme të ish pazarit të Shkodrës, rrëzë kalasë Rozafat, në një livadh në rrafshinën e lumenjve Kir e Drin. Për nga forma e ndërtimit është frymëzuar nga xhamitë e sulltanëve të Stambollit. Kjo xhami është e vetmja në Shqipëri për nga lloji, që fillon me një oborr me kolona të gjera, para se të hysh në sallën

e faljes. Ndërtimi i kësaj xhamie, në këtë formë, ka të bëjë me atë që pashallëku i Shkodrës është në gjendje që edhe në ndërtimin e objekteve të kultit të thyejë të drejtën perandorake për të pasur një element të tillë, vetëm ata. Salla e faljes paraqitet si një bllok i ulët, kapërcyer nga një tambur oktagonial shumë i lartë, në majë të të cilit qëndron kubeja, gjysmë rrethore. Interieri shfaqet si një dhomë e gjatë dhe e gjerë, pavarësisht se përmasat janë jo dhe aq të mëdha. Vizualisht kjo dhomë është zgjeruar nga një lloj thellësie, në të cilën është vendosur Mihrabi. Në majë të Mihrabit ka tre kube, ndërsa në të djathtë ka dy kube. Xhamia është ndërtuar me gurë të

shkëlqyer në të kaltër e të bardhë, që janë shumë rezistent ndaj veprimeve erozive.

Nga dëmtimet e ndryshme që pati kjo xhami, qoftë nga mbulesa, ashtu edhe përbrenda, si dhe nga vërshimet e herëpashershme të lumit Kir, për disa kohë mbeti e papërdorshme, ndërsa në vitin 1978, periudhë që në Shqipëri ishin shkatërruar ndërtesat e bukura dhe të vjetra që tregonin kulturën e shqiptarit, shërbimet e monumenteve të kulturës, i vendosën një mbulesë me çimento për ta shpëtuar këtë thesar jo si objekt kulturi, por si objekt ndërtimor. Me ndërtimin e kësaj xhamie të madhe të Shkodrës, shohim se në Shqipëri po shfaqej një arkitekturë me stil të zhërvjellët e me

shije, që nuk munguan në shekullin XVIII. Ky stil haset edhe në ndërtimin e xhamive të tjera në Bullgari, Anatinë qendrore, etj. Në këtë xhami gjendet një shkrim që na jep një informacion historik, ku shkruhet: Viti 1187 Hixhri është data e ndërtimit të xhamisë së madhërishtme prej Mehmet Pashës, zot i bamirësive. Dhe më poshtë: "Viti 1280 është data e riparimit të xhamisë prej kujdestarit të saj Mahmut Berberi". Respektivisht, këto dy data të kalendarit islamik, përkojnë me vitet 1773 dhe 1863. Riparimi i saj është bërë para vitit 1865, periudhë kur në Shkodër ndodhi përmbytja e madhe që shkatëroi një pjesë të mirë të Shkodrës së vjetër.



Berat Jakupi flet pas suksesit në KE në Turqi

# Pas shumë pengesave u riktheva në rrugën e vjetër

“Para se gjithash dua të falënderoj drejtorin e ARS për pritjen që na e bërën pas këtij sukse si të madh që e bëmë. Nga ana ime jam i kënaqur shumë, pasi u riktheva në rrugën e vjetër pas shumë pengesave që i pata në karrierën time, shumë lëndime, por u desh që pas gjithë kësaj të stërvitem më shumë”, thotë Jakupi



Koha Bujar KURTAJ

Shkup, 8 maj – Në hapësirat e Agjencisë për Rini dhe Sport dje qëndroi përfaqësuesja e Maqedonisë në karate, e cila në Kampionatin Evropian në Koxhaeli të Turqisë për senior bëri një sukses të madh, duke fituar një medalje të argjendtë Berat Jakupi dhe një të bronzit Jovana Georgieva dhe duke vërtetuar kështu kualitetin e saj në kontinentin e vjetër. Nga ARS, respektivisht nga drejtori i saj Marjan Spaseski konfirmuan se me këtë sukses u dëshmuua se sporti i karatesë vitet e fundit është sporti me më trofe dhe më i suksesshëm individual në Maqedoni, pasi po arrin rezultate edhe në nivel evropian dhe atë botëror,

derisa sukse si i fundit në Turqi, vërtetoi këtë. Derisa, i lumtur për këtë sukses u shpreh edhe Berat Jakupi. “Para se gjithash dua të falënderoj drejtorin e ARS për pritjen që na e bërën pas këtij sukse si të madh që e bëmë. Nga ana ime jam i kënaqur shumë, pasi u riktheva në rrugën e vjetër pas shumë pengesave që i pata në karrierën time, shumë lëndime, por u desh që pas gjithë kësaj të stërvitem më shumë. Në anën tjetër derisa unë po rikuperohesha nga lëndimet, kundërshtarët e mi ishin të stërvitur dhe për ti arritur unë ata, u desh që të ushtroj shumë më tepër. Falënderoj të gjithë që më ndihmuan të rikthehem në formën e vjetër dhe në sukseset e njëjta duke fillua nga Federata e Karatesë dhe kryetarin e saj, pastaj trajnerit tim kondicional Trajçe Bogdanovski, Zharko Arsovskin, Sashko Ar-

sovskin dhe Emill Pavlov, me të cilët i bëmë përgatitjet e fundit si dhe seleksionuesin e përfaqësueses me të cilën për çdo luftë kemi zbatuar taktikë të ndryshme. Shpresoj se ky është vetëm fillimi dhe një pikë deri në Lojërat Olimpike dhe shpresoj në kampionatet e ardhshme Evropiane dhe Botërore do të rruaj këtë nivel. Por, përsëris synimi im është pjesëmarrja në LO me shpresë se nga atje do të kthehem me ndonjë medalje, e pse jo edhe dashtë Zoti me medalje të arrit”, deklaroi Berat Jakupi, karateisti shqiptar nga Gostivari. E lumtur gjithashtu me medaljen e bronzit ishte edhe Jovana Georgieva. “Jam shumë e kënaqur me atë që arrita ta bëj në këtë evropian, por para se gjithash nga vetja. Ky sukses erdh si rezultat i përgatitjeve të shumta që i kisha, shumë mund dhe përkrahje nga të gjithë

anëtarët e Federatës. Falënderoj seleksionuesin, i cili dinte që në secilën luftë të zbatoj taktikë, të më ndihmojë të luftoj njëjtë si Sashko Arsovski, pastaj Zhar dhe Emillit për përgatitjet që i realizuam. Ky është fillimi dhe shpresoj se do të kem edhe sukse tjera.”, tha Georgieva. Ndërkohë, pas këtij sukse si të madh dy reprezentuesit e Maqedonisë Jakupi dhe Georgieva do të marrin bursë nga ARS-ja e kategorisë botërore. Jakupi për medaljen e argjendtë dhe Georgieva, në katër vitet e ardhshme do të marrin pagë prej dy rrogave mesatare në Maqedonisë, respektivisht më shumë se 700 euro, ndërsa për Sara Radiçevska, e cila fitoi pozitën e tetë, do ti takojë bursë të kategorisë ndërkombëtare, respektivisht në dy vitet e ardhshme ajo do të merr pagë prej një rroge mesatare.

## Historia prekëse e Besart Berishës Kaloj luftën për t’u bërë mbret

I ulur në një hotel në Sidnej duke biseduar i qetë, duke reflektuar, duke e analizuar veten, modest dhe i zhytur në mendime. Kjo të bën të mendosh se përse Besart Berisha është asgjë tjetër veçse i qetë, i cili gjuan nga të gjitha pozitat dhe bëhet figura më e urreyer e tifozëve kundërshtarë? “The Daily Telegraph”, në versionin austrian, ia ka kushtuar një shkrim futbollistit kosovar, me të cilin ka biseduar për shumë gjëra. Ai ishte vetëm gjashtëvjeçar kur prindërit u larguan nga Kosova në vitin 1991, dy vjet pasi kishin nisur tensionet me Serbinë dhe që ishte përshkallëzuar situata me protesta, arrestime, represion dhe në fund edhe me luftë. Familja Berisha kishte arritur në lindje të Berlinit për ta nisur një jetë të re. “Kur shkoni në një vend të ri me pak gjëra duhet t’ia nisni nga zeroja, që është paksa e vështirë”, e fillon bisedën prishtinasi. “Mirëpo, ndoshta ky ishte një çelës i vogël për mua që të jem i urretur tash si lojtar. Gjithmonë e kujtoj se nga kam ardhur. Mënyra se si kemi jetuar në Gjermani më bëri personin që jam tash, më ka bërë ta vlerësoj suksesin”, shtoi ai. “Posa arrita në Gjermani fillova të luaja futboll. E shihja këtë si një mundësi për mua për të bërë diçka. Ishte puna ime, shkolla ime, ishte gjithçka për mua. Ishte e vështirë në një vend tjetër, nuk e flisja gjuhën dhe ishte mjaft e vështirë të shkoja në



shkollë. Është e vështirë të kesh të ardhme, të bëhesh dikush”, rrëfen Berisha. Është e kuptueshme që 32-vjeçar me një fëmijëri të kaluar jo si bashkëmoshatarët e tij, nxjerr “zjarr” nga sytë e tij kur luan. “Absolutisht, kjo vjen si rezultat i mënyrës se si jam rritur. Kur e luan këtë lojë dhe kur ju jep shumë juve, e vlerësoni atë edhe më shumë. Çdo ndeshje që e luaj shkoj më shumë i fokusuar dhe luaj edhe më me pasion. Kjo është mënyra se si mundohem të luaj. I jam mjaft falënderues kësaj loje dhe për atë se ku jam unë sot. Unë nuk shkoj asnjëherë në lojë dhe të them se kjo është vetëm një lojë. Do të zbris gjithmonë në fushë dhe do të them: kjo është jeta ime”, përfundoi Berisha. Pasi ka fituar disa trofe ai thotë se kjo e kë bërë më të urretur dhe më kërkues që në pjesën e mbetur të karrierës të mundohet të fitojë trofe të tjerë.

Ardian Nuhiu beson te grupi dhe kualiteti i lojtarëve të tij

## Shpresoj ta mbyllim kampionatin aty ku jemi aktualisht

Me disfatën nga Pobeda, beteja nuk është humbur, deri në fund ka edhe katër xhiro, ku sipas trajnerit Ardian Nuhiu, secila do të jetë si finale. Trajneri ambicioz thotë se në futboll duhesh të kesh fat, dhe kjo i mungoi ekipit në këtë përballje, derisa thotë se beson te ky grup i lojtarëve dhe kualiteti i tyre me shpresë se kampionatin do ta mbyllin aty ku janë aktualisht, në pozitën e shtatë

Koha Bujar KURTAJ

Shkup, 8 maj – Edhe pse pritej që me fitore ti ik edhe më shumë pozitës së balotazhit, skuadra e FC Shkupi të dielën ka pësuar një dush të vërtetë, duke u mundur në terren vendas nga Pobeda, konkurrentin direkt për

ikje nga balotazhi. Një disfatë e papritur, e cila nuk i dëshpëroi vetëm futbollistët, por edhe publikun në përgjithësi, të cilët ishin të bindur në fitore të ekipit, por ja që në një farë mënyrë edhe fati ua ktheu shpinën atyre, duke i marr parasysh rastet e shumta dhe një shtyllë dhe një transversale pas rezultatit 1:2. Mirëpo, me disfatën nga Pobeda, beteja nuk është humbur, deri në fund ka edhe katër xhiro, ku sipas trajnerit Ardian Nuhiu, secila do të jetë si finale. Trajneri ambicioz thotë se në futboll duhesh të kesh fat, dhe kjo i mungoi ekipit në këtë përballje, derisa thotë se beson te ky grup i lojtarëve dhe kualiteti i tyre me shpresë se kampionatin do ta mbyllin aty ku janë aktualisht, në pozitën e shtatë. “Në futboll duhesh të kesh fat, ndërsa në sot nuk e kishim atë. Ndeshjen e filluam shumë mirë, shënu-



am për 1:0, krijuam raste për të rritur epërsinë por nuk i realizuam rastet, ndërsa më pas u dënuam dhe pranuan gol për 1:1. Në pjesën e dytë situatë e njëjtë, krijuam raste, por nuk i realizuam, ndërkohë që mysafirët prapë na dënuan duke kaluar në epërsi me 1:2. Nga ky moment përsëri u ngritëm, krijuam raste, kishim një shtyllë dhe një transver-

sale, por topi nuk desh të përfundojë në gol. Sidoqoftë jemi një pikë para kundërshtarit, besoj se në katër ndeshjet e mbetura do të luajmë edhe më mirë. Besoj se ky grup i lojtarëve dhe kualiteti i tyre dhe shpresoj se në fund do ta mbyllim kampionatin aty ku jemi aktualisht”, thotë për gazetën KOHA, trajneri Nuhiu. Sipas tij, xhironja e para-

- Kundërshtarët e Shkupit:
- Xhiro e 33 - Pelisterin (Manastir)
- Xhiro e 34 - Bregalnica (Çair)
- Xhiro e 35 - Sileksin (Kratovë)
- Xhiro e 36 - Mkd. Gj.P. (Çair)
- Kundërshtarët e Pobodës:
- Xhiro e 33 - Bregalnica (Shtip)
- Xhiro e 34 - Mkd Gj.P. (Prilep)
- Xhiro e 35 - Rabotnički (Shkup)
- Xhiro e 36 - Renovën (Prilep)

fundit do të nxjerr në sipërfaqe shumë gjëra, ndërsa pranon se fati është në duart e tyre. “Në çdo ndeshje do të futemi për të fituar, pra fatin e kemi në duart tona. Ndeshjet të lehta në këtë kampionat nuk ka pasi deri më tani u dëshmuua se secili mund të mund secilin, andaj edhe katër xhirot e fundit nuk do të jenë të lehta dhe të gjitha do të jenë si finale. Do ti analizojmë mirë kundërshtarët dhe mendoj se xhironja e parafundit ku ne do të jemi mysafir i Sileksit ndërsa Pobeda e Rabot-

niçkit, do të nxjerr në sipërfaqe shumë punë”, përfundoi trajneri i bardhekalterëve.

ndërkohë, pas kësaj disfate Shkupi rrezikon seriozisht balotazhin për mbetje në elitën e futbollit vendor duke marr parasysh se përballet me kundërshtar të fortë si Pelisterin që lufton për të dalë në Evropë dhe Sileksin, e cila edhe përkundër disfatës nga Rabotnički ka gjasë për të kapur pozitën e katërt. Ndryshe, të dyja ndeshjet Shkupi i luan si mysafir, ndërsa dy ndeshjet kushitimsht i ka të lehta pasi takohet me ekipet që nga sezoni i ardhshëm do të jenë pjesë e Ligës së dytë, Bregalnica dhe Maqedonija Gj.P. Por, e njëjta gjë vlen edhe për Pobodën, pasi në dy xhirot e fundit takohet me kundërshtar si Rabotnički dhe Renova, por që të dyja do ti luan para tifozëve të saj.



Real Madrid janë rreshtuar për një goditje gjatë afatit kalimtar të verës për qendërmbrojtësin e Manchester Sittit, Eliakim Mangala. Reprerentuesi francez i ka bërë përshtypje klubit madrilien gjatë huazimit të tij këtë sezon në Valencia, të cilët duken të tërhequr për të finalizuar marrëveshjen në vlerë prej 18 milionë funteve

# Historia e pabesueshme e Amvryseas Distomo

Arritja e realizuar nga Amvryseas Distomo është bërë pjesë e historive të pabesueshme të futbollit. Sepse bota e topit dhuron shumë përralla, e fundit në rendin kohor ka qenë pa dyshim triumfi në Premier Ligë i Leicesterit të Klaudio Ranierit në sezonin 2015-16



Nga masakra e 1944-ës te festa për fitoren e kampionatit dhe kalimin në futbollin profesionist të Greqisë. Arritja e realizuar nga Amvryseas Distomo është bërë pjesë e historive të pabesueshme të futbollit. Sepse bota e topit dhuron shumë përralla, e fundit në rendin kohor ka qenë pa dyshim triumfi në Premier Ligë i Leicesterit të Klaudio Ranierit në sezonin 2015-16. Ndërkohë, suksesi i Amvryseas Distomo ka lënë shenjë në qytetëzën e vogël greke që aktualisht ka më pak se dymijë banorë. Një histori që është njolllosur gjatë

Luftës së Dytë Botërore nga nazistët, që më 10 qershor të 1944-ës kanë vrarë 218 persona mes të cilëve ka pasur gra, të moshuar dhe fëmijë. Masakra ka qenë e shpejtë: për të mos shkuar dy herë në të njëjtën shtëpi, nazistët kanë ngjyrosur me gjak një X të madh në dyert e banesave ku kishin kaluar një herë. Në qytetëzën e Distomos, 73 vite nga ajo masakër, tani festohet një kalim historik në Football Lige 2, kategoria e parë e futbollit profesionist grek. "Të Pavdekshmit", ky është

pseudonimi i ekipit, kanë grumbulluar 73 nga 78 pikët që kanë pasur në dispozicion në kampionatin e Enoseis Podosfairikon Somaiteion. Pse quhen "Të Pavdekshmit"? Ky është kuptimi i Ambrisos, emri i Distomos në lashtësi. Skuadra e drejtuar nga Agelos Kyriakou ka fituar garën me Kitheronas falë dy fitoreve të marra në dy javët e fundit të kampionatit, 2-0 kundër Parnasos dhe 5-0 ndaj PAO Kyrriaki. Por merita kryesore e këtij kalimin e kësaj arritjeje i shkon sulmuesit Mar-

ios Plakidas dhe 34 golave të tij. Tani kanë filluar festimet në Distomo. Grupi i lojtarëve që drejtohet nga Agelos Kyriakou ka shkruar historinë, edhe falë financimeve private, veçanërisht nga banorët e Distomos që kanë emigruar në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, të cilët kthehen shpesh në Greqi për të kaluar pushimet. Aventura në futbollin profesionist nuk do të jetë e lehtë për Amvryseas Distomo, por kjo do të jetë një tjetër histori e pabesueshme e kësaj qyteze të vogël greke.

## Tifozët e Bajernit, "bojkot" për ndeshjen në Leipçig

Bajern Munihiun e ka fituar kampionatin gjerman sivjet, kur ende nuk është mbyllur sezoni. Madje, skuadra bavareze ka pesë vite radhazi që rrëmben titullin, duke vendosur një rekord në futbollin gjerman. Nga ana tjetër, skuadra e cila sivejt i ka bërë më shumë presion rekordmenëve, RB Leipçig, dje arriti zyrtarisht kualifikimin në Ligën e Kampionëve dhe ndeshja e javës së ardhshme do të jetë pikërisht ndërmjet dy vendeve të para në fushën e Leipçigut. Problemi i kësaj përballjeje do

të jetë se Bayern nuk do të ketë ultrasit si mbështetës. Këta të fundit që dje kanë bërë me dije se nuk do udhëtojnë për në stadiumin "Red Bull Arena". Arsyeja dihet prej kohësh. Ata janë kundër ekepeve pa traditë dhe të ngritura me milionat e një pronari të vetëm, diçka e konsideruar "mëkat" në Gjermani. RB Leipçig nisi projektin e madh me kompaninë gjigante austriake në vitin 2009 dhe sezonin tjetër do ta shohë veten në Evropë, por në Munihi e urrejnë këtë fakt.



Publicitet

KOMUNA E ÇAIRIT  ОПШТИНА ЧАИР

Komuna e Çairit në bazë të nenit 84 të Ligjit për procedurë të përgjithshme administrative ("Gz. Zyrtare e RM" nr. 124/15), bën dorëzimin me

### SHPALLJE PUBLIKE

Me Aktvendim nr. 31-Pi1-2 nga data 24.01.2017 iu është urdhëruar personit **N. N.** që ta **LARGOJË** objektin rrethohe në rr. "Gjorgji Tomovski" PK 2830 KK Çair në Shkup në afat prej 3 (tre) dite dhe detyrohet ti kompensojë harxhimet në procedurë për të cilën do të aprovohet konkluzion i veçantë. Ankesa kundër këtij aktvendimi nuk e prolongon përmbarimin e tij.

I paralajmërohet palës se dorëzimi i shpalljes publike llogaritet për e rregullt dhe se pasojat negative të cilat mundën të ndodhin do ti bartë vetë pala.

### URGJENTISHT

Shitet shtëpi në lagjen Serava-Shkup në rr. "7 korriku" nr. 8 afër spitalit gjinekologjik, shtëpia është e ndërtimit të ri me dokumentacion të kompletuar. Kontakt tel. 070-775-703; 071 372 221

Urgjentisht shitet shtëpi në rr. Pere Toshev nr. 30 - Xhon Kenedi, Shkup me sipërfaqe prej 140 m2 oborr dhe 116m2 objekt banimi. Kontakt telefoni 072/643 093



Tel: 02 3179 - 904, Fax: 3118 - 060  
marketing@koha.com.mk

Në bazë të neneve 125, 125-a dhe 131 të Ligjit për Arsimin e Lartë (Gaz. Zyrtare e RM- së nr. 35/2008, 103/2008, 26/2009, 83/2009, 99/2009, 115/10, 17/11, 51/11, 123/12, 15/13, 24/13, 41/14, 116/14, 130/14, 10/15, 20/15, 98/15, 145/15, 154/15, 30/16 dhe 120/16), Rregullores për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në thirrje mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe të bashkëpunëtorëve në Fakultetin e Shkencave Islame Shkup, nenit 162 të Statutit të Fakultetit të Shkencave Islame - Shkup, si dhe në bazë të vendimit të Këshillit mësimor-shkencor të FSHI-së të mbajtur më 26.04.2017, shpallet:

### KONKURS

Për zgjedhjen dhe ri-zgjedhjen e mësimdhënësve në të gjitha thirrjet mësimore shkencore dhe në thirrje të bashkëpunëtorëve I. Shpallet Konkurs për zgjedhjen e mësimdhënësve në të gjitha thirrjet mësimore- shkencore dhe të bashkëpunëtorëve në Fakultetin e Shkencave Islame Shkup:

1. Një mësimdhënës për fushën e Sociologjisë dhe lëndët: Hyrje në studimet e religjionit; Hyrje në shkencën e hadithit dhe Metodologjia e studimit të hadithit.
2. Një mësimdhënës për fushën e Gjuhës angleze.
3. Një mësimdhënës nga fusha e Pedagogjisë dhe pedagogjisë islame dhe lënda: Etika e religjionit.
4. Një mësimdhënës nga fusha e Gjuhës shqipe dhe lënda: Fonetika dhe morfologjia e gjuhës arabe.

Kushtet për thirrjen mësimore-shkencore docent, profesor inordinar dhe profesor ordinar:

- ▶ Thirrje mësimore - shkencore, me Vendim të organit kompetent- Këshillit mësimor- shkencor të institucionit të arsimit të lartë, nëse e posedon;
- ▶ Diplomë për gradën shkencore-doktor i shkencave nga fusha shkencore në të cilën zgjidhet;
- ▶ Kandidatët që konkurrojnë duhet të kenë kontinuitet në studimet nga fusha përkatëse;
- ▶ Listë të punimeve shkencore dhe publikimeve profesionale të botuara, si dhe kopje të punimeve të publikuara;
- ▶ Biografi e shkurtër;
- ▶ Ta dorëzojë punimin e doktoratës;
- ▶ Vërtetim për njohjen e një gjuhe të huaj;
- ▶ Njohje të gjuhës shqipe - shkrim dhe lexim;
- ▶ Certifikatë nga libri amë i të lindurve;
- ▶ Certifikatë e shtetësisë.

\*Kandidatët duhet t'i plotësojnë kushtet për zgjedhje në thirrje mësimore-shkencore, të parapara me nenin 125 dhe 125-a të Ligjit për Arsimin e Lartë.

\*Fletëparaqitjen bashkë me dokumentet e nevojshme, kandidati duhet t'i dorëzojë në afat prej 5 ditë pune, nga dita e shpalljes së Konkursit, në Dekanatin e Fakultetit të Shkencave Islame- Shkup, në adresën: f. Kondovë Shkup.

Shkup, 08.05.2017

Fakulteti i Shkencave Islame - Shkup



ZBRITJE DERI NË 30%  
**CENTAR ZA GUMI**  
NË RRUGEN E PLASTIKAVE PËRBALL MARMARIS.  
Kontakt Tel: 070-222-388, 071-263-723 dhe në facebook CentarZaGumiHR



Interi është një hap larg historisë, por asaj të gabuarës. Mungon vetëm një, më pas do të jetë një rekord: shtatë ndeshje pa fitore, ecuria më e zikaltërvëe pa fitore që nga momenti i krijimit të Serie A është prej tetë ndeshjesh

Tani Interi është një hap larg historisë, por asaj të gabuarës. Mungon vetëm një, më pas do të jetë një rekord: shtatë ndeshje pa fitore, ecuria më e zikaltërvëe pa fitore që nga momenti i krijimit të Serie A është prej tetë ndeshjesh. Ka ndodhur në sezonin 1947-48, nga java e 22 tek ajo e 29-ta, me një bilanc prej 5 humbesh dhe 3 barazimesh. Në këtë sezon kjo ecuri ka arritur në shtatë ndeshje, me dy barazime dhe pesë humbje: pas fitores 7-2 kundër Atalantas skuadra është shfryrë. Është zhdukur iluzioni i Ligës së Kampionëve, pas barazimit 2-2 me Torinon rremat janë tërhequr mbi varkë dhe askush nuk është shqetësuar për të larguar ujin që po futej nga të gjitha anët. Për të shmanjur futjen në histori mbetet ndeshja e ardhshme kundër Sasuolos, por katastrofa ka ndodhur tashmë. Dy pikë në shtatë ndeshjet e fundit, në të cilat Inter do të

## Interi në rënie të lirë, një hap larg historisë



ishte e fundit në renditje, mbrapa Palermos dhe Peskaras. Në këtë ecuri pa fitore ka pësuar 2,1 gola për ndeshje, një konfirmim numerik i një mbrojtjeje që fut ujë nga të gjitha anët. Inter, në fakt, pëson gol prej dhjetë ndeshjesh radhazi në kampionat. Zëvendësimi i Icardit, kapiteni dhe lojtari simbol, është një tjetër shenjë e një grupi që nuk

ka lider, si në aspektin teknik edhe në atë psikologjik. Askush nuk mund ta fajësojë Piolin për zëvendësimin, me Mauriton që ka prekur vetëm 18 topa gjatë ndeshjes, duke humbur tetë prej tyre. Paradoksi është se pavarësisht kësaj ecurie, falë ndalesave të Fiorentinas dhe Milanit, vendi i gjashtë dhe Europa nuk ishin të paarrtshëm. Por

duket se kompeticioni i dytë më i rëndësishëm Evropian për klube nuk i intereson zikaltërve, ndoshta as klubit. Në këtë moment nuk pritet të ketë zgjedhje drastike, edhe pse një shkarkim tjetër do të krijonte më shumë probleme nga sa mund të zgjidhte. Pritet fundi i sezonit, me shpresën për të ndalur në njëfarë mënyrë hemorragjinë.

## Ofertë nga Bajerni për Veratin

Mbrëmja e së dielës ishte e madhe për prokuratorin Donato Di Kampli, i cili prezantoi në Milano një aventurë profesionale, të quajtur "Supporter". Bëhet fjalë për një kompani menaxhimi, që do të japë ndihmë në 360 gradë (mbrojtje ligjore, menaxhim dhe konsulentë financiare, marketing dhe menaxhim "ad hoc") për lojtarët që duan t'i bashkohen. Gjatë mbrëmjes, sigurisht ai foli edhe për të ardhmen e klientit të tij, Marko Verati. Përsëri, Di Kampli ka konfirmuar qëndrimin e djaloshtit italian të talentuar në Francë, edhe pse, në të njëjtën kohë, ranë dakord për të pranuar një

ofertë nga Bayern Munihi: "Po e përsëris për herë të njëjndtë, Marko është i lumtur në Paris. Ai ka një kontratë deri në qershor 2021, ndaj patjetër duhet ta respektojë vullnetin e PSZH-së, një klub që ai e do. Juventus dhe Interi nuk do të ishin as rreshtin e parë dhe as në të dytin, në rast të një ankandi për Veratin. Oferta e Bayern Munihi? Ndoshta ka, por kush është i interesuar duhet të bisedojë me mua. Ne do të takohemi me drejtuesit e klubit francez për të kuptuar projektet e tyre, nëse ende e kultivon ambicien për të fituar Ligën e Kampionëve", ka deklaruar Di Kampli.



## Konte gati të shpenzojë një shumë rekord për Lukaku



Trajneri i Çelsit Antonio Conte, sipas shtypit anglez, mësohet t'i ketë thënë klubit se kërkon të shpenzojë një shumë rekord për të siguruar Romelu Lukakun verën e ardhshme. Sipas "MailOnline", Lukaku duhet të kushtojë dyfishin e 28 milionë funte të paguara nga Everton për ta marrë nga londinezët në 2014-ën, për këtë arsye, nëse Conte kërkon të sigurojë sulmuesin belg duhet të shpenzojë më shumë se shifra rekord (për Çelsin) 50 milionë funte (59 milionë euro) e investuara për Fernando Torres. Megjithatë, Conte e ka bërë të qartë se Lukaku është jetik për planet e tij të ardhshme. 23-vjeçari ka një ecuri të jashtëzakonshme në Premier Ligë, veçanërisht duke parë moshën e tij të re, në sezonin aktual ai ka realizuar 24 gola, më shumë

se çdo sulmues tjetër në kampionatin anglez, duke e çuar numrin total të golave në këtë kampionat në 86. Disa mund të pyesin nëse ai vlen me të vërtetë kaq shumë, por duket se trajneri italian është i vendosur për ta bërë pjesë të skuadrës së tij.

Ndërkohë, Çelsi duket se është gati të bëjë një ofertë prej 20 milionë funte për sulmuesin e Sasuolos Domenico Berardi. Ish-trajneri i Juventusit mendon se ai do të ishte përforcimi i duhur për "Blutë", që sezonin e ardhshëm do të kthehen të luajnë në Ligën e Kampionëve. Conte është gati të tejkalojë çdo ofertë që mund të bëjë Juventus. "Zonja e Vjetër" në fakt ka të drejtën për të blerë lojtarin për 15 milionë funte pasi e shitën këtë të fundit te Sasuolo për 8 milionë funte.

## Roma, shumë më lart se Milani

Stacioni i shëmtuar për Milanin, i cili vazhdon periudhën e vet negative. Kuqezinjtë kanë pësuar një humbje të rëndë, në shtëpi, 4-1 në duart e Romës. Një tjetër hap i gabuar muajin e fundit të sezonit për Montella dhe të tijtë. Trajneri Vincenzo Montella nuk ka nxjerrë justifikime, por ka pranuar supremacinë e Romës. Duke folur pas ndeshjes për mikrofonat e "Sky Sport", ai pranoi: "Roma ka qenë shumë më lart se ne. Urime lojtarëve dhe trajnerit në stol. Besoj se ishim në gjendje të rivalizojmë me kundërshtarin, por nuk zgjati shumë", ka theksuar Montella. Lidhur me një statistikë domethënëse të situatës kritike të Milani,



marrjen e vetëm dy pikëve në 4 ndeshjet e fundit, trajneri kuqezit thotë: "Sonte skuadra dha gjithçka, edhe një pikë do të ishte vendimtare për vendin e 5-të. Do të luajmë fort kundër Atalantës, e cila ka një nivel më

të ulët sesa lojtarët e Romës. Ky që po kalojmë është një problem finalizimi. Edhe sonte kemi pasur disa mundësi, por shpesh kemi gabuar në momentet vendimtare. Ne kemi nevojë për entuziazëm dhe vullnetin për të

luftuar. Kemi hedhur themelet për të ardhmen, jemi ende të gjashtë në renditje, çka do të thotë se diçka e mirë është bërë. Kjo nuk është koha për të folur mbi të ardhmen time. Jam i detyruar, së bashku me klubin, për të qëndruar të fokusuar vetëm në të tashmen. Dua të them se drejtuesit e rinj të klubit janë duke punuar në rrugën e drejtë, nuk i shqetëson asnjë lloj bilanci. Secili prej nesh e ndien se diçka ka ndryshuar, por kjo nuk do të thotë që ne duhet të humbasim ndeshjet. Unë nuk mendoj se do të ketë revolucion, kam ide mjaft të qarta nga fillimi i vitit se çfarë i duhet Milanit", ka deklaruar Montella.

## Debat i fortë mes Nejmarit dhe Unzue

Përplasja me njërin nga yjet e Barcelonës mund ta dëmtojë njërin nga kandidatët për stolin e skuadrës katalanase. Sipas "Mundo Deportivo", zbulohet se Neymar dhe zv.trajneri Unzue kanë pasur një debat të ashpër të enjten e kaluar në sytë e gjithë stafit. Kjo ka ndodhur gjatë trajnimit të Barcelonës. Sipas informacioneve të së përditshmes spanjolle në fjalë, ndihmëstrajneri i Luis Enrique iu afrua brazilianit gjatë seancës për t'i bërë disa vërejtje, që Neymar



nuk i pranoi me dëshirë. Biseda ishte gjithnjë në rritje në fushë dhe zv.trajneri e ka këshilluar hapur sulmuesin brazilian për ta kontrolluar

jetën e tij jashtë fushës, duke i kërkuar që të fokusohet më shumë në karrierën si futbollist. Kjo gjë

nuk i ka pëlqyer Nejmarit, i cili është përgjigjur në mënyrë të zemëruar për Unzue. As lojtari dhe as zv.trajneri, sipas "Mundo Deportivo", që konfirmoi përplasjen, nuk e kanë mohuar incidentin. Përplasja ndodhi vetëm një ditë pasi braziliani kishte pohuar dëshirën e tij që Unzue të jetë pasardhësi i Luis Enrique në stolin drejtues të skuadrës nga "Kamp Nou". A do t'i qëndrojë kësaj bindjeje Neymar edhe pas përplasjes në fjalë? Koha do ta tregojë.



Legjenda argjentinase, Diego Maradona, është caktuar trajner i ekipit Al-Fujairah FC nga Emiratet e Bashkuara Arabe. 56-vjeçari i rikthehet punës së trajnerit për herë të parë nga viti 2012 kur u shkarkua nga ekipi tjetër i EBA, Al Uasli

Liga e Kampionëve

# Juventus ndaj Monakos kërkon finalen



Që të shkojë në finalen e Kardifit, Juventus duhet të mbyllë me sukses gjysmëfinalen ndaj Monakos, mjafton edhe të administrojë me profesionalizëm atë që ndërtoi në Principatë. Dy golat e shënuar në fushën e skuadrës franceze japin jo pak siguri për gjysmëfinalen e kthimit, por Liga e Kampionëve është një kompeticion episodik, ndaj, për këtë arsye, bardhezinjtë do të bëjnë çdo përpjekje për të shmangur surpriza të këqija. Njeriu i momentit është padyshim Gonzalo Higuain. Pas dopietës në "Louis II" dhe golit "in extremis" kundër Torinos, sulmuesi amerikano-jugor mund të mburret me vendin e tretë të

përkohshëm (për golat në një sezon) në historinë e shënuesve të Juventusit. Vendin e parë të kësaj renditjeje e mban Felice Borel, në sezonin 1933-1934, kur shënoi 37 gola. Në vendin e dytë, referuar sezonit 1925-1926, e mban Ferenc Hirzer, me 35 gola. Vendi i fundit i këtij podiumi, ose i treti, me 32 gola, janë Aleks Del Piero, David Trezeguet dhe Gonzalo Higuain. Pra, duke gjetur një tjetër gol personal, kampioni nga Argjentina do të bëhet sulmuesi më i mirë në historinë e Juventusit, që shënon më shumë gola në një sezon të vetëm, që nga lufta e deri më sot. Mundësitë për qendërsulmuesin nuk mungojnë. Me tri ndeshje të mbetura në

kampionat, ku Higuain lufton së bashku me një numër të madh konkurrentësh për të fituar skeptrin e golashënuesit më të mirë; me finale e Kupës së Italisë dhe, ndoshta, aktin final të Ligës së Kampionëve, gola të tjerë do të shënojnë. Blerja më e shtrenjtë e Seria A, 90 milionë euro, e ka ndihmuar në masë të madhe "Zonjën e Vjetër" për më tepër cilësi, duke qenë pjesëtarët i një skuadre ndoshta të papërsëritshme bardhezi. Pasi ka shkëlqyer edhe te Real Madridi dhe Napoli, Higuain ka vënë në shfaqje gjithë talentin e tij të madh. Por, në Torino, ai ka kapur kulmin maksimal të maturimit, duke tentuar të prekë lartësi të

Dy golat e shënuar në fushën e skuadrës franceze japin jo pak siguri për gjysmëfinalen e kthimit, por Liga e Kampionëve është një kompeticion episodik, ndaj, për këtë arsye, bardhezinjtë do të bëjnë çdo përpjekje për të shmangur surpriza të këqija

pazbulueshme. Nga ana tjetër, Kilian Mbape nuk ka ndër mend që të dorëzohet kaq lehtë, në pritje të gjysmëfinalës së kthimit kundër Juventusit. Vërtet humbja 2-0 në Montekarlo është një rezultat i keq, por në futboll përmbyset ekzistojnë dhe sulmuesi i talentuar i Monakos karikon shokët e tij: "Kjo fitore në kampionat na jep shumë forcë", tha Mbape pas suksesit të së shtunës me Nansi. "Do të udhëtoj në Torino për t'i bërë keq Juventusit, sepse personalisht shoh një forcë të madhe besimi në grup, e cila tregon se nuk kemi vdekur. Prandaj, në 'Juventus Stadium' do të na duhet të jemi më të egër dhe të shënojmë një gol të shpejtë, pasi kështu do t'i vinim në presion ata dhe mund ta përmbysim", ka deklaruar Mbape.



## Nuk jemi të interesuar për Moratan

Masimiliano Mirabelli, drejtori sportiv i Milanit, thotë se Alvaro Morata nuk është në agjendën e klubit lombard. Edhe pse sulmuesi i Real Madridit është në fokusin e shumë klubeve evropiane, ngaqë nuk ka gjetur hapësirat e duhura të aktivizimit te Real Madridi, Milani nuk është një prej tyre. Kjo u shpreh nga Mirabelli për "Mediaset Premium": "Unë shkova në Madrid për të parë një ndeshje dhe jo për të parë Morata. Milani nuk është i interesuar për këtë futbollist", ka thënë Mirabelli para disfatës 4-1 të tijve ndaj Romës. "Strategjia jonë është e pavarur nga klasifikimi. Planet tona nuk do të ndryshojë në varësi të pozicionit tonë të fundit në tabelën e klasifikimit. Aktualisht kemi një ekip të ri, një grup të mirë lojtarësh. Ne e dimë se na duhen lojtarë me potencial dhe eksperiencë për të rritur nivelin. Kur merkato të hapet, ne do të veprojme në përputhje me rrethanat. Kemi ide të qarta, e dimë përgjegjësinë tonë dhe e dimë se në vitet e ardhshme Milani nuk

mund të jetë në pozitë të tanishme", ka theksuar Mirabelli. "Donaruma? Xhixhio është një lojtar i rëndësishëm dhe ne e pamë këtë në ndeshjen kundër Romës. Ne duam që të qëndrojmë në portën e Milanit për një kohë të gjatë", kështu thotë drejtori i përgjithshëm i Milanit, Marko Fasone, që nuk ka dyshime për të ardhmen e Donaruma, i pyetur në lidhje me qëndrimin e tij në Milano. Por, përveç portierit, menaxheri i kuqezinjve bën edhe një premtim për tifozët: "Ne kemi një plan të qartë, kemi një detyrim për t'u kthyer në Evropë. Do të kthehemi mes ekipeve të mëdha në 4-5 vitet e ardhshme." Një prononcim edhe për trajnerin e ardhshëm të Milanit: "Montella? Unë kam folur tashmë dhe e përsëris: Ai gëzon respektin e shoqërisë, ndaj do të jetë trajneri ynë edhe për sezonin e ardhshëm. Fabregas? Është një lojtar i rëndësishëm dhe ne kemi punuar për të, por do të flasim në fund të kampionatit", ka theksuar Fasone.

## Rinovon Mesi

Leo Messi ka rinovuar kontratën e tij me Barcelonën. Katalanasja "SPORT" është në gjendje të thotë se lojtari argjentinian ka shënuar "golin e jetës", duke zgjeruar bashkëpunimin e tij me klubin katalanas, pas bisedimeve me bordin drejtues. Bisedimet mes babait të lojtarit dhe klubit kanë konverguar në parametrat e përcaktuar nga të dyja palët. Merret vesh se takimi i mesit të janarit, kur për herë të parë u ulën ballë për ballë Hosep Maria Bartomeu dhe Horhe Mesi, kishte hedhur themelet, mbi të cilat është punuar. Që atëherë kanë kaluar pothuajse katër muaj, ndërsa tashmë qëndrimet janë shumë afër. Në ditët e fundit, duke përfutur edhe nga prania e Jorge Mesit në Barcelonë, ka pasur përparime të mëdha në bisedime, deri në pikën që optimizmi është mbizotëruar te Barcelona. Drejtuesit e klubit pranojnë se ky është një lajm i madh për "barcelonismo".



Një shembull i kësaj ishin deklaratat e bëra nga Zhordi Mestre, zëvendës presidenti sportiv, pas ndeshjes kundër Vilarealit, teksa pretendonte se "procesi i rinovimit me Mesin po përparon mirë, ka për qëllim mbërritjen në finale". Deri tani, presidenti Hosep Maria Bartomeu ka qenë duke punuar në heshtje me babain e lojtarit. Merret vesh se gjërat e mëdha kanë dakordësi tashmë, kanë mbetur vetëm disa gjëra të vogla, por të rëndësishme, për të vërtetuar se ekziston një marrëveshje në parim mes palëve. Nuk ka më dyshime, Mesi dhe

Barcelona do të jenë bashkë edhe për pesë sezona. "Rinovimi është çështje javësh", ka avancuar më tej Mestre. Vetë Lionel Mesi nuk dëshiron që ky proces të shpallet, përderisa ekipi është i përfshirë në luftën për La Liga dhe "Copa del Rey", ndaj zyrtarizimi i rinovimit mund të shtyhet deri në fund të sezonit. Kontrata aktuale e Mesit përfundon në vitin 2018. Ky është një rinovim i madh, sepse, në moshën 29-vjeçare, mund të jetë kontrata e fundit si lojtar i Barcelonës. Mesi është ende i veshur me blu dhe të kuqe. Përparësia e tij kanë qenë gjithmonë titujt.

## Barcelona synon Konten, Abramoviç ka gjetur zëvendësuesin

Antonio Conte mund të largohet nga Çelsi pas vetëm një sezoni të suksesshëm në "Stamford Brixh" dhe është në krye të listës së të kërkuarve të Inter. Trajneri italian ka bërë një punë mahnitëse në sezonin e tij të parë të "Blutë" e Londrës, duke i udhëhequr ata menjëherë drejt rikthimit të titullit kampion në Premier Ligë. Conte është nën kontratë me Çelsin edhe për sezonin e ardhshëm, me klubin që planifikonte të ulej dhe diskutonte një marrëveshje të re me trajnerin këtë muaj. Tekniku italian u zhvendos një vit më parë në Angli pa bashkëshortin dhe vajzën e tij, të cilat nuk janë bashkuar ende më atë në Londër. Nga ana tjetër, Barcelona po konsideron mundësitë për zëvendësimin e trajnerit Luis Enrique, i cili pat deklaruar që në shkurt të këtij viti se do të tërhiqet



në fund të sezonit. Në këto kushte, sikurse raporton "express.co.uk" Conte ka tërhequr vëmendjen e klubit blaugrana, falë transformimit që ai mundi të realizojë te Çelsi. Për këtë arsye, hierarkia e klubit katalanas është gati të bëjë lëvizjen e saj për të transferuar italianin në Spanjë. Raportohet gjithashtu se nëse Roman Abramoviç nuk do të mund ta bindë Conte që të qëndrojë në Londër, atëherë pronari i "Bluve" nuk do të duhet të kërkojë shumë larg tij për zëvendësuesin e italianit.

mund ta bindë Conte që të qëndrojë në Londër, atëherë pronari i "Bluve" nuk do të duhet të kërkojë shumë larg tij për zëvendësuesin e italianit.

## DASHI (20/III-20/IV)



Akoma një ditë në shoqëri jo të mirë me Hënën tek Peshorja që pengon të realizojë projektet tuaja. Nuk është rasti për të shkarkuar mbi partnerin zhgënjimet e një projekti të shkuar dëm, kërkonti mbështetjen e tij dhe mirëkuptimin e tij. Bëni mirë të pini sa më shumë ujë.

## DEMI (21/IV-20/V)



Yjet ekzaltojnë ekuilibrin tuaj dhe dashuri për gjërat e vogla. Përfitoni për ta bërë më të këndshme shtëpinë ose ambientin e punës. Do të keni mundësi të diskutoni me një person që ngjall interesin tuaj. Bëni mirë të filloni një djetë të pasur me perime dhe fruta të stinës.

## BINJAKËT (21/V-20/VI)



Nën qiellin e mbushur me yje shumë favorizuese si puna ashtu edhe dashuria do të shkojë shumë mirë dhe pa keqkuptime. Nëse jeni në kërkim të shpirtit binjak do të keni të gjithë armët në dispozicion për të joshur atë që ju pëlqen. Ndjejeni në formë dhe jeni të bukur si dielli.

## GAFORRIA (21/VI-22/VII)



Ndonjë e papritur mund të prishë planet tuaja për ditën. Lini mënjane humorin e keq dhe armatosuni me durim sepse shumë shpejt do të gjeni zgjidhjen e duhur. Ndonjë diskutim do të përfundojë duke rënduar atmosferën në çift, por do të mjaftojë pak për të ju bërë të rigjeni sintoninë e duhur.

## LUANI (23/VII-22/VIII)



Duke treguar kopetencë dhe në të njëjtën kohë simpati dhe karizëm, mund ta tregoni këtë në cdo situatë vecanërisht kur bëhet fjalë për të ju imponuar të tjerëve. Kontaktet e nevojshme dhe komunikimi në punë është i rëndësishëm. Do të dini të shfrytëzoni sa më mirë mundësitë që keni.

## VIRGJËRËSHA (23/VIII-22/IX)



Sot do të jeni të detyruar të rimerrni një diskutim që mendoni, ose shpresoni, që ishte mbyllur përfundimisht. Pas një diskutimi sqarues mund të ndryshoni opinionin dhe të vendosni të ktheheni në hapat tuaja. Përpara se të mbyllni një herë e mirë një histori tashmë të lodhur, përpuni të bëni një tentativë të fundit.

## PESHORJA (23/IX-22/X)



Nga takimet në punë në mbrëmje mundane, do të jeni të parët që do të mrekulloheni me shumë gjëra që do arrini të bëni me sukses në këtë ditë. Një çështje do të mbyllet me avantazh, por bëni kujdes se si do ti investoni shumat e parave që keni mbledhur. Ditë e favorshme për aktivitete fizike dhe shopping.

## AKREPI (22/X-21/XII)



Atë që deri tani e keni konsideruar vetëm si një hobi, praktik dhe teorik, do mund të transferohet dalëngadalë në një mundësi të re pune. Lëvizni me durim, por bëhuni edhe largpamës dhe investojini paratë tuaja në një biznes frutdhënës.

## SHIGJETARI (22/XI-21/XII)



Jini gjithmonë gati për të kapur si duhet të rehat me optimizëm, kështu që mos u trembni edhe nga ndonjë e papritur e vogël që mund të keni. Të jepni më të mirën tuaj do të jetë objektiviteti juaj, mbi të gjitha kur në lojë janë realizime profesionale dhe të ardhura ekonomike.

## BRICJAPI (22/XII-20/I)



I keni të gjitha letrat në dorë që projektet tuaja të mbarojnë mirë, por nuk është ky momenti për të vënë të bardhën mbi të zezë. Mos jini i paduruar, nxitimi mund të ju shtyjë të bëni gabime si në punë ashtu në sektorin financiar. Mos e ekzagjeroni me pijet e gazuara.

## UJORI (20/I-19/II)




Mundësi shumë të mira për ata që punojnë në botën e artit ose të spaktaklit. Jeta shoqërore nuk shkon shumë mirë megjithatë do të jetë kalimtare. Një aktivitet i shëndetshëm fizik, mundësisht në ajër të pastër do ju duhet për të larguar shqetësimet me qarkullimin e gjakut.

## PESHQIT (20/II-19/III)



Një takim i rastësishëm do ju sjelli magjinë e së kaluarës. Kultivoni kujtimet, por mos lejoni të përfshihen nga nostalgjia. Derisa do të humbeni mbrapa ëndërrave të porealizueshme, do të jetë e vështirë për ju të arrini të ndërtoni dicka konkrete me ata që janë pranë jush.

<b>Mensur Mamuti</b>	THEMELUESI I OPELIT, NË FOTO	TRAJNERI I KF "TREPÇA" REP. FEDERALE DHE QYTETI I LINDJES SE A.O.	Z	NORVEGJIA	PARMAK ME SHUFRA HEKURI (SH.)
ARGËTIM, DEFRIM					
ORENDI, ZBUKURIM					
MBRETËRI E LASHTE NË LINDJEN E AFERT (PASHQ.)					
KANTON NË FRANCË GOVATA				LITRI TRAJNERI TURK, FATHI (SHQ.)	
<b>K</b>					
MALET SASI E MADHE FLORINJSH					



<b>TH</b>				KULLOSAT	FLORI	<b>KOHA</b>	VOZITËS TË TANKEVE PRODHUES PIRUNASH	<b>T</b>	SË SHPEJTI (FRENGJ.) A...
RAJON NË LESOTO						SHTËPI PUBLIKE TANTALI			
RAJON I MADH NË KUFIRIN: INDI - PAKISTAN - KINË	POETI FRENG, ALFONS DE PËRMËR VETOR								
<b>K</b>					HYJNESHË GREKE, MOTRA E IRISIT ÇËSHTJA				
TRENTALEXANDER ARNOLD MBIEMRI DHE EMRI I PIKTORIT GUERMAN				Ë. T. FIS INDIAN, ENOK		FIT UNIVERSAL INTERNET NUMBER REMOTE BIOS UPDATE			
<b>H</b>									
<b>KOHA</b>	QYTET NË MADAGASKAR METRI								
PËRBINDËSHIT ME TRUP TË NJERIJT DHE ME KOKË TË DEMI									

ZGJIDHJET: Z, AHENG, DEKOR, ASIRI, MER, L, KORITA, PYJET, THESAR, T, LERIBA, PAB, LAMARTINI, KASHMI, ARKE, TAA, ET, UIN, HAJDER ERNST, MANAMBATO, MINOTAURËT.

## Sudoku

shumë i lehtë

shumë i vështirë

			1	4	3		5	2											
			5								8								4
				2	8									6					
8		1						7	3			8	4						1
4		5					8		1					2	5				
2	3						6		5						8	3			
			6	8							5			3					
3						7						6		8					9
9	5		2	3	1							1	4						

Shumë i lehtë: 689143752, 724596318, 513728964, 891465273, 465372891, 237819645, 172684539, 348957126, 956231487. Shumë i vështirë: 843721695, 976358124, 251946783, 684573912, 739812546, 125694837, 598237461, 462185379, 317469258.



## Bëmë baba të të ngjaj!

Byron dhe Emily Schlenker, babë e bijë nga Sirakuza, New York kanë hyrë në librin e rekordeve Guinness pasi janë personat me gjuhën më të gjerë në Tokë. 8.5 cm arrin gjuha e Byron dhe mund të krahasohet me një iPhone 6. Gjerësia e gjuhës së 16-vjeçares Emily arrin në 7.3 cm dhe është më e gjerë se një kartë krediti.



## Kjo grua detyron burrin ta pickojë me bletë 30 herë në javë



Të gjithë e dimë se pickimi nga bletët është i dhimbshëm dhe më mirë të evitohet, por ky rregull nuk ka vlerë për 36-vjeçaren Ingrid Watt, e cila e ka një ritual të çuditshëm javor duke detyruar burrin e saj ta pickojë 30 herë me bletë, me shpresën se do të mund të ndalojë një sëmundje të gjëndrave limfatike që i rrezikon jetën. Në një trajtim që shumëkush do ta kon-

sideronin të frikshëm burri i saj çdo të hënë, të mërkurë dhe të premte mban 10 bletë me pincet derisa ta pickojnë dhe të lëshojnë helmin djegës në lëkurën e kurrizit të saj, duke mbajtur thumbin brenda për 20 minuta. Edhe pse është shumë e çuditshme Ingrid beson se helmi po mban sëmundjen nën kontroll, diçka që medikamentet mjekësore kanë dështuar

për shumë vite. Ajo insiston se dhimbja ia vlen sepse ndihet më mirë tani, diçka që se ka bërë ndër vite. "Nuk e mendoja në fillim se do të mund të arrija deri në 10 pickime sepse është shumë e dhimbshme, por duke parë përmirësimet ia vlejti. Helmi nga pickimi i bletës nuk është për të gjithë por për mua është i mahnitshëm, shpresoj se për dy vjet do të bëhem më mirë", thotë ajo. Ingrid nga Iverness në Skovi, mendon se është infektuar me linë e deleve kur ishte adoleshente dhe luante qengjat në një fermë në Orkneys. Lija e deleve është një infeksion bakterial që përhapet nga parazitët, e cila po të vërehet shpejt mund të trajtohet me antibiotikë, por ama nëse nuk zbulohet që në fazat e para mund të godasë sistemin imunitar, shkaktojë sëmundje të zemrës, dhe humbje të memories.

## Pse nuk duhet t'i rrihni fëmijët

Një studim i ri ka zbuluar se rrahja e fëmijës suaj mund të jetë e dëmshme për sjelljen e tyre dhe të shkaktojë probleme afatgjata të shëndetit mendor. Sipas studimit nga Universiteti i Teksasit, fëmijët që janë rrahur, në të vërtetë janë më pak të bindur dhe më shumë gjasa sfidojnë prindërit e tyre duke u sjellë keq. Këta fëmijë në të ardhmen më shumë gjasa do të tregojnë



tendenca anti-sociale, janë të pirur për të qenë agresiv

dhe të vuajnë nga probleme të shëndetit mendor. Rezultatet kanë dalë pas një studimi që ka zgjatur 50 vjet dhe janë analizuar 160,000 fëmijë. "Rrahja jep të kundërtën e asaj çfarë duan të arrijnë prindërit", ka thënë Andrew Grogan-Taylor, autori i studimit. Rezultatet e këtij studimi vijnë më pak se një vit, pasi OKB sugjeroi që rrahja e fëmijëve të shpallej e jashtëligjshme.

## KALENDARI HISTORIK 9 PRILL

- 1386 - Traktati i Vindorit mes Portugalisë dhe Anglisë.
- 1502 - Kolombo nisët nga Spanja në lundrimin e tij të katërt dhe të fundit drejt Botës së Re.
- 1689 - Mbreti anglez Willem III i shpallë luftë Francës.
- 1766 - John Byron kthehet në Angli pas një udhëtimi të tij përreth botës.
- 1901 - Australia hap parlamentin e saj të parë në Melburn.
- 1955 - Republika Federale e Gjermanisë i bashkohet NATO-s.
- 1960 - Nigeria bëhet pjesë e Shteteve të Komonveltit.
- 1964 - Krushçovi viziton Egjiptin.
- 1988 - Ndërtesa e re e Parlamentit të Australisë në Kanbera hapet nga Mbretëresha Elizabeta.
- 2004 - Vritet kryetari i Çeçenisë Ahmet Kadirov nga një eksplozim në një fushë të minuar gjatë një parade përkujtimore të Luftës së Dytë Botërore në Grozni të Çeçenisë.

## A E DINI SE... ?



Në përgjithësi një deve mund të japë 5-20 litra qumësht në ditë, madje edhe pa pirë ujë për rreth 3 javë. Problemi qëndron se qumështi i devesë nuk koagullohet lehtësisht. Falë zhvillimit të teknologjisë, shkencëtarët përdorin rennet për të bërë djathë deveje.

Tuneli më i gjatë i trenit në botë, "Gotthard Base Tunnel" është hapur në dhjetor të viti 2016. Ky tunel është 57 km i gjatë dhe është tuneli më i gjatë i trenave në botë. Ai shkuroi kohën e udhëtimi dhe nga Cyrihu në Lugano udhëton për 45 minuta. Ky projekt zgjati 20 vjet dhe u hap sipas kohës. Sa shumë zvicercane.



Hiliteri dëshironte që të bëhej prift. Ai u mahnit nga një prift në moshën katërvjeçare, pasi prifti arriti ta shpëtonte atë një liqen i ngrirë. Si i rritur, Hitlerit i ndryshoi dëshira. Nga dëshira për tu bërë prift, ai dëshiroi të 'luante rolin e Zotit'.



## BARSOLETA



### STUDENTI DHE PESHKU I ARTË

Një student e zë një peshk të artë. Më lësho dhe do ta plotësoj një dëshirë - thotë peshku. Si një? A nuk janë tri? - pyet me habi studenti. Eee, tash është me sistemin e Bolonjës...

### POLITIKANI SHQIPTAR

Një politikan shqiptar po bisedonte me një mikun e tij. - E keqja ime është që kur të vdes, do shkoj fishek e në ferr... - Ndërsa e mira është, që do kem të gjithë shokët e mi aty...

## THËNIA E DITËS

Të qenit plotësisht të ndershëm me vetveten është një ushtrim i mirë. (Sigmund Freud)

